

1 E enjte, 7 nëntor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, ju lutem, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është
8 lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.
10 Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit.

14 Përpara se të vijë dëshmitari, Trupi Gjykues ka disa
15 aspekte që do të trajtojë.

16 Së pari, Trupi Gjykues pasi shqyrtoi kërkesën e Mbrojtjes
17 së Veselit do të ndryshojë kalendarin sipas, domethënë, afatet
18 për dorëzimin e materialeve sipas rregullës 143 për
19 dëshmitarin W01453.

20 Trupi Gjykues urdhëron ZPS-në të dorëzojë parashtrimet
21 për pranueshmërinë e dokumenteve brenda të hënës 11 nëntor
22 2025 [Sipas përkthimit]. Urdhërohet Mbrojtja të përgjigjet
23 brenda të mërkurës 13 nëntor 2025 [Sipas përkthimit]. Nuk do
24 të shqyrtohen kundërpërgjigje.

25 Së dyti, Trupi Gjykues do të japë vendimin e vet sa i

1 takon materialit me numër 1D00204 që ishte me numër provizor.
2 Trupi Gjykues nuk do ta pranojë materialin me numër 1D00204 si
3 provë gjyqësore. Ju kërkohet ndjesë. Përgjegjësia për të
4 vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë e
5 dëshmisë së tij është e Trupit Gjykues. Dhe sa i takon
6 mospërputhjeve të dëshmive të tij, do t'i bëjë Trupi Gjykues
7 dhe asnjë trupi tjetër gjykues.

8 Gjithashtu sa i takon pjesëve përkatëse të aktgjykimit
9 Limaj, i janë treguar dëshmitarit dhe ai ka dhënë komentet
10 përkatëse gjatë kundërpvetjeve që i ka bërë Mbrojtja këtij
11 dëshmitari.

12 Më tej Trupi Gjykues thekson që nuk është e detyruar të
13 zbatohet konstatimet e trupave të tjera gjyqësore më parë. Për
14 rrjedhje Trupi Gjykues rrëzon pranimin e materialit 1D00204.

15 Do të japim dhe një urdhër tani sa i takon parashtrimit
16 të protokolluar të datës 1 nëntor 2024 me numër F02692.

17 Më falni, po, edhe një herë. 1 nëntor 2024. Mbrojtja e
18 Krasniqit kërkoi riklasifikimin e materialit përkatës si
19 material publik.

20 Më 4 nëntor u përgjigj ZPS-ja dhe kundërshtonte
21 ndryshimin e riklasifikimit.

22 Trupi Gjykues vëren se më 5 nëntor 2024 Mbrojtja e
23 Krasniqit dorëzoi një version të redaktuar publik të
24 materialit F02316. Prandaj, Trupi Gjykues e rrëzon kërkesën e
25 Krasniqit si të tejkaluar tashmë për riklasifikim dhe

1 riklasifikon materialin F02692.

2 Me kaq mbyll urdhrin e tretë me gojë.

3 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të

4 Prokurorisë W4153.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam dhe unë diçka për të trajtuar.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më lejoni një

7 çast të përfundoj unë, ju lutem.

8 Sot do vijojmë me dëshminë e dëshmitarit të Prokurorisë

9 W01453.

10 Tani z. Misetiç.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Dje në përfundim të

12 seancës, më informoi Sekretarja që për provën materiale që

13 mori numrin 1D00214. Që ishte një faqe e një libri të

14 Gjeneralit Jackson, si praktikë është përfshirë edhe ballina,

15 kopertina e librit. Prandaj do kërkoja që të pranohet edhe

16 kopertina e librit që mban numrin 1D00214, përndryshe

17 SPOE00212586 që është pjesë e paketës së materialeve me numër

18 SPOE00212586 deri në 00212692.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

20 kundërshtime?

21 Z. PACE: [Përkthim] S'kemi kundërshtime që të pranohet

22 dhe kopertina.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

24 [Përkthim] Atëherë, materiali SPOE00212586, që është

25 kopertina e librit, pranohet dhe i bashkëngjitet provës me

1 numër 1D00214.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, kjo faqe
3 do t'i bashkëngjitet provës 1D00214, dhe klasifikimi është
4 publik.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
6 Tani mund të sillni dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pikësëpari,
9 vërej për procesverbal që dhe avokati kujdestar, z. Hodaj,
10 është i pranishëm në sallën e gjyqit.

11 Z. HODAJ: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
13 Dëshmitar. Mirëmëngjesi Avokat.

14 Dëshmitar, ju rikujtoj që të përgjigjeni qartë me fjali
15 të shkurtra, nëse nuk e kuptoni një pyetje kërkoni që pyetja
16 të përsëritet, ose thjesht thoni që nuk e kuptoni që ta
17 sqarojmë pyetjen.

18 Gjithashtu, mos harroni të na thoni ku i bazoni ju
19 faktet, rrethanat për të cilat do t'ju bëjmë përgjigjet [Sipas
20 përkthimit].

21 Flisni pranë mikrofonit dhe bëni një pauzë prej pesë
22 sekondash përpara se të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë për
23 përkthyesit.

24 Në çdo moment që keni nevojë për të bërë pushim, na thoni
25 dhe do ta bëjmë të mundur.

1 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
2 vërtetën, sikurse vetë e thatë përmes betimit solemn.
3 Gjithashtu ju rikujtoj, garancitë që ju ka ofruar Trupi
4 Gjykues të hënën janë ende të vlefshme dhe nëse refuzoni të
5 përgjigjeni do të gjobiteni.

6 DËSHMITARI: SHUKRI BUJA (Vijon)

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani, do të
8 vijojmë me pyetjet -- z. Misetić, përfunduat ju?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, unë përfundova.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
11 Do të fillojmë me ekipin e Mbrojtjes së Veselit.

12 Z. Dixon, ju do t'i bëni pyetjet?

13 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
15 dëgjojeni z. Dixon me vëmendje.

16 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

17 Z. DIXON: [Përkthim]

18 PY. Mirëmëngjes z. Buja. Unë quhem Rodney Dixon. Dhe jam
19 Avokati për z. Kadri Veseli. Unë kam disa pyetje për ju.

20 PË. Mirëmëngjes.

21 PY. Z. Buja, dje në dëshminë tuaj folët për dy brigadat në
22 zonën tuaj, 161 dhe 162. Dhe shpjeguat se Brigada 161
23 qëndronte, ishte e vendosur, pra, në zonën e Shtimes, të
24 Ferizajt, dhe 162 ishte në zonën e Kaçanikut. E kam kuptuar
25 drejt?

1 PË. Po.

2 PY. Gjithashtu, dhatë dëshmi se këto brigada janë formuar në
3 tetor dhe vijuan përgjatë nëntorit dhe dhjetorit. Pra, e thënë
4 ndryshe, procesi i krijimit të këtyre brigadave filloi në
5 tetor por vazhdoi deri në dhjetor. A thatë kështu?

6 PË. Po.

7 PY. A mund t'ju pyes lidhur me këtë proces që ju thatë se
8 zgjati përafërsisht tre muaj. Ka pasur disa vështi [Sipas
9 përkthimit] në atë kohë, apo jo? Pra, ka pasur vështirësi për
10 krijimin e brigadave, që të ishin të gatshme për luftim, apo
11 jo?

12 PË. Ka pas vështirësi, dhe formimi i brigadave ka qenë një
13 proces në vazhdimësi deri në përfundim të luftës.

14 PY. A mund të na tregoni me një përmbledhje, me një fjalë,
15 cilat vështirësi keni pasur ju asokohe? Çfarë vështirësish
16 keni pasur?

17 PË. Po, ka pas mungesë të personelit profesional. Po ashtu ka
18 pas mungesa bukur shumë të materialeve ushtarake, ka pas edhe
19 mungesa të shumta dhe të vendosjes së njësiveve nëpër shtëpi.
20 Ka pas pengesa bukur të madh.

21 PY. Kur thoni ka pasur mungesë profesionistësh, domethënë e
22 keni fjalën që s'ishin të stërvitur për të qenë në një
23 brigadë, dhe nuk ishin të gatshëm për luftim, dhe se shumë
24 persona as nuk kishin përdorur ndonjëherë armë përpara?

25 PË. Po, sepse në periudhë bukur të gjatë nuk ka pas shërbim

1 ushtarak, dhe shumica e atyre që lajmëroheshin për t'u kyçur
2 në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës kanë qenë të patrajnuar dhe
3 nuk kanë ditur as përdorimin e armëve.

4 PY. A është e vërtetë që përpara kësaj periudhe, pra para
5 tetorit, ju keni pasur disa ofensiva serbe në zonën tuaj, në
6 gusht dhe shtator, apo jo?

7 PË. Ka pas një ofensivë serbe në rrethinën e fshatit Jezercë
8 dhe ka qenë një ofensivë shumë e fuqishme.

9 PY. Përmendët z. Agim Bajrami, që është shok i afërt i juaji,
10 thatë, dhe që ju ndihmoi për organizimin qysh në fillimet e
11 veta. Z. Agim Bajrami, a është një prej personave që u vra
12 gjatë kësaj ofensive në 1998?

13 PË. Agim Bajrami është vra në Kaçanik në 1998, në gusht.

14 PY. Tani, këto territoret ku qëndronin Brigadat 161 dhe 162,
15 161 është thellë në veri, 162 thellë në jug, pranë kufirit me
16 Maqedoninë, kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Në dëshminë tuaj ju thatë që duhej kohë për të udhëtuar
19 mes këtyre zonave. Gati dy net, saktë?

20 PË. Po, e saktë është.

21 PY. Pra, duhej kohë për të udhëtuar dhe në distanca të
22 shkurtra. A është e vërtetë që ishte e vështirë që të shkoje
23 nga brigada 161 tek tjetra brenda zonës tuaj?

24 PË. Po, sepse rrethanat kanë qenë shumë të vështira. Ka qenë
25 kohë e luftës dhe ne nuk kemi pas gjithë kontrollin në këtë

1 territor.

2 PY. Rruga që lidh dy zonat, nuk mund të përdorej asokohe, apo
3 jo? Apo e përdornit?

4 PË. Jo, rruga nuk është përdorur, janë përdorur rrugë të
5 maleve.

6 PY. Po pse nuk përdornit rrugën edhe shkonit përmes maleve?

7 PË. Po sepse rrugët ishin nën kontrollin e ushtrisë dhe
8 policisë serbe.

9 PY. Në dëshminë tuaj ju thatë po ashtu që gjatë kësaj kohe,
10 tetor, nëntor, dhjetor, ju po përpiqeshit të formonit zonat,
11 strukturën e zonës, kështu?

12 PË. Po, ka qenë një proces në vazhdimësi.

13 PY. Po. Dua të sqarojmë pak kronologjinë. Në janar ju keni
14 qenë në zonë. Por a është e saktë që ju më pas në shkurt
15 shkuat në Shqipëri e vazhduat më tej jashtë Shqipërisë,
16 kështu?

17 PË. Nuk më kujtohet data e saktë, por përafërsisht fundi i
18 shkurtit apo prillit -- apo marsi, më fal.

19 PY. Dhe ju thatë, u kthyet -- për të sqaruar pak
20 kronologjinë. Ju thatë që jeni kthyer -- në fillim të
21 bombardimeve të NATO-s që ka qenë në fund të marsit 1999.
22 Domethënë, nga jashtë shtetit jeni kthyer rreth kësaj date dhe
23 jeni rikthyer në zonën tuaj, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Pra, në zonën tuaj keni qenë, kjo është e sigurt që keni

1 qenë në janar në zonën tuaj, kur ndodhi dhe masakra -- deri në
2 janar, domethënë, deri në momentin që ndodhi masakra e
3 Reçakut, kështu? Keni qenë në zonën tuaj?

4 PË. Po, kam qenë në zonën time.

5 PY. Do t'ju bëj tani disa pyetje për sektorin e zbulimit në
6 zonën tuaj.

7 Kur filluat dëshminë këtu, ju thatë që ka qenë një z.
8 Elmi Reqica shef i sektorit të zbulimit në zonën tuaj. A ju
9 kujtohet që e keni thënë këtë?

10 PË. Po.

11 PY. A është e vërtetë që ai u emërua në këtë pozitë prej jush
12 në dhjetor të 1998, saktë?

13 PË. Përafërsisht në dhjetor, por emërimi ka qenë nga unë.

14 PY. A ju kujtohet që në fakt ju e keni thirr në telefon kur e
15 keni emëruar se ai ka qenë jashtë Kosovës. E keni thirr në
16 telefon dhe i keni thënë të kthehet se do ishte sektori -- më
17 fal, shefi i sektorit të zbulimit, kështu ka qenë?

18 PË. Nuk më kujtohet saktë kjo, por e di që një periudhë ka
19 qenë në Shqipëri.

20 PY. A ju kujtohet ju që ai u rikthye në janar të 1999-s, nga
21 gjysma e dytë e janarit 1999, për të marrë pozitën e tij në
22 sektorin e zbulimit?

23 PË. E di që në janar ka qenë në komandë të zonës dhe e ka
24 ushtruar detyrën e tij.

25 PY. Ju thatë që jeni ju personi që e emëruat. A është e

1 vërtetë atëherë që askush prej Shtabi i Përgjithshëm nuk e ka
2 emëruar atë në këtë pozitë?

3 PË. Jo, s'e ka emëruar.

4 PY. Z. Kadri Veseli, atëherë, nuk është personi që e ka
5 emëruar atë në pozitë, por jeni ju personi që e keni emëruar?

6 PË. Nuk ka pas mundësi Kadri Veseli me e emëru sepse unë kam
7 qenë komandant i zonës.

8 PY. A është e vërtetë që përpara se të emërohej z. Reqica,
9 nuk ka pasur asnjë person përgjegjës për zbulimin në zonën
10 tuaj?

11 PË. Jo, s'ka pas, sepse në tetor, nëntor, kemi filluar
12 konsolidimin e komandës së zonës operative të Nerodimës.

13 PY. Pra, ju në zonën tuaj s'keni pasur ndonjë strukturë të
14 zbulimit përpara kësaj?

15 PË. Jo, nuk ka pasur.

16 PY. Në brigadat që përmendëm, pra, 161 dhe 162, as këto dy
17 brigada nuk është se kishin ndonjë njësi përgjegjëse për
18 zbulimin?

19 PË. Jo, deri në formimin e tyre s'ka pasur.

20 PY. Kur u formuan në tetor, nëntor, dhjetor, u emërua ndonjë
21 person në këto brigada atëherë, për t'u marrë me çështjet e
22 zbulimit apo ka ndodhur më vonë?

23 PË. Nuk e di momentin e saktë, por secili komandant i
24 brigadës i emëruar ka pas për detyrë me i formu sektorët dhe
25 besoj që diku nga dhjetori janë formuar të gjithë sektorët dhe

1 të brigadave që kanë operuar në zonën time.

2 PY. Këta sektorë u caktuan prej komandantëve të brigadave
3 përkatëse, apo jo?

4 PË. Po, në konsultim me shefin e shtabit të zonës janë
5 përcaktuar nga komandantët e brigadave.

6 PY. Komandantët e brigadave, po faleminderit. Kam edhe disa
7 pyetje për z. Reqica. Ju atë e keni njohur që para luftës, ky
8 është një person që e njihnit dhe tek i cili kishit besim,
9 prandaj dhe i kërkuat të kthehej dhe të ishte përgjegjës për
10 sektorin e zbulimit, kështu?

11 PË. Kam qenë në burg bashkë me Elmi Reqicën, kam vuajtur
12 burgun e Serbisë me z. Elmi Reqica.

13 PY. A është e vërtetë që ai ka punuar për një OJQ, organizatë
14 joqeveritare, që e kishte emrin Këshilli për të Drejtat dhe
15 Liritë e Njeriut, CDHRF, në Kosovë.

16 PË. Po ka punuar për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave
17 dhe Liritë të Njeriut.

18 PY. Kjo është një OJQ që trajton rastet e abuzimeve ndaj
19 civilëve, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe ai ka punuar në këtë organizatë deri në fillimet e
22 luftës, apo jo?

23 PË. Po, ashtu është.

24 PY. Ju thatë që kur u kthye, ai e mori pozitën në janar të
25 1999. A është e vërtetë që ai nuk kishte burime në dispozicion

1 për të ushtruar funksionet e tij si oficer zbulimi?

2 PË. Ka pasur shumë pak burime, ose më mirë me e thënë hiç.

3 PY. Ka qenë thjesht një person, vetëm ai. Pra, në sektorin e
4 zbulimit, askush tjetër.

5 PË. Po, fillimisht ka qenë vetëm ai.

6 PY. Kjo ka ndodhur në janar, shkurt, mars? Pra këto tri muaj
7 ka qenë vetëm?

8 PË. Nuk më kujtohet a ka qenë vetëm tre muaj, por e di që
9 fillimisht ka qenë vetëm ai i emëruar në sektorin e zbulim-
10 kundërzbulimit.

11 PY. Ai nuk kishte ndonjë zyrë të vetën. Zyrë enkas për
12 çështjet e zbulimit, apo jo?

13 PË. Edhe një herë se s'e kuptova.

14 PY. Më falni, se e formulova keq. Ta bëj të qartë. Ai nuk
15 kishte një zyrë të vetën, apo jo? Kishte një zyrë të vetën ku
16 të kryente detyrat e tij?

17 PË. Ai më shumë në atë periudhë ka punuar që të strukturojë
18 sektorin sepse është dashtur të përzgjidhen njerëzit për atë
19 sektor.

20 PY. Por ju punonit të gjithë bashkë në një zyrë, ndanit një
21 zyrë, apo jo? Se ashtu ishin rrethanat asokohe, a është
22 kështu?

23 PË. Po, në periudhën e fillimit të komandës së zonës kemi
24 qenë në një shtëpi dhe kemi pas zyrat aty.

25 PY. A është e vërtetë se ju nuk e keni pasur dhe luksin të

1 uleshit në një zyrë edhe të jepnit urdhra që aty? Edhe ju
2 personalisht bashkë me z. Reqica dilnit në terren dhe merrnit
3 pjesë në luftime, a është e saktë?

4 PË. Po, e saktë është, kam marrë pjesë drejtpërdrejt në
5 luftime në çdo betejë që është zhvilluar në atë kohë.

6 PY. Edhe z. Reqica? Edhe ai merrte pjesë në luftime?

7 PË. Po, gjithë komanda e zonës ka marrë pjesë në luftime.

8 PY. Tani dëshiroj t'ju bëj disa pyetje lidhur me
9 informacionet që mund të grumbullonte z. Reqica në kuadrin e
10 detyrave të zbulimit. Me sa mbani mend, a ju raportonte ai ju
11 informacionet që mblidhte?

12 PË. Në periudhë më të vonë, po.

13 PY. Kur thoni "në periudhë më të vonë", mund të na ndihmoni
14 diçka më shumë me përafërsi, për çfarë periudhe datash bëhet
15 fjalë?

16 PË. Po, periudha mund të jetë pas shkurtit sepse në atë kohë
17 edhe është konsolidu ma mirë sektori i zbulim-kundërzbulimit.

18 PY. A është e vërtetë se nga ky moment e në vijim ai ju jepte
19 informata për pozicionet serbe, vendndodhjen e forcave serbe,
20 domethënë, të këtij lloji ishin informatat që ju jepte,
21 kështu?

22 PË. Po, kjo ka qenë detyra e zbulim-kundërzbulimit.

23 PY. A është e vërtetë që nuk e kishte ai për detyrë të
24 mblidhte informata për bashkëpunëtorë të mundshëm apo civilë
25 që mbase ndihmonin forcat serbe?

1 PË. Kjo nuk ka qenë detyrë e sektorit të zbulimit.

2 PY. Raportet që ju jepte, apo më saktë raportimet për
3 pozicionet serbe, ishin me shkrim apo ishin me gojë, si ju
4 raportonte ai ju?

5 PË. Shumica e raporteve ka qenë me gojë, ka pas edhe raste
6 kur ka mund të raportojë me shkrim, kur kem pas lëvizje të
7 mëdha të forcave serbe.

8 PY. Informacionet që ju jepte, ai këto informacione ju jepte
9 në kuadër të rolit tuaj si komandant zone, apo jo?

10 PË. Po. Ishte detyra e tij të raportonte te shefi i shtabit
11 dhe te komandanti i zonës.

12 PY. Pra, që t'i përdornit ju në zonë këto informata, në
13 mënyrë që të organizonit operacionet tuaja dhe mbrojtjen tuaj,
14 apo jo?

15 PË. Sigurisht.

16 PY. Këto nuk kanë qenë informacione që ti më pas ia përcillje
17 Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

18 PË. Jo, si raporte nuk i kemi përcjell.

19 PY. Z. Reqica gjithashtu nuk është se ju anashkalonte ju edhe
20 i raportonte dikujt drejtpërsëdrejti në Shtabin e
21 Përgjithshëm?

22 PË. Nuk ka qenë detyrë e tij me raportu në Shtab të
23 Përgjithshëm.

24 PY. Në dëshminë tuaj thatë se në prill dhe në maj,
25 për afërsisht, ju mësuat se Kadri Veseli, z. Kadri Veseli,

1 ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe se kishte qenë
2 pjesë e Shtabit të Përgjithshëm dhe ishte drejtor i zbulimit.
3 A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

4 PË. Po.

5 PY. A është e vërtetë që z. Veseli në këtë rol asnjëherë nuk
6 ju ka dhënë ju personalisht ndonjë urdhër për zonën tuaj?

7 PË. Jo, s'më ka dhanë urdhra.

8 PY. Ai nuk i ka dhënë asnjë urdhër as z. Reqica, apo jo?

9 PË. Jo, sepse z. Reqica ka qenë në kuadër të komandës së
10 zonës operative të Nerodimës.

11 PY. Kjo ka ndodhur si në periudhën që po diskutojmë,
12 domethënë, në vitin 1998, edhe në muajt e parë të 1999, apo
13 jo? Domethënë, për të dyja këto periudha ajo çfarë thatë më
14 përpara është e vërtetë, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Ishit tu fol për 1999, por në 1998 nuk ka pas ndonjë
16 strukturë të tillë operative, do të thotë, të zbulim-
17 kundërzbulimit në zonën operative të Nerodimës.

18 PY. Dje na shpjeguat se z. Veseli erdhi në zonën tuaj dhe
19 thatë që periudha ka qenë pak a shumë maj, apo fillimi i
20 qershorit. Ai tha që z. Veseli, ju tha që z. Veseli ka ardhur
21 në zonën tuaj për të qëndruar aty gjatë kësaj periudhe. A ju
22 kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

23 Z. DIXON: [Përkthim] Dhe kjo është thënë në procesverbal
24 në faqen 218 [Sipas përkthimit].

25 DËSHMITARI: Po, më kujtohet.

1 Z. DIXON: [Përkthim]

2 PY. Është e vërtetë, apo jo, që kjo është periudha kur po
3 bëhej organizimi i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës pas
4 konferencës së Rambujesë, a është kështu?

5 PË. Po, e vërtetë është.

6 PY. A ju kujtohet se në atë kohë, domethënë në maj, qershor e
7 në vijim, z. Veseli në atë fazë, në atë kohë, ka qenë ministri
8 i shërbimit informativ të Kosovës? A ju kujtohet që z. Veseli
9 është caktuar në atë pozicion në atë kohë?

10 PË. Nëse nuk gaboju, ka qenë muaji maj kur dalë publik
11 informacioni për ministrat në kuadër të qeverisë së përkohshme
12 të Kosovës.

13 PY. Pra, ju e keni ditur që kur z. Veseli ka qenë në zonën
14 tuaj, domethënë, në atë kohë ai ishte emëruar si shefi i
15 Shërbimit Informativ të Kosovës, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe në atë kohë ai nuk ishte më anëtar i Shtabit të
18 Përgjithshëm ndërkohë që ka qenë i pranishëm në zonën tuaj,
19 por vepronte në kapacitetin ose në postin e tij si shef i
20 këtij institucioni. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po, më kujtohet. Qeveria e përkohshme ka kalu në
22 organizim civil.

23 PY. Keni dhënë dëshmi, gjithashtu, edhe lidhur me një takim
24 ku ka marrë pjesë z. Veseli, gjatë kohës kur ka qëndruar në
25 zonën tuaj. Doja të sqaroja disa gjëra lidhur me të. Ju thatë

1 që nuk keni pasur mundësi që të merrnit pjesë në atë takim. A
2 ka ndodhur kështu, Dëshmitar?

3 PË. Në takimet e asaj kohe të Shtabit të Përgjithshëm dhe
4 qeverisë së përkohshme nuk kam mujt me marrë pjesë sepse unë
5 s'kam qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm e as e qeverisë së
6 përkohshme.

7 PY. Ju thatë se keni qenë aty për të bërë organizimet e
8 nevojshme për sigurinë edhe çështjet e tjera të lidhura. A
9 është e drejtë të thuhet që ju nuk keni marrë pjesë në bisedat
10 që janë zhvilluar në takim dhe nuk keni njohuri lidhur me këto
11 biseda. Është e drejtë të thuhet kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, është e drejtë kjo.

13 PY. A ju kujtohet që në dëshminë tuaj ju u shprehët lidhur me
14 një takim që keni marrë pjesë, takim që kishte të bënte me
15 përvjetorin e ligës shqiptare që është zhvilluar më datë 10
16 qershor 1999, ku ju thatë që z. Veseli ka folur në këtë takim.
17 Ju është treguar gjithashtu dhe një artikull i BBC-së lidhur
18 me këtë.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Për ata që na ndjekin nga Gjykata,
20 është prova P526.

21 PY. Ju kujtohet, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Kur z. Veseli ka folur aty, a ju kujtohet në qoftë se ai
24 ka folur në cilësinë e tij si një prej ministrave ose
25 personave përgjegjës në ministrinë -- në qeverinë e re të

1 Kosovës, ju kujtohet kjo gjë, Dëshmitar?

2 PË. Kjo nuk më kujtohet, por ka folur si një personalitet
3 politik i lartë.

4 PY. Faleminderit. Kam disa tema të fundit dhe do përfundoj
5 për pak, z. Buja.

6 Gjatë marrjeve në pyetje ju treguan kolegët, kolegu im,
7 Prokurori, ju tregoi tekstin e disa rregulloreve të brendshme
8 disiplinore, dhe ju thatë që këto ishin dokumente nga zona
9 juaj pak a shumë rreth janarit të vitit 1999.

10 PË. Po, ashtu thashë.

11 PY. A është e drejtë të thuhet që z. Reqica në sektorin e
12 zbulimit, që për të cilin edhe folëm më herët, a është e
13 drejtë të thuhet që nuk ishte përgjegjësi e tij për të zbatuar
14 këto rregullore disiplinore, apo jo?

15 PË. Nuk ka qenë detyrë e zbulim-kundërzbulimit, ka qenë
16 detyrë e policisë ushtarake dhe komandantit të brigadës.

17 PY. Domethënë, sektori i zbulimit nuk është se kishte asnjë
18 lloj përgjegjësie sa i takon hetimeve që kishin të bënin me
19 çështje disiplinore. A është e drejtë të thuhet kjo,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po, e drejtë është.

22 PY. Po ashtu ju përmendët policinë ushtarake. Dhatë dëshmi
23 gjithashtu edhe për njësitin e formuar në policinë ushtarake.
24 A është e drejtë të thuhet që edhe sektori i zbulimit nuk
25 është se kishte ndonjë përfshirje, s'kishte lidhje me punën e

1 policisë ushtarake? A mund të thuhet kjo, Dëshmitar?

2 PË. Sektori i zbulim-kundërzbulimit ka qenë në kuadër të
3 komandës së zonës, ndërsa policia ushtarake ka qenë njësi e
4 veçantë apo kompania e policisë, që ka raportu drejtpërdrejt
5 komandantit të zonës.

6 PY. Është e drejtë, është e saktë, apo jo, që këto ishin dy
7 sektorë të veçantë, domethënë policia ushtarake ishte një
8 sektor, ndërkohë që sektori i zbulim-kundërzbulimit ishte
9 sektor i veçantë, nuk kishin lidhje me njëri-tjetrin,
10 domethënë ishin sektorë të veçantë, është e drejtë të thuhet
11 kjo, Dëshmitar?

12 PË. Policia ushtarake ka qenë njësi e veçantë, ndërsa sektori
13 ka qenë sektor i veçantë.

14 PY. Po. Ju thatë që policia ushtarake u bë batalion i
15 policisë ushtarake me kalimin e kohës, domethënë u bë batalion
16 i veçantë. A është kështu?

17 PË. Po.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës
19 nuk kam pyetje të tjera.

20 PY. Dëshmitar, nuk kam pyetje të tjera.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts,
22 fjala për ju.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, nuk kam pyetje për
24 dëshmitarin.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

1 Alagendra, fjala për ju për pyetjet për dëshmitarin.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
3 Gjykatës.

4 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

6 PY. Mirëmëngjes z. Buja. Unë jam Venkateswari Alagendra dhe
7 jam Avokatja e z. Jakup Krasniqi.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për
9 arsye planifikimi, dua t'ju them që nuk do më duhet më shumë
10 se sa një orë për këtë dëshmitar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
12 Në orën 10.00 do bëjmë pushimin për 10 minuta, sa për ta ditur
13 ju, Avokate.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Z. Buja, të martën ju thatë në dëshminë tuaj që z.
16 Krasniqi njihej nga popullata civile për shkak të faktit që ai
17 ka qenë ish-i burgosur politik. Ka qenë pjesë e strukturave të
18 LDK-së dhe njihej gjerësisht si një person politikisht
19 kompetent dhe i zgjuar. A ju kujtohet ta keni thënë këtë,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, ju ishit në dijeni të faktit që z. Krasniqi ka qenë
23 një i burgosur politik për shumë kohë, domethënë, ka qenë
24 aktivist për shumë kohë, dhe më pas ka qenë i burgosur politik
25 për një periudhë të gjatë, për dhjetë vite, nga viti 1981 deri

1 në vitin 1991. Këtë informacion e keni pasur, apo jo,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Si pjesë e veprimtarive të tij politike, ai ishte i
5 lidhur me LDK-në përpara luftës, a është kështu, Dëshmitar?

6 PË. Po.

7 PY. Ju mund të konfirmoni se Jakup Krasniqi nuk ka qenë
8 asnjëherë anëtar i LPK-së, a është e saktë kjo?

9 PË. Unë së paku nuk e di që ka qenë anëtar i LPK-së.

10 PY. Pra, në qoftë se ndokush sugjeron që Jakup Krasniqi ka
11 qenë gjithmonë anëtar i LPK-së, jo nuk ishte e saktë, apo jo,
12 Dëshmitar?

13 PË. Edhe një herë, të lutem?

14 PY. Të kërkoj ndjesë. Pra, në qoftë se dikush do sugjeronte
15 ose supozonte që Jakup Krasniqi ka qenë gjithmonë anëtar i
16 LPK-së, kjo gjë nuk do ishte e vërtetë, ky informacion nuk do
17 ishte i vërtetë, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Jo, sepse publikisht ai ka qenë anëtar i Lidhjes
19 Demokratike të Kosovës.

20 PY. Të mërkurën, ju thatë që Bardhyl Mahmuti ka qenë pjesë e
21 kryesisë së LPK-së. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Ai më vonë u bë përfaqësues politik i UÇK-së, apo jo?

24 PË. Po, është e vërtetë.

25 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do

1 kërkoja që të paraqitet në ekran dokumenti 4D00088.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të shkojmë në faqen

4 DJK01052, faqja e dytë.

5 PY. Në mes të faqes Bardhyl Mahmuti thotë:

6 "... Jakup Krasniqi ishte një atdhetar i shquar që kishte
7 kaluar mbi dhjetë vjet në burgjet serbe, profesor që gëzonte
8 famën e një pedagogu shembullor dhe një intelektual që kishte
9 mbështetje të pakontestueshme gjithandej Kosovës."

10 A është e saktë kjo, Dëshmitar? Që Jakup Krasniqi kishte
11 fituar reputacion të padiskutueshëm me popullatën civile.

12 Gjithashtu, për faktit që kishte qenë profesor historie dhe
13 kishte qenë një pedagog shembullor. A është e saktë kjo?

14 PË. Po, e saktë.

15 PY. Në paragrafin e tretë në dokumentin që keni në ekran, z.
16 Mahmuti shpjegon që tema e parë e ngritur nga diplomatët e
17 huaj ishin elementët e ideologjisë dhe marrëdhëniet ndërmjet
18 LPK-së dhe LDK-së. A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. Do ju kërkoja që të lexonit dy paragrafët e tjerë, nëse
21 është e mundur. E lexuat?

22 PË. Po.

23 PY. Faleminderit. Z. Mahmuti e thotë qartë, apo jo, që Jakup
24 Krasniqi nuk kishte qenë asnjëherë anëtar i LPK-s, por kishte
25 qenë në fakt anëtar i LDK-së. E thotë z. Mahmuti këtë gjë në

1 artikull, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. E saktë është.

3 PY. Më pas ai thotë që emërimi i Jakup Krasniqit si zëdhënës
4 i UÇK-së nga LPK-ja ishte avantazh sepse kjo tregonte që UÇK-
5 ja nuk ishte vetëm e lidhur me LPK-në, por tregonte në një
6 farë mënyre unitetin e UÇK-së. A pajtoheni ju me këtë,
7 Dëshmitar?

8 PË. Po, pajtohem.

9 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër
10 e të njëjtit dokument.

11 PY. Dua t'ju tërheq vëmendjen te paragrafi i parë, z. Buja.
12 Shihni paragrafin e parë. Bardhyl Mahmuti këtu thekson që "në
13 fakt, detyra e LPK-së ishte që të unifikonte të gjithë
14 shqiptarët, pavarësisht klasave ideologjisë, partive, apo
15 ndasive fetare." A e shikoni këtë, z. Buja?

16 PË. Po.

17 PY. Edhe kjo është në përputhje me atë se si e keni kuptuar
18 ju situatën dhe duke marrë parasysh edhe statutin që ju tregoi
19 z. Misetić dje, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Po, kjo është pjesë e statusit, statutit të LPK-së, të
21 cilin kam qenë edhe unë anëtar.

22 PY. Ju pajtoheni se përzgjedhja e Jakup Krasniqit, një figurë
23 e LDK-së si zëdhënës i UÇK-së ishte një shenjë e fortë që
24 demonstronte që UÇK-ja ishte një organizatë që nuk kishte
25 lidhje politike me asnjë parti. A është e saktë kjo,

1 Dëshmitar?

2 PË. E saktë është, por në atë kohë Jakup Krasniqi në --
3 emërim si zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e kam
4 pritur me padurim sepse ka qenë një personalitet i
5 jashtëzakonshëm, një njeri që ka pasur rezon politik të
6 jashtëzakonshëm, dhe ka qenë një njeri i cili është pritur në
7 mënyrë të jashtëzakonshme mirë nga popullata civile.

8 PY. Faleminderit. Tani, të kalojmë te marrëdhënia ndërmjet
9 vëllait tuaj Ramë Buja, dhe Jakup Krasniqit përpara luftës.

10 Edhe vëllai juaj, Ramë Buja, ka qenë i burgosur nga
11 regjimi serb përpara luftës, apo jo, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Për mbi një vit vëllai juaj ka qëndruar i ndaluar, i
14 burgosur së bashku me z. Krasniqi në burgun e Novisadit, apo
15 jo, Dëshmitar?

16 PË. Ka qenë i dënuar me 8 vite, ndërsa një pjesë të periudhës
17 së burgut, vuajtjes së burgut ka qëndruar me Bacën Jakup.

18 PY. Arriti një pikë që ata ishin në një qeli bashkë të dy,
19 apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Vëllain tënd e liruan nga burgun në janar të vitit 1990,
22 apo jo?

23 PË. Po, është e vërtetë.

24 PY. Kur z. Krasniqi u lirua nga burgun në vitin 1991,
25 domethënë një vit pas vëllait tuaj, vëllai juaj, Ramë Buja dhe

1 familja e tij i shkuan për vizitë në shtëpinë e tij në

2 Negrovc, apo jo, Jakup Krasniqit?

3 PË. Këtë nuk mund ta di sepse unë kam qenë në burgun e

4 Nishit.

5 PY. Në atë kohë e keni fjalën. Megjithatë, kjo është një

6 marrëdhënie për të cilën ishit në dijeni, domethënë ishte

7 zakon që vëllai juaj të shkonte të vizitonte z. Krasniqi në

8 Negrovc, edhe z Krasniqi të vinte dhe të vizitonte familjen

9 tuaj, kjo ishte e ditur për ju, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Po, ne kemi pas marrëdhënie të mira familjare dhe ish-të

11 burgosurit politikë, në veçanti Jakupi me Ramën kanë pas

12 marrëdhënie të veçanta sepse kanë vujt bashkë në burgjet

13 jugosllave.

14 PY. Ajo ishte një marrëdhënie e cila mbështetej në një besim

15 të ndërsjellë midis jush dhe z. Krasniqi, a është e saktë kjo,

16 Dëshmitar?

17 PË. Sigurisht.

18 PY. Të martën, ju thatë se jeni takuar me z. Krasniqi në

19 qershor ose në korrik të vitit 1998, kur ka dhënë një

20 intervistë në cilësinë e tij si zëdhënësi, domethënë kur ka

21 dhënë, në fakt, intervistën e parë si zëdhënësi i UÇK-së, këtë

22 thatë ju. Domethënë si zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të

23 Kosovës. A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

24 PË. Po.

25 PY. Më pas, Prokuroria ju lexoi një pjesë të dëshmisë së

1 dhënë ju, nga ju për TPNJ-në në çështjen Limaj, ku ju thatë që
2 pas paraqitjes së parë publike të Jakup Krasniqit, ju
3 insistuat që të takoheshit me zëdhënësin e UÇK-së, dhe në fakt
4 e keni takuar atë rreth datës 20 qershor të vitit 1998. A ju
5 kujtohet kjo, Dëshmitar?

6 PË. Po.

7 PY. Me paraqitjen publike të z. Jakup Krasniqi si zëdhënësi i
8 UÇK-së më 14 qershor 1998, a është e vërtetë të thuhet që ju
9 supozuat që ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm?

10 PË. Po. Dalja publike si zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të
11 Kosovës ne nënkuptuam se ai është anëtar i Shtabit të
12 Përgjithshëm.

13 PY. Në atë kohë ai ishte anëtar i vetëm i Shtabit të
14 Përgjithshëm që njihej publikisht, që njihej gjerësisht, a
15 është e drejtë të thuhet kjo, është e vërtetë kjo?

16 PË. Po.

17 PY. Në cilësinë e tij si zëdhënës, z. Krasniqi njihej me emër
18 e mbiemër, dhe nuk njihej me pseudonime ose me nofka. A është
19 e saktë kjo?

20 PË. E saktë.

21 PY. Po ashtu, edhe fytyra e tij transmetohej dhe njihej
22 publikisht, apo jo, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. Në dëshminë që keni dhënë në vitin 2005, ju keni thënë që
25 ishte rrezikshmëri të lartë për një anëtar të Shtabit të

1 Përgjithshëm që ta bënte të njohur emrin dhe mbiemrin sepse
2 bëhej automatikisht menjëherë shënjestër për forcat serbe. A
3 ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Edhe sot i qëndroni asaj çfarë keni thënë, apo jo,
6 Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe për këtë arsye, thuajse të gjithë kishin nofka në
9 mënyrë që të mbronin veten dhe të mbronin familjet e tyre në
10 atë kohë, ku Jakup Krasniqin të gjithë e njihnin me emër,
11 mbiemër dhe e njihnin si fytyrë. A është e saktë kjo,
12 Dëshmitar?

13 PË. Po, e saktë është.

14 PY. Është e vërtetë, apo jo, që z. Krasniqi ka qenë një
15 figurë politike e njohur në zonën e Drenicës, dhe njerëzit e
16 dinin çfarë prejardhje kishte ai dhe ku e kishte familjen?

17 PË. Po, është e vërtetë.

18 PY. Ju pajtoheni me mua që kjo jo vetëm që e ka vendosur
19 Jakup Krasniqin në rrezikshmëri të lartë, por ka vendosur në
20 rrezik gjithashtu edhe jetën e bashkëshortes, fëmijëve,
21 prindërve, dhe të gjithë familjes së tij më të gjerë, apo jo?

22 PË. Po, është e saktë.

23 PY. Si figura e vetme publike e UÇK-së, e bërë publike, nuk
24 ishte e sigurt që Jakup Krasniqi të qëndronte në një vend të
25 vetëm, në një vend fiks, dhe për këtë arsye ai lëvizte në

1 vende të ndryshme. Domethënë, për arsye sigurie, lëvizte nga
2 një vend tek tjetri. A pajtoheni me mua lidhur me këtë,
3 Dëshmitar?

4 PË. Po, ka lëvizur bukur shumë.

5 PY. Tani dëshiroj që të shikojmë disa pjesë të deklaratave të
6 mëhershme që kanë lidhje me z. Krasniqi.

7 Më 8 mars 2005, i keni thënë TPNJ-së në çështjen Limaj,
8 që Jakup Krasniqi nuk kishte rol operativ dhe nuk është marrë
9 me çështje operative. A i qëndroni dhe sot e kësaj dite kësaj
10 çfarë keni thënë, Dëshmitar?

11 PË. Po. Zëdhënësi ka qenë zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të
12 Kosovës, dhe detyrat operative s'kanë kuptim.

13 PY. I thatë Trupit Gjykues dje, për procesverbal e keni thënë
14 në faqen 20 të transkriptit të përkohshëm, për referencë, që
15 kur keni kontaktuar me Jakup Krasniqin pas paraqitjes së tij
16 publike këtë e keni bërë sepse keni supozuar që ai i
17 raportonte më tej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. A ju
18 kujtohet ta keni thënë këtë dje?

19 PË. Kam thënë se ka qenë njeriu i vetëm publik nga Shtabi i
20 Përgjithshëm dhe adresa e vetme për të kontaktuar me Shtabin e
21 Përgjithshëm. E kemi njoftuar z. Krasniqi, tu shpresu që do të
22 përcillem në Shtabin e Përgjithshëm.

23 PY. Në rregull. Ju këtë rol gjatë kësaj periudhe e keni
24 përshkruar ose e keni karakterizuar si person ndërlidhës, ose
25 si ndërmjetës, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Ka qenë zëdhënës, dhe ne adresën e vetme e kemi pas dhe
2 realisht, do të thotë, nuk kemi pas mundësi të tjera përpos
3 përmes Jakup Krasniqit me kontakt me Shtabin e Përgjithshëm.

4 PY. Në rregull. Pra, ju pajtoheni me mua që në rolin e tij si
5 zëdhënës ai kishte rol vetëm thjesht për të kaluar ose për të
6 përcjellë mesazhe dhe informacion. Ju e keni ditur në atë kohë
7 që ai nuk kishte rol, ose nuk kishte mundësi që të merrte
8 vendime operacionale. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. Kjo është në përputhje me rolin e një zëdhënësi në çdo
11 ushtri, sepse roli i zëdhënësve është që të përfshihet me
12 shtypin edhe që të ketë biseda me përfaqësues zyrtarë,
13 diplomatë, dhe të mos merret me çështje operative luftarake. A
14 pajtoheni me mua lidhur me këtë, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. I keni thënë gjithashtu TPNJ-së se Jakup Krasniqi
17 asnjëherë nuk ka përcjellë mesazhe kur ka pasur luftime dhe
18 kur njësitet në terren duhej që të koordinoheshin. A i
19 qëndroni kësaj gjëje dhe sot, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Më pas pyeteni se kush ju kanë dhënë udhëzime lidhur me
22 këto çështje, me këto tema. Në përgjigje ju keni thënë,
23 personat që na jepnin informacion ishte Azem Sylja, që më vonë
24 e keni zbuluar që ishte komandanti i përgjithshëm i UÇK-së,
25 dhe Sokol Bashota që ishte i përfshirë me organizimin. Po

1 ashtu, kjo pjesë e deklaratës tuaj ju tregua nga Prokurori të
2 martën. A i qëndroni kësaj deklaratë përsëri sot, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Të mërkurën, z. Misetic -- ose, ta them ndryshe, i thatë
5 z. Misetic që nuk ishit në dijeni që Sokol Bashota ishte
6 zëvendësi i Azem Sylës. A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

7 PË. Po.

8 PY. Dëshiroj që të paraqitet në ekran një dokument. Nuk e di,
9 të nderuar Gjykatës, në qoftë se do bëjmë pushimin tani apo
10 pasi të shikojmë dokumentin.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
12 pushimin tani.

13 Dëshmitar, do bëjmë dhjetë minuta pushim, do kthehemi në
14 10.10 këtu. Mund të dilni nga salla. Ju lutem, mos flisni me
15 askënd jashtë sallës së gjyqit lidhur me dëshminë.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
18 pushim deri në orën 10.10.

19 --- Pauza fillon në orën 9.58.

20 --- Seanca rifillon në orën 10.10

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
22 sillni dëshmitarin në sallë.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
25 të vazhdojë z. Alagendra me pyetjet e veta. Dëgjojeni me

1 vëmendje.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

3 Ju lutem vendosni në ekran provën me numër P00157 -- 87
4 [Sipas përkthimit], në versionin PDF.

5 PY. Dëshmitar, shikoni kolonën e parë në të majtë diku nga
6 mesi. Është një intervistë që ka dhënë Azem Syla për Zërin e
7 Kosovës. I është bërë një pyetje atij:

8 "Kur krijohet Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe cilët
9 kanë qenë anëtarët e parë?"

10 E shihni në mes?

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Pak më poshtë shqipen, ju
12 lutem, që të shfaqet e plotë. Në të majtë është. Është kjo që
13 fillon "Ata që vendosën ...".

14 PË. Po.

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faqja 3 e PDF-së, ju lutem.
16 Në anglisht është në mes të faqes.

17 PY. E lexuat z. Buja paragrafin:

18 PË. Po.

19 PY. A pajtoheni ju me mua atëherë që sipas kësaj, Azem Syla
20 ka thënë:

21 "Pas ngjarjeve të 1997-s, u detyruam të ndanim detyrat,
22 kështu që zëvendësi im, Sokol Bashota, u vu në krye të Shtabit
23 të Përgjithshëm dhe kreu më shumë detyra deri në periudhën e
24 takimeve të Rambujesë."

25 E patë këtë?

1 PË. Po.

2 PY. A pajtoheni me mua që Azem Syla është personi më i
3 përshtatshëm që mund të tregojë kush ka qenë zëvendësi i tij?

4 PË. Sigurisht që Azem Syla mund të tregojë më mirë sepse unë
5 këto çështje nuk i kam ditur në atë kohë.

6 PY. Po, por kjo përputhem dhe me atë që keni thënë ju në TPNJ
7 që Azem Syla dhe Sokol Bashota kanë qenë të përfshirë në
8 operacione, në aktivitete operative - më falni - sikurse është
9 dhe koordinimi me komandantin e njësive përfshirë edhe ju, për
10 të krijuar vijat e furnizimit nga '98-s deri në fillim të '99-
11 s, kështu?

12 PË. Po, kështu duhet të jetë.

13 PY. Në korrik të '98-s përveç Sokol Bashotës dhe Azem Syla ka
14 qenë dhe një person tjetër që ka pasur detyra operative, pranë
15 UÇK-së dhe ky person ishte Bislime Zyrapi, apo jo?

16 PË. Nëse nuk ka gaboj ka qenë fundi i korrikut, fillimi i
17 gushtit që Bislime Zyrapi ka pas detyrën e shefit të shtabit.

18 PY. Dhe sikurse i thatë dje Trupit Gjykses roli i Jakup
19 Krasniqit si ndërlidhës apo si ndërmjetës zgjati për shumë pak
20 kohë, sepse në '98-s juve ju thanë që kontaktet me Shtabin e
21 Përgjithshëm nuk do të mbaheshin më me zëdhënësin por me
22 Bislime Zyrabin. Kështu ka qenë?

23 PË. Po.

24 PY. Po ashtu na thatë dje se e keni ndjekur, e keni përcjellë
25 dëshminë e z. Zyrapi në këtë sallë gjyqi dhe pajtoheni me mua

1 besoj që z. Zyrapi i ka thënë këtij Trupi Gjykues që me
2 udhëzim të Sokol Bashotës ka vizituar, ka ndihmuar dhe ka
3 këshilluar komandantët lokalë në gjithë Kosovën nga fillimi i
4 majit, qershorit 1998. E kundërshtoni këtë?

5 PË. Këto nuk e di, po e di që në korrik, gusht janë takuar,
6 në fundin e korrikut apo fillimin e gushtit jam takuar dhe me
7 shefin e shtabit, Bislim Zyrapi.

8 PY. Po. Por, nëse vetë z. Zyrapi e ka thënë këtë, ju nuk keni
9 arsye për ta kontestuar se ai e dinte shumë mirë vetë se çfarë
10 bënte.

11 Z. PACE: [Përkthim] E kundërshtoj, nuk është ky
12 dëshmitari që mund t'i përgjigjet kësaj pyetje. Nuk është e
13 përshtatshme për këtë dëshmitar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

16 PY. Z. Zyrapi konfirmoi se ai u bë shef i operacioneve në UÇK
17 në korrik të 1998-s. Dhe në kuadër të këtij roli ai filloi të
18 udhëtonte në zona të ndryshme dhe takohej me komandantët e
19 zonave për t'i ndihmuar ata me organizimin. E kontestoni ju
20 këtë?

21 PË. Jo, s'e kundërshtoj.

22 PY. Z. Zyrapi, po ashtu ka konfirmuar se komandantët e zonave
23 i drejtoheshin pikërisht atij për çështje të strukturimit, të
24 organizimit apo dhe për çështje të tjera ushtarake. Edhe kjo
25 është periudha, është pikërisht periudha kur thoni dhe ju që

1 Bislim Zyrapi ka qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

2 PË. Po, realisht komandantët e zonave i kanë drejtu shefit të
3 shtabit. Kështu ka qenë.

4 PY. Sa i takon z. Krasniqi, a pajtoheni me mua, Dëshmitar, se
5 ju mund të flisni vetëm për kontaktet që keni pasur ju vetë me
6 z. Krasniqi, nuk mund të flisni për kontaktet që kanë pasur
7 komandantët e tjerë në gusht - më falni - në qershor dhe
8 korrik 1998.

9 PË. Për vete mund të flas, po për të tjerë nuk di çfarë
10 kontaktesh kanë pas.

11 PY. Flasim tani për dëshminë që keni dhënë për kontaktet që
12 keni pasur ju me z. Krasniqi në korrik -- në qershor 1998.

13 Ditën e martë ju na thatë se në atë kohë ju nuk kishit
14 telefona. Atëherë, a pajtoheni ju me mua që kontaktet që keni
15 pasur me z. Krasniqi asokohe kanë qenë kontakte fizike me --
16 pra, e keni takuar thjesht fizikisht, kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Edhe dhe atëherë në vartësi të rrethanave, apo jo, nëse
19 mundeshit ta takonit apo jo?

20 PË. Sigurisht.

21 PY. Të martën ju thatë që në korrik '98-s e keni takuar një
22 herë z. Krasniqi në fshatin Javor.

23 PË. Po.

24 PY. Bashkë me z. Krasniqi jeni takuar prapë në një rast
25 tjetër kur keni shkuar të takoni civilët që ishin zhvendosur

1 nga shtëpitë e tyre në Grykën e Shalës. Të kujtohet që fole
2 dhe për këtë rast dhe thatë që ishte z. Krasniqi dhe z. Thaçi
3 në këtë rast atje?

4 PË. Po, më kujtohet.

5 PY. Prokurori ju pyeti nëse ju kujtohej ndonjë rast tjetër
6 kur jeni takuar me z. Krasniqi në korrik dhe qershor '98-s dhe
7 ju thatë se nuk ju kujtohet asnjë rast tjetër. Tani unë dua ta
8 konfirmojmë edhe një herë. Në qershor dhe në korrik të '98-s
9 shumë pak herë jeni takuar me z. Krasniqi, apo jo?

10 PË. Me z. Krasniqi jam takuar në qershor kur ka dalë zëdhënës
11 i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe sa më kujtohet edhe
12 rasti i dytë ka qenë në grykën e Shalës kur kemi shkuar me
13 popullatën civile.

14 PY. Gjatë dëshmisë në çështjen Limaj, por edhe dje, ju
15 treguat për një rast kur e kanë ndaluar vëllain tuaj në
16 qershor ose korrik të '98-s në një postbllok, thatë ju. Ju
17 kujtohet që folët për këtë?

18 PË. Po.

19 PY. Vëllai për të cilin po flisni ju është Ramë Buja, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Dje i thatë Trupit Gjykues se kur e ndaluan vëllain, ai
22 ishte rrugës për në Negroc që të takohej me z. Krasniqi.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kjo është e reflektuar në
24 transkript në faqet 8, 9, rreshtat 20 e më tej, i datës 6
25 nëntor.

1 PY. A ju kujtohet që e thatë këtë?

2 PË. Po.

3 PY. Tani unë dua të lexoj atë që i keni thënë TPNJ-së, sepse
4 është disi e ndryshme nga ajo që kemi dëgjuar dje.

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem të vendoset në
6 ekran materiali IT-03-06 T4002 deri në 4087, faqen 4033. Në
7 anglisht është faqja 33 e PDF-së. Shqipja është me numër IT-
8 03-66 9 mars 2005 Pjesa 2, faqja 2, rreshtat 5 deri në 21.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, ky
10 është një dokument që ka aktualisht numër provizor prove me
11 numër P01821.

12 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

13 PY. Po lexoj nga rreshti 7 tek anglishtja. Kështu keni thënë
14 ju:

15 "Unë mund të marr shumë shembuj, por ndër shembujt që më
16 kujtohen më së mirë është ndalja e vëllait tim, i cili kishte
17 ardhur për vizitë në ato territore dhe e kanë ndalur ushtarët
18 dhe nuk e kanë lëshuar për një periudhë kohore një apo dy
19 orëshe. Dhe unë pas arritje atje, edhe unë kam filluar të
20 dyshoj në thëniet e tij që po pretendonte të takonte Jakup
21 Krasniqin në Negroc. Dhe ky ishte dyshimi se si mund ta dinte
22 vëllai im vendqëndrimin e Jakup Krasniqit, kur unë nuk e dija
23 se ishte në Negroc. Vëllai im jetonte dhe punonte në
24 Prishtinë, dhe kjo ishte për mua e pakuptimtë. Pas sqarimeve
25 të tij pas një periudhe dy-tre orëshe, se ai nuk e dinte se

1 Jakup Krasniqi ishte në Negroc, por e dinte se ishte
2 vendndodhja apo vendlindja e Jakup Krasniqit dhe mund të
3 informohej nga familja e tij se ku ndodhej ai.”

4 Ju kujtohet Dëshmitar që e keni thënë këtë, z. Buja?

5 PË. Po.

6 PY. Pra vëllai juaj nuk po shkonte në Negroc të takohej me z.
7 Krasniqi, por po shkonte në Negorc të kërkonte për z. Krasniqi
8 ose të pyeste se ku ndodhej ai. A pajtoheni me mua?

9 PË. Po, kështu ka qenë.

10 PY. Ju personalisht, apo dhe vëllai juaj në atë kohë nuk e
11 dinit se ku ndodhej z. Krasniqi, por ju besonit se mund të
12 ishte në Negorc, ose më së paku familja e tij do ta dinte,
13 kështu?

14 PË. Vëllau im besonte se mund ta dija, po mund të marr
15 informacionin te familja e tij në Negroc. Po z. Buja, Ramë
16 Buja, e as unë nuk e kemi ditur vendqëndrimin e Jakup
17 Krasniqit dhe kjo ka qenë dhe arsyeja e ndaljes për disa orë
18 të z. Ramë Buja.

19 PY. Po a pajtohemi ju me mua atëherë që z. Krasniqi udhëtonte
20 gjatë të gjithë kohës sepse njihej me zë dhe me fytyrë dhe nuk
21 ishte e lehtë për askënd në UÇK që ta kontaktonte apo të
22 takohej me të, e veçanërisht në korrik të '98-s ka pasur
23 luftime të mëdha.

24 Z. PACE: [Përkthim] Është shumë e paqartë kjo pyetje e
25 Prokurores, e avokates - më falni. S'e kuptoj si mund të

1 përgjigjet dëshmitari.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja është
3 shumë e përbërë. Zbërthejeni.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, duke qenë se z. Krasniqi njihej me zë dhe me
6 fytyre, ai ishte në rrezik, apo jo?

7 PË. Sigurisht që ishte në rrezik.

8 PY. Dhe për këtë arsye ai lëvizte shpesh, apo jo?

9 PË. Kjo ka qenë njëra nga arsyet, sigurisht.

10 PY. Në korrik të '98-s ka pasur luftime të mëdha, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe kjo ka qenë përreth Negrocit, apo jo?

13 PË. Ka qenë komplet një vijë e sulmeve nga Gryka e

14 Llapushnikut deri në Grykë të Carralevës.

15 PY. E për këtë arsye ishte shumë e vështirë për anëtarët e
16 UÇK-së të takoheshin me njëri-tjetrin apo edhe të komuniknin
17 me njëri-tjetrin, apo jo?

18 PË. Po, ka qenë e vështirë.

19 PY. Flasim tani për bisedat që keni bërë ju me z. Krasniqi në
20 atë kohë. Ju më herët na thatë se keni pasur marrëdhënie
21 familjare me z. Krasniqi para luftës, kështu ka qenë?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe kur folët, kur keni fol me z. Krasniqi, në ato pak
24 raste në qershor dhe korrik të '98-s kryesisht këto ishin
25 biseda familjare, kështu?

1 PË. Po, kemi pas dhe biseda të shumta familjare.

2 PY. Dhe keni diskutuar dhe i keni biseduar si dy njerëz të
3 barabartë brenda UÇK-së të cilët po përpiqeshin të bënë të
4 pamundurën në ato rrethana, apo jo?

5 PË. Po, në atë kohë kështu ka qenë.

6 PY. Gjatë bisedave ju nuk e keni informuar z. Krasniqi për
7 ndalim, keqtrajtim të personave, apo jo?

8 PË. Jo. S'kam pas -- unë s'kam ndaluar, as keqtrajtuar dhe
9 s'kam pas arsye ta njoftoj z. Krasniqi.

10 PY. Në rregull. Tani duam të flasim për emërimin tuaj si
11 komandant i zonës së Nerodimës, siç na thatë ju. I keni thënë
12 TPNJ-së se z. Krasniqi është ai që ju informoi se ju kishte
13 emëruar Shtabi i Përgjithshëm në këtë pozitë. Të kujtohet kjo.

14 PË. Po.

15 PY. Ta sqarojmë pak këtë. Nëse ka ndodhur kjo bisedë me z.
16 Krasniqi, ju e dini apo e dinit që z. Krasniqi nuk ishte
17 personi që ju emëroi po thjesht personi që ju përcolli
18 mesazhin, kështu?

19 PË. Z. Krasniqi ka qenë zëdhënës dhe njeri vetëm i Ushtrisë
20 Çlirimtare të Kosovës që ka qenë publik, dhe edhe komunikimin
21 e emërimi, apo ndonjë udhëzimit ka mundur të jetë përmes Jakup
22 Krasniqit.

23 PY. Por nuk është detyra e zëdhënësit të emërojë komandantët.

24 A kam të drejtë?

25 PË. Po, e drejtë është.

1 PY. Ju keni thënë para TPNJ-së se kur hytë në Kosovë në mars
2 '98-s filluat për zhvillimin dhe koordinimin e territorit nga
3 Lipjani deri në Ferizaj e më tutje në Kaçanik, kështu?

4 PË. Po, kam vepruar në atë terren.

5 PY. Në muajt pra, prill, maj dhe qershor, kjo ka qenë
6 veprimtaria juaj kryesore, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe më pas të gjitha këto vende u bënë pjesë e nënzonës
9 së Nerodimës, apo jo?

10 PË. Me përjashtim të Lipjanit të cilën nuk ishte pjesë e
11 zonës operative të Nerodimës edhe pjesa ku ishin njësitet
12 guerile, Pjetërshticë, Krojmir, Fushticë dhe Shalla.

13 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, vendosni në ekran
14 materialin 03769-03-TR-ET anglisht. Shqipja është me numër
15 039769-03 faqja 8. Në anglisht duhet të shohim faqen 9. Tek
16 anglishtja tek rreshti 21, 4 deri 17 shqipja.

17 PY. Po ua lexoj z. Buja. Sipas kësaj ju keni thënë:

18 "... në atë kohë unë kam qenë koordinator i tre zonave,
19 Shtimje, Ferizaj dhe Kaçanik, dhe në atë kohë kam organizuar
20 dhe veprimtaritë brenda UÇK-së. Dhe për shkak të të kësaj, u
21 bëra komandant i nënëzonës, sepse fillimisht zona e Nerodimës
22 ishte një nënëzonë."

23 Ju kujtohet kjo?

24 PË. Po.

25 PY. A pajtoheni atëherë me mua që ju në fakt nuk është se

1 jeni emëruar në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por thjesht
2 ishte një zyrtarizim i punës që ju kishit ndërkohë tre muaj që
3 e kryenit, apo jo?

4 PË. Po, mund të thuhet edhe ashtu.

5 PY. I keni thënë TPNJ-së në 2003 se kur të treguan për
6 formalizimin e emërimit tuaj ende ishin të papërkufizuara
7 gjërat:

8 "... çdo gjë ishte e papërkufizuar, çdo gjë ishte e
9 paqartë."

10 A ju kujtohet kjo?

11 PË. Po.

12 PY. Dje konfirmuar se në atë kohë ju informuan për emërimin
13 por nuk e dinit kush do të ishte shtabi, çfarë përgjegjësish
14 do të kishit dhe çfarë territori do të kishit në përgjegjësinë
15 tuaj?

16 PË. Po, është e vërtetë.

17 PY. Pra, e thënë ndryshe, me fjalë të thjeshta, ju dinit që
18 ishte një ide për të ndarë Kosovën në nënzona dhe për shkak se
19 kishit vepruar më parë në zonën mes Lipjanit dhe Kaçanikut, ju
20 do të emëroheshin si përgjegjës për këtë territor, por nuk ju
21 dhanë hollësi të mëtutjeshme për këtë, saktë?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. I keni thënë TPNJ-së se pas emërimit tuaj, si komandant i
24 nënzonës, keni marrë udhëzime nga Azem Sylja dhe Sokol Bashota
25 të cilët kanë qenë të përfshirë në organizimin e UÇK-së. A ju

1 kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

2 PË. Nuk po më kujtohet po prej Azem Sylës sigurisht kam marrë
3 urdhrin.

4 PY. Në rregull. Nga gushti i '98-s ju keni marrë udhëzime nga
5 Bislím Zyrapi, apo jo?

6 PË. Në fund të korrikut dhe në fillimin të gushtit, sigurisht
7 nga shefi i shtabit.

8 PY. Këta janë personat të cilët ju kanë dhënë ju udhëzime dhe
9 këshilla sa i takon organizimit dhe komandës të nënzonës dhe
10 funksionimit të njësiteve. A është e saktë kjo?

11 PË. Po.

12 PY. A ju kuptojmë drejtë, z. Buja, që ajo çfarë ju ka
13 komunikuar z. Krasniqi që ju u caktuat në zonën e Nerodimës,
14 por kjo ndodhi vetëm thjesht sa i takon komunikimit, por
15 ndërkohë personat e tjerë që ju kanë dhënë udhëzime dhe
16 këshillime si të bëhet organizimi ka qenë Sokol Bashota dhe
17 Azem Sylá. A është e saktë kjo?

18 PË. S'po e di për Sokol Bashotën, po Azem Sylá dhe Bislím
19 Zyrapi.

20 PY. Kurdo që ka qenë mundësia që të raportoni sa i takon
21 përparimit, avancimit të organizimit, ju i keni raportuar
22 këtyre personave, i keni përditësuar këta persona lidhur me
23 zhvillimet. A është e saktë kjo?

24 PË. Ka qenë një periudhë kur në mes gushtit kam udhëtuar për
25 Shqipëri dhe pastaj është shkëputur kjo mundësi e imja për të

1 zgjeruar apo për të organizuar nënzonën operative të

2 Nerodimës.

3 PY. E qartë. Faleminderit. Tani do të kalojmë tek grupi i

4 personave me të cilët jeni hasur në traktor në afërsi të

5 fshatit të Krojmirit, rreth datës 23 ose 24 korrik. Do flasim

6 për këtë temë. Pra, në vitin 1998. Ju flisni për këtë takim në

7 vitin 2003, 2005 dhe keni folur dhe gjithashtu përpara këtij

8 Trupi Gjykses dhe. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

9 PË. Nuk e kuptova për cilën [E padëgjueshme].

10 PY. A ju kujtohet që të keni folur për faktin që jeni takuar

11 me disa njerëz në një traktor në fshatin e Krojmirit rreth

12 datës 23 ose 24 korrik 1998. Ju kujtohet kjo?

13 PË. Po.

14 PY.

15 PY. Në deklaratën e vitit 2003 përpara TPNJ-së ju keni thënë

16 që në atë kohë kishte një ofensivë serbe dhe që gjendja ishte

17 tërësisht kaotike. A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

18 PË. Po.

19 PY. Popullata civile po largohet në atë kohë nga zona, apo

20 jo?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe ju keni parë një traktor me një grup njerëzisht që po

23 shkonin tek pllaja, tek fusha në Krojmir dhe aty ju njohët

24 disa forca serbe të pozicionuara ose të stacionuara aty. A

25 është e saktë kjo?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Sipas mendimit dhe duke pas parasysh ofensivën në vazhdim
3 e sipër, ishte e rrezikshme që të vazhdoje të shkoje në atë
4 drejtim. A ishte kështu, Dëshmitar?

5 PË. Po, ka qenë e rrezikshme për të gjithë popullatën civil.

6 PY. Ju i paralajmëruat personat që ishin në traktor që kishte
7 forca serbe në atë drejtim, po ata insistuan që donin të
8 vazhdonin në atë drejtim dhe pastaj në fund ju i lejuat që ato
9 vazhdonin në drejtimin që donin. A është kështu, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Pasi i latë që të largoheshin ishit shumë të shqetësuar,
12 apo jo, që ngaqë i latë që të vazhdonin në atë drejtim dhe nga
13 fakti që forcat serbe ishin stacionuar atje, ju në fakt ishit
14 i shqetësuar se i lejuat të shkonin në një zonë që ishte e
15 rrezikshme dhe që ata mund të dëmtoheshin nga serbët. A është
16 kështu, Dëshmitar?

17 PË. Po, e thashë edhe dje.

18 PY. Më pas ju folët me shumë veta të tjerë me shumë persona
19 të tjerë për të marrë garanci për veten tënde, që ajo çfarë
20 bëre ishte e saktë, ishte e drejtë. A është e saktë kjo,
21 Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Dëshmia juaj është që një prej shumë personave me të
24 cilët ju folët ishte z. Krasniqi, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Atëherë, në qoftë se kjo është e vërtetë, biseda që keni
2 pasur me personat në traktor, që e keni bërë pastaj me z.
3 Krasniqi, ishte që thjesht ju i keni thënë që jeni ndjerë keq.
4 Nuk është se i ke ndaluar ato ose nuk është se ke bërë ndonjë
5 gjë tjetër për të ndaluar rrezikun që i paraqitej atyre.

6 Thjesht kaq keni thënë në këtë bisedë, apo jo, Dëshmitar?

7 PË. Ky ishte shqetësimi im sepse kishin ndodh masakra ma
8 herët dhe isha i shqetësuar sepse unë kisha marrë vendimin për
9 t'i liruar për të ecur në pjesën e rrafshit ku ishin të
10 stacionuar forcat serbe.

11 PY. Do të kaloj te një temë tjetër tani, z. Buja. Më herët
12 sot i konfirmuat z. Dixon se u kthyet në Kosovë diku nga marsi
13 i vitit 1999 pas fillimit të bombardimeve të NATO-s. A është e
14 saktë kjo?

15 PË. Po.

16 PY. Në fund të shkurtit të '99-s kur nuk keni qenë në Kosovë,
17 forcat serbe kanë pasur një ofensivë shumë të ashpër në zonën
18 e Kaçanikut. A është e saktë kjo?

19 PË. Nuk e kuptova, më sqaroni.

20 PY. Po flas për periudhën rreth fundit të shkurtit '99-s, e
21 di që nuk keni qenë në Kosovë në atë periudhë. Megjithatë po
22 ju pyes a jeni në dijeni që forcat serbe kishin nisur një
23 ofensivë të ashpër në zonën e Kaçanikut në atë kohë? E kam
24 fjalën dhe një herë për shkurtin e '99-s, Dëshmitar.

25 PË. Po.

1 PY. Më 28 shkurt ka pasur një sulm serb në Puset e Nikës, apo
2 jo? Pusin e Nikës. Ka ndodh kështu apo jo?

3 PË. Nuk më kujtohet data e saktë, po ka pas dhe sulm në
4 Pustenik dhe në fshatrat e Kaçanikut.

5 PY. Kjo ofensivë vazhdoi më tej edhe me 8 mars 1999. Forcat
6 serbe u futën në fshatin e Ivajës. A ka ndodhur kështu,
7 Dëshmitar?

8 PË. Po, kështu ka ndodhur.

9 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
10 paraqesë në ekran dokumentin IT-05-87.1, që është prova
11 P01029, në faqen 52 të versionit në PDF. ERN-ja është 0352529
12 [Sipas përkthimit]. Ju lutem paraqisni faqen 52 edhe në shqip
13 edhe në anglisht.

14 PY. Dëshmitar, ky është një dokument i OSBE-së dhe i Misionit
15 Verifikues të Kosovë ku përshkruhen ngjarjes e fillimit të
16 marsit të '99-s në zonën e Kaçanikut.

17 Besoj që mund të shikoni përpara jush një hartë e
18 Kaçanikut edhe disa zona të cilat janë të shënuara në mars të
19 '99-s. E shihni këtë, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Në kutinë e parë thuhet në të majtë:

22 "Në orën 9.05, UÇK-ja raporton VAZHDOJ/MUP-i ka sulmuar
23 fshatin Strazh dhe ka garantuar fshatin Ivajë. Në orën 14.00
24 raportoj se Strazha po digjej."

25 A e shikon këtë, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 PY. Kutia nga njëri -- nga 1 deri te 4 përshkruhen luftime.

3 Pastaj te kutia në të majtë vazhdon dhe përshkruhet më tej

4 situata duke shkruar si më poshtë:

5 "Në orën 1612 luftimet në zonën e Kaçanikut po qetësohen.

6 Verifikimi i këtyre luftime nuk ishte i mundur meqë VJ/MUP-i

7 ka bllokuar qasjen në këto zona."

8 A pajtoheni me mua z. Buja, se ky dokument po thotë se

9 ishte e pamundur që të kishte qasje në zonën e Kaçanikut në

10 këtë periudhë. Pajtoheni me mua lidhur me këtë?

11 PË. Po.

12 PY. Të përqendrohemi tek harta që keni në ekran. A shikoni në

13 cep në të djathtë disa simbole, pra simbolet në fund të faqes

14 a i shikoni që janë kolonat e gjata, rrugë të mbyllura dhe

15 shënjestra kryesore për të shtënë? I shikon këto?

16 PË. Po.

17 PY. Nëse shohim hartën, do vëmë re që ka kolona të ushtrisë

18 serbe në zonën e Kaçanikut deri në kufi me Maqedoninë. E

19 shikoni këtë, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Në qoftë se do të shikojmë, për shembull, shënjestrat e

22 luftimeve, për shembull, shikojmë që ka grantime në Kaçanik,

23 Ivajë, Strazhë, Glloboçicë edhe Pustenik. A është e saktë kjo,

24 Dëshmitar?

25 PË. Po. Mesa po e shoh edhe Gajrën.

1 PY. Nëse shohim rrugët që janë bllokuar, shohim që rruga
2 midis Bobit, Gajres dhe Ivajrës [Sipas përkthimit] janë
3 mbyllur nga forcat serbe. A është kështu, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Gjithashtu edhe rruga nga Pusteniku në kufi që shkojnë
6 drejt Ivajës janë mbyllur, të paktën sipas kësaj harte, apo
7 jo?

8 PË. Po.

9 PY. Pra, territori përreth Ivajës ka qenë tërësisht i
10 izoluar. Askush nuk mund të futej në territoret dhe askush nuk
11 mund të dilte prej tij. A është e saktë kjo?

12 PË. Po, e saktë.

13 PY. Këto fshatra kanë qenë në shënjestër të vazhdueshme për
14 granatime, apo jo?

15 PË. Po, para se të sulmonin me forca tokësore bënin
16 granatime.

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të kalojmë tani në faqen
18 03525246. Në faqen 56 [Sipas përkthimit] të versionit në PDF.

19 PY. Ky është një raport lidhur me ngjarjet e 9 marsit të
20 vitit 1999. Në raport thuhet si më poshtë:

21 "Vazhdon operacioni i Armatës Jugosllave/MUP-it për
22 spastrimin e zonës nga UÇK-ja. Zonës së Hanit të Elezit.
23 Fillimisht patrullat e KVM-së janë bllokuar nga kalimi në
24 fshatrat e prekura. Pastaj forcat e Armatës Jugosllave/MUP-it
25 vazhduan sipas taktikës së tyre të rrethimit të fshatrave

1 lokalë duke detyruar banorët të ikin përmes përdorimit të
2 drejtpërdrejtë ose të tërthortë të armëve të zjarrit. Deri në
3 mes të pasdites shtëpitë në fshatrat Gajre ... Ivajë ...
4 Strazhë dhe Alil Mëhallë ishin në flakë. Dukej se njësitë e
5 MUP-it kishin për qëllim shkatërrimin e këtyre fshatrave.”

6 Kështu thuhet në këtë dokument. A pajtoheni me këtë
7 përshkrim, Dëshmitar?

8 PË. Po, kështu ka qenë.

9 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të kalojmë tani në faqen 56
10 të versionit në PDF që ka numrin 035250 [Sipas përkthimit].

11 PY. Këtu shohim një hartë tjetër të Kaçanikut me kuti të
12 tjera ku përshkruhen ngjarjet e datës 9 mars 1999. A i shikon
13 kutitë edhe hartën e Kaçanikut, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 PY. Sipas kutive në të majtë, armata jugosllave dhe MUP-i
16 mohon qasjen për shkak të arsyeve të sigurisë. A është e
17 vërtetë kjo? Është kështu?

18 PË. Po, kështu ka vepruar ushtria jugosllave.

19 PY. Sipas kutisë 3, fshatarët ishin larguar nga luftimet, apo
20 jo?

21 PË. Po, janë larguar në për male.

22 PY. Thuhet gjithashtu që ka rreth 500 fshatra në mes të Bobit
23 dhe Ivajës të cilat kanë ikur drejt veriut. A ka qenë kështu?

24 PË. Kështu që [E pakuptueshme].

25 PY. Në qoftë se do të kalojmë këtë tek kutia 4, thuhet që

1 shtëpitë në Gajre dhe në Ivajë ishin nën zjarr.

2 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë, të nderuar Gjykatës. U
3 bë ca kohë që dëgjojmë këto pyetje kështu që është e
4 rëndësishme që Avokatja të shpjegojë se cila është relevanca e
5 këtyre pyetjeve.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, keni të
7 drejtë. Çfarë relevance kanë këto pyetje?

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kjo ka ndodhur në kohën kur
9 pretendohet që të kenë ndodhur krime, kështu që unë po
10 përpiqem që ta bëj të qartë se cila ka qenë situata në atë
11 kohë sipas këtij raporti.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që e
13 keni bërë të qartë.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Mirë, në këtë rast atëhere
15 kërkoj që të pranohet dokumenti si provë.

16 Kërkoj që të pranohet si provë të tri faqet e diskutuara.

17 Faqet janë 52, 55 dhe 56 e versionit në PDF të këtij
18 dokumentit në ekran.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtim?

21 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
23 dokumenti IT-05-87.1 P01029 në faqen 52, 55 dhe 56 pranohen në
24 prova gjyqësore.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të

1 nderuar Gjykatës. këto faqe do të marrin numrin e provës
2 4F00096. Do i kërkoja avokates që të sqarojë klasifikimin
3 sepse përkthimi në shqip është i klasifikuar si publik,
4 ndërkohë që versioni i dokumentit në anglisht, domethënë
5 origjinali në anglisht është i klasifikuar si konfidencial.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjitha
7 faqet duhet të riklasifikohen si publike.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

9 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

10 PY. Faleminderit z. Buja. Nuk kam pyetje të tjera për ju.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
12 znj. Alagendra.

13 A ka pyetje plotësuese?

14 Z. PACE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. në qoftë se
15 doni mund të filloj tani ose mund të filloj pas pushimit, si
16 të më thoni ju.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Filloni tani.

18 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin që është në
19 ekran së pari.

20 Pyetje vijuese nga z. Pace:

21 Z. PACE: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, dje, dhe e kam fjalën konkretisht për faqen
23 22080, rreshti 24 deri në faqen 22081, rreshti 4; në
24 transkriptin në kohë reale në faqen 69 rreshtat 14 deri në 19,
25 juve ju bëtë kjo pyetje dhe dhatë këtë përgjigje gjatë

1 pyetjeve plotësuese:

2 "PY. Ju udhëtuat në Shqipëri me Hashim Thaçin, ndërmjet
3 personave të tjerë, apo jo?

4 "PË. Po, është e saktë.

5 "PY. Ju nuk e dinit që ai ishte anëtar i Shtabit të
6 Përgjithshëm ose Shtabit Qendror në atë kohë, apo jo?

7 "PË. Jo. Në atë kohë LPK-ja kishte një sektor
8 ndërlidhjeje."

9 PY. Dëshmitar, kush ishte i përfshirë në sektorin e
10 ndërlidhjes së LPK-së?

11 PË. Në sektorin e ndërlidhjes së LPK-së nëse e kujtoj saktë
12 kanë qenë Xhavit Haliti, Ali Ahmeti dhe Emrush Xhemajli.

13 PY. Çfarë roli ka pasur sektori dhe personat që sapo
14 përmendët ju?

15 PË. Nuk e di saktë, po e di që përmes këtij sektori ne kemi
16 hynë në Kosovë.

17 PY. Çfarë doni të thoni që përmes këtij sektori keni hyrë në
18 Kosovë? Mund të na e shpjegoni pak?

19 PË. Po ky sektor ka qenë përgjegjës për organizimin e hyrjes
20 tonë në Kosovë dhe të transportit të vijës se ka do të
21 depërtojmë në Kosovë e çështje të tjera.

22 PY. Më herët sot, e kam fjalën konkretisht për faqen 12,
23 rreshtat 9 deri në faqen 13, rreshti 18 për transkripti e
24 ditës së sotme, ju bën pyetje për Ilmi Reçikën [Sipas
25 përkthimit] dhe raportimit të tij. Pyetjet dhe përgjigjet janë

1 si më poshtë:

2 "PY. Ky informacion që ju është dhënë ju, ky informacion
3 ju është dhënë për shkak të pozicionit tuaj si komandant i
4 zonës, apo jo?

5 "PË. Po. Ishte detyre e tij që të raportonte përpara
6 shefit të shtabit edhe komandantit të zonës.

7 "PY. Pra, ishte për përdorimin tuaj në zonë në mënyrë të
8 tillë që t'ju ndihmonte për operacionet dhe për Mbrojtjen.

9 "PË. Absolutisht po.

10 "PY. Ju nuk i keni përcjellë informacion askujt në
11 Shtabin e Përgjithshëm apo jo?

12 "PË. Jo. sa i takon raportimeve, jo. nuk është se kemi
13 përcjellë raportime."

14 Pra, ju dëshmuat më herët që ju nuk e keni përcjellë të
15 paktën raporte zbulimi në Shtabin e Përgjithshëm, por a keni
16 marrë ju raporte nga shërbimi i zbulimit të UÇK-së,
17 pavarësisht që nuk keni dhënë raporte për shërbimin e
18 zbulimit?

19 PË. Me sa më kujtohet, jo.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më
21 lejoni dëshiroj t'i tregoj një pjesë të një dëshmie të
22 mëparshme të dëshmitarit, në pajtim me rregullën 143(2)(b)(c).

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
24 vazhdoni.

25 Z. PACE: [Përkthim] Për këtë kërkuj që të paraqitet në

1 ekran dokumenti SIT0023748-0022844 [Sipas përkthimit]. Dhe
2 konkretisht dua të paraqitet faqja SITF0022787 [Sipas
3 përkthimit] rreshtat 10 deri në 19. Në versionin në shqip
4 dokumenti mban numrin IT-02-54 20020606-TR-ET [Sipas
5 përkthimit], faqja 7, rreshtat 9 deri në 20.

6 PY. Ndërkohë që paraqitet dokumenti, Dëshmitar, unë do t'ju
7 lexoj një pjesë të pyetjeve dhe përgjigjeve që ju janë bërë
8 juve në vitin 2002 në gjykimin kundër Milosheviqit.

9 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull.

10 PY. Do lexoj pyetjen dhe përgjigje se pastaj kam pyetje për
11 juve. Gjykatësi May ju pyet:

12 "A mundët t'i afroshetit Reçakut gjatë këtij sulmi?"

13 Ju përgjigjeni:

14 "Jo, për shkak se nga raporti që më është bërë nga
15 zëvendëskomandanti kanë hasur në zjarr të madh, dhe sipas
16 informacioneve që kishte inteligjencë servisi i UÇK-së, kishte
17 forca të shumta të policisë që kishin sulmuar në atë kohë në
18 këtë drejtim. Dhe diku sipas informacioneve të tyre ishin
19 rreth 600 këmbësorë që e mbronin pjesën e pozicionit që i
20 kishin zënë forcat serbe. Prandaj ka qenë shumë e vështirë
21 përparimi përpara se është lëshuar urdhri tjetër që të mbetet
22 në vend dhe të mbrojnë grykën e Lushakut për të cilën kam
23 sqaruar dje se ka qenë jetike për komandën e zonës."

24 Dëshmitar, si e keni mësuar përmbajtjen e raportit nga
25 shërbimi që ju e quani shërbimi "inteligjent servis" i UÇK-së?

1 Nga e keni marrë vesh situatën nga ky shërbim, Dëshmitar?

2 PË. Unë e sqarova. Shërbimi kundërzbulimi dhe zbulimit i
3 zonës operative të Nerodimës është dashtë të raportojë për
4 lëvizjen e forcave për rrezikshmërinë nga forcat serbe dhe
5 normalisht që ky këtu po quhet "inteligjent servisi", zbulim-
6 kundërzbulimi i UÇK-së i zonës time unë kam marrë raportin se
7 ka lëvizje të forcave. Këtu po thuhet 600 këmbësorë që mbronin
8 pozicionet që i kishin zënë forcat serbe. Fjala është për
9 inteligjent servisin apo zbulim-kundërzbulimin e zonës të
10 cilën e kam komanduar unë.

11 PY. Sikurse e pamë përpara një minuti më herët sot, ju thatë
12 që nuk i keni përcjellë informacion zbulim-kundërzbulim
13 Shtabit të Përgjithshëm. A i keni përcjellë informacion për
14 ndonjë temë apo çështje tjetër Shtabit të Përgjithshëm të UÇK,
15 Dëshmitar?

16 PË. po, i kam raportuar në periudhë ma të vonshme, edhe ka
17 qenë raporte që i kemi dërguar shefit të shtabit, raporte
18 përmbledhëse për zhvillimin e luftimeve apo betejave dhe i
19 kemi raportuar edhe për gjendjen strukturore dhe nevojën apo
20 mungesën e armatimeve dhe materiale logjistike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, do
22 të bëjmë pushimin e paradites sot.

23 Z. PACE: [Përkthim] Patjetër.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
25 bëjmë një pushim për 30 minuta tani. Mund të dilni nga salla e

1 gjyqit së bashku me Asistenten. Do shihemi përsëri në sallë në
2 orën 11.30.

3 DËSHMITARI: Faleminderit.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
6 pushim deri në orën 11.30.

7 --- Pauza fillon në orën 11.03

8 --- Seanca rifillon në orën 11.31

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
10 sillni dëshmitarin në sallë.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
13 vazhdoni me pyetjet tuaja plotësuese.

14 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

15 Ju lutem, hiqni nga ekrani dokumentin.

16 PY. Dëshmitar, përpara pushimit bëme këtë shkëmbim:

17 "PY. Sapo pamë para një çasti, sot ju keni thënë se nuk
18 keni kaluar, nuk i keni përcjellë raporte të zbulimit UÇK-së,
19 shtabit të UÇK-së. A i keni kaluar raporte të tilla UÇK-së në
20 raste të tjera?"

21 Jeni përgjigjur:

22 "Po, kam raportuar në një fazë të mëvonshme. Këto kanë
23 qenë përmbledhje, raporte përmbledhëse që i përcilleshin
24 shefit të shtabit për operacionet, luftime, veprime, mungesën
25 e armëve, municioneve dhe aspekte të tjera logjistike."

1 Pra, në përgjigjen tuaj përpara pushimit ju thatë që keni
2 raportuar lidhur me operacionet dhe veprimtaritë në luftime,
3 gjatë luftimeve. Po në këto raporte përfshinit informacione ju
4 për pozicionet e armikut?

5 PË. Po. Në atë kohë, ne përveç raporteve të shefi i shtabit
6 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ne i kemi njoftuar edhe
7 ekipet vëzhguese për shkak se pozicionoheshin forcat serbe dhe
8 shkelej Marrëveshja Holbrooke-Milosevic, do të thotë, në këto
9 raporte janë përfshi edhe brigadat.

10 PY. Të jemi të qartë, përpara se keni -- përpara se të
11 informonit këto ekipe për pozicionet e armikut, i njëjti
12 informacion a përfshihej në raportet dhe për shefin e shtabit?
13 Do ta bëj më saktë pyetjen. Pra, këto raporte a i shkonin dhe
14 shefit të shtabit të Shtabit të Përgjithshëm?

15 PË. Unë nga këto raporte që më vinin nga brigadat, nga
16 sektorët, bëja një raport përmbledhës për shefin e shtabit dhe
17 kryesisht këto raporte janë dhënë përmes lidhjes satelitore
18 telefonike sepse kemi pas vështirësi të takimit të
19 drejtpërdrejtë.

20 PY. A mbani mend të keni bërë raporte me shkrim për ndonjë
21 person në Shtabin e Përgjithshëm për aspekte që lidheshin me
22 zonën?

23 PË. Kryesisht me shefin e shtabit kemi pas.

24 PY. Me shkrim apo vetëm me gojë?

25 PË. Tani s'më kujtohet a kam bërë me shkrim ndonjëherë, po

1 raportet me shkrim janë dhënë përmes lidhjes telefonike, do të
2 thotë edhe në qoftë se s'kemi mujt me i dërgu raportin me
3 shkrim.

4 PY. Mesa ju kujtohet kur keni filluar t'i dorëzoni këto
5 raportet përmbledhësi siç i quani ju?

6 PË. Edhe një herë se s'e kuptova?

7 PY. Pra, ju thatë që më vonë dërgonit raporte tek Shtabi i
8 Përgjithshëm në formë përmbledhëse, raporte përmbledhëse, një
9 përmbledhje. Kur, nga pikëpamja kohore, kur keni filluar t'i
10 dorëzoni këto raporte?

11 PË. Nëse nuk gaboj, nga diku fundi i janarit të 1999.

12 PY. Po raportet me shkrim, nëse keni dërguar raporte me
13 shkrim, kur keni filluar t'i dërgoni për shefin e shtabit apo
14 për ndonjë person tjetër në Shtabin e Përgjithshëm?

15 PË. Te shefi i shtabit sepse detyra e komandantëve të zonave
16 ka qenë me shefin e shtabit. Raporte me shkrim s'po më
17 kujtohen kur kemi fillu apo kur kemi pas mundësi me i dorëzu
18 raporte me shkrim.

19 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj të shohim në ekran provën me
20 numër P00228 përbri provës P00228-ET, është pjesë e
21 materialeve që kemi ngarkuar ne për pyetjet plotësuese që
22 kemi. Faleminderit.

23 PY. Dëshmitar, në të majtë është shqipja dhe në të djathtë
24 anglishtja. Siç mund ta shihni vetë, në krye të dokumentit
25 thuhet Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Shtabi i Përgjithshëm,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Shukri Buja (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Pace

Faqe 59

1 Drejtoria Operative. Ka një numër: "G-3/33-19 më 28.12.1998."

2 Dhe më poshtë thotë:

3 "Raport mbi referimi e komandantëve të zonave operative
4 të UÇK-së

5 "- i dedikohet - zëvendëskomandantit të Shtabit të
6 Përgjithshëm të UÇK-së."

7 Shkojmë shpejt në faqen e fundit, shkurtimisht - më falni
8 - në faqen e fundit të dy dokumenteve. Këtu shohim nënshkrimin
9 poshtë titullit shefi i SHP-së së UÇK-së, kolonel Bislum
10 Zyrapit edhe vulën e UÇK-së.

11 Z. PACE: [Përkthim] Rikthehemi në faqen e parë.

12 PY. Siç mund ta shohim, në krye të dokumentit thuhet si në
13 vijim:

14 "Në bazë të urdhëresës për referim numër 82-1/111 e datës
15 11.12.1998, drejtuar komandantëve të zonave operative referimi
16 në fjalë është zhvilluar më 20.12.1998. Duke analizuar
17 referatet me shkrim të komandantëve të zonave të Dukagjinit,
18 Pashtrikut, Nerodimës, Shalës dhe Llapit... "

19 Dhe vazhdon dokumenti më poshtë.

20 Pra, Dëshmitar, siç e shohim këtu, këtu është përmendur
21 një referim me shkrim, referat me shkrim thotë nga disa
22 komandant zone, përfshirë zonën e Nerodimës në datën 20
23 dhjetor 1998. A ju kujton gjë kjo, ekziston mundësia që të
24 keni dorëzuar një referat me shkrim?

25 PË. Kjo s'po më kujtohet, po ka mundësi të kem dërguar.

1 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

2 PY. Dëshmitar, sot gjatë kundërpyetjeve të Avokates së z.
3 Krasniqi, ajo ju tregoi një deklaratë të mëhershme - e cila
4 është pasqyruar në transkriptin e ditës së sotme në faqen 35,
5 rreshti 22, faqja 36, rreshti 14 - do ta shohim dhe bashkë
6 deklaratën e mëparshme dhe më pas do t'ju bëj pyetje.

7 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem vendosim në ekran materialin
8 03976903-TR-ET, faqja 9, rreshtat 17 deri në 21.

9 PY. Do nxjerrim dhe një herë deklaratën në ekran dhe unë do
10 t'ju rilexoj pyetjet që ju lexoi Avokatja gjatë
11 kundërpyetjeve.

12 Z. PACE: [Përkthim] Në anglisht do lexoj nga faqja 9,
13 rreshtat 17 e deri në 21. Nuk e kam shqipen për momentin, po
14 janë vetëm dy fjali që do lexoj.

15 PY. Kjo është përgjigja që i keni dhënë ju një pyetjeje gjatë
16 kundërpyetjeve.

17 "... në atë kohë isha koordinator i tre zonave Kaçanik,
18 Ferizaj dhe Shtime me komandantët dhe në atë kohë kam
19 organizuar dhe veprimtaritë brenda UÇK-së dhe për shkak të
20 kësaj unë u bëra komandant i nënzonës së fillimisht Nerodima
21 ka qenë nënzonë."

22 Sot, Dëshmitar, pasi ua lexoj Avokatja këtë, u bë kjo
23 pyetje dhe përgjigje:

24 "PY. A pajtoheni me mua që ju nuk jeni emëruar në
25 kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por thjesht u zyrtarizua puna

1 që ju ndërkohë e kryenit në këtë zonë për tri muaj, kështu?"

2 Dhe ju u përgjigjët:

3 "Po, mund të thuhet dhe kështu", thatë ju.

4 Tani do shohim një pjesë tjetër të së njëjtën intervistë
5 por disa faqe më lart.

6 Z. PACE: [Përkthim] Në anglisht është faqja 5, rreshtat 6
7 deri në 16.

8 PY. Dëshmitar, është në të njëjtën intervistë që pamë pak më
9 herët, ju keni thënë kështu:

10 "Në përgjithësi, të gjitha vendimet janë bërë përmes
11 Shtabit Qendror. Shtabi Qendror vendoste për emërimin e
12 komandantëve. Besoj se kjo mund të respektohej për shkak të
13 veprimtarive politike dhe përvojës ushtarake. Po kjo ka ndodhë
14 në një fazë të mëvonshme kur UÇK-ja më në fund u organizua dhe
15 ... kishte një strukturë të mirë. Po në përgjithësi në fillim
16 të luftës u vendos në bazë të personave që kishin organizuar
17 njësitet dhe kështu me radhë, por më vonë u vendos me vendim
18 të Shtabit Qendror mbështetur në veprimtaritë politike, ai
19 beson edhe për shkak të përvojave ushtarake."

20 Përgjigja këtu a është e saktë?

21 PË. Nuk po shoh ndonjë dallim në përgjigjet e mia, sepse,
22 sigurisht, që unë kam supozuar se Shtabi i Përgjithshëm ka
23 vendosë në bazë të përvojës time politike dhe ushtarake. Dhe
24 meqë kam qenë në atë pjesë, kam koordinuar veprimet e
25 njësiteve guerile në bazë të asaj ka marrë vendimin që unë të

1 jem komandant i nënzonës. E thashë që më është përcjellë

2 përmes zëdhënësit ky vendim.

3 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

4 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

6 z. Pace.

7 Gjykatësi Mettraux.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi

9 Smith.

10 Pyetje nga Trupi Gjykses:

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjesi, z. Buja.

12 PË. Mirëmëngjesi.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua të bëjmë disa sqarime

14 lidhur me pyetjet që ju ka bërë si Prokuroria, si Ekipet e

15 Mbrojtjes për kohën tuaj në Zvicër përpara qëndrimit. E

16 kuptoni?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Fillimisht unë do të doja

19 të na tregoni, nëse mundeni, kuptohet, a ju kujtohet data në

20 mars të 1998 kur u larguat nga Zvicra për të shkuar në Kosovë?

21 PË. Përafërsisht ka qenë 6, 7 marsi.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju na shpjeguat dhe, më

23 korrigjoni nëse nuk e kam kuptuar saktë, ju thatë që në këtë

24 kohë u larguat për shkak të ngjarjeve që po zhvilloheshin mes

25 datë 5 deri në 7 mars 1998 në shtëpinë e Jasharëve, kështu, në

1 banesën e Jasharëve?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju thatë se gjatë kohës që
4 ishit në Zvicër keni qenë i angazhuar me LPK-në deri në
5 momentin që u kthyet në Kosovë. E kam kuptuar saktë?

6 PË. Po, saktë.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në këtë angazhim, pra,
8 këtë angazhim e keni filluar rreth vitit 1995, kështu?

9 PË. Po mendoni në LPK?

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, në LPK.

11 PË. E njëjta organizatë ka qenë edhe LPRK-ja, vetëm emri ka
12 ndërru dhe angazhimi im në LPRK dikun 1993 apo 4 ka qenë. Jo,
13 më falni, ka qenë para 1990. Ka qenë në vitet 1980, do të
14 thotë, angazhimi im ka qenë ë vitin 1985, 1986.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Në fakt, nuk
16 ishte përgjigja juaj problemi. Unë doja të thoja, në fakt,
17 përfshirja juaj në Zvicër. Pra, në Zvicër jeni angazhuar me
18 LPK-në në 1995, apo jo?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e kam kuptuar unë saktë
21 që gjatë kohës që keni jetuar në Zvicër, keni jetuar në
22 qytetin Aargau?

23 PË. Kam jetuar në fshatin Koblenz në rrethinë e Baden, ndërsa
24 kam qenë anëtar i redaksisë në Aargau.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse ju kujtohet, kush ka

1 jetuar tjetër në atë pjesë të Zvicrës, flasim kush nga LPK-ja?

2 PË. Ka qenë edhe një anëtar tjetër i redaksisë, Haki Morina.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Azem Syla, a ka jetuar
4 dhe Azem Syla në të njëjtën pjesë të Zvicrës?

5 PË. Këtë nuk e di.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Emrush Xhemajli?

7 PË. Në Zvicër po, po jo në rrethinën e Aargau.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni jetuar afër njeri-
9 tjetrit?

10 PË. Me Emrushin, jo.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Ali Ahmeti?

12 PË. Nëse nuk gaboj, ka qenë rrethinën e Lausanne.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kadri Veseli?

14 PË. Nuk e di në atë kohë ku ka jetuar.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por në Zvicër ka qenë edhe
16 ai, apo jo?

17 PË. Po, në Zvicër ka qenë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Hashim Thaçi?

19 PË. Po, Hashim Thaçi ka qenë në Zvicër.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po një person me emrin
21 Avdyl Mexhid Karaga --

22 PËRKTHYESJA: Ju kërkojmë ndjesë, nuk e kemi kuptuar
23 mbiemrin.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Avdyl Mexhid Karaga?

25 PË. Jo, s'më kujtohet.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të themi që gjatë
2 kohës që keni qenë në Zvicër nga 1995 deri në 1998 takoheshit
3 rregullisht me personat e LPK-së, me anëtarët e LPK-së,
4 përfshirë emrat që sapo diskutuam, kështu?

5 PË. Kemi pas takime, mbledhje kur kemi pas, jemi takuar me
6 këta persona që u përmendën. Po pjesë e këtyre mbledhjeve,
7 mbledhjeve të përgjithshme -- më falni, këshillit të
8 përgjithshëm nuk kanë qenë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, por
9 nëse nuk gaboj, kanë qenë Ali Ahmeti, Emrush Xhemajli, Gafurr
10 Elshani e të tjerë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në gjendje ta
12 konfirmoni nëse komunikata e parë e UÇK-së është përgatitur në
13 Zvicër? Keni dijeni për këtë? Komunikata e parë e UÇK-së.

14 PË. Jo, nuk e di.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë kohës që keni qenë
16 në Zvicër thatë që keni qenë në redaksinë Zëri i Kosovës, a e
17 kam kuptuar unë drejt që ju keni qenë në bordin apo në
18 redaksinë e kësaj gazete nga 1996 deri në marsin e 1998,
19 kështu?

20 PË. Po, kam qenë në redaksi.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më herët ju thatë që Zëri
22 i Kosovës ka qenë shumë e lidhur me LPK-në dhe në një farë
23 mënyre ka qenë një derivat i LPK-së, kështu?

24 PË. Ka qenë organi zyrtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju e shpjeguat dhe, nëse

1 nuk e kam kuptuar saktë, ju lutem, lirisht më korrigjoni. Po
2 nga sa kuptova unë, ju thatë që LPK-ja ka qenë ombrella
3 politike e cila krijoi UÇK-në, prej asaj u krijua UÇK-ja. E
4 kam kuptuar drejt?

5 PË. Unë e thashë, LPK-ja ka qenë me vendim të këshillit të
6 përgjithshëm mbështetësja politike, propagandistike, materiale
7 dhe financiare.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po citoj fjalët e
9 intervistës që keni dhënë në 20 prill në 2003, në faqen 17 në
10 anglisht. Ju keni folur këtu për LPK-në dhe e keni përshkruar
11 si "ombrella politike mbulesa e UÇK-së", kështu?

12 PË. Po, kështu dhe mund të quhet. Por realisht në vendimin e
13 kemi pas të për ta mbështetur politikisht në aspektin material
14 dhe financiar. Do të thotë, kemi qenë në atë kohë kemi qenë
15 subjekti politik i vetëm që e ka mbështetë, ma vonë është
16 mbështetur edhe nga subjekte tjera.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Mikrofondi çaktivizuar].

18 [Përkthim] Ju kërkohet ndjesë.

19 Ju i thatë z. Misetic dhe mua shkurtimisht para një çasti
20 dhe thatë se emri i organizatës, i organizatës politike u
21 ndryshua edhe nga LPRK u bë LPK dhe, në fakt, u hoq thjesht
22 germa R që ishte për "republikë", germa që simbolizonte
23 republikën, kështu?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të them

1 se R-ja u hoq rreth vitit 1991 pasi kuvendi i Kosovës lëshoi
2 deklaratën për pavarësi, është e drejtë?

3 PË. Këtë nuk e di, se në këtë periudhë kam qenë në burg në
4 Serbi.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani kam disa pyetje për
6 mënyrën sesi ka qenë e organizuar LPK-ja dhe, sigurisht, mund
7 të përgjigjeni nëse e dini. A është e vërtetë që në çdo vend
8 që vepronte LPK-ja Zvicra, Austria, Gjermania e shtete të
9 tjera, pra, në secilin prej këtyre shteteve kishte një këshill
10 të përgjithshëm të LPK-së?

11 PË. Po, ka pas nëndegët e saj të shtrime nëpër shtete
12 evropiane dhe ne kemi qenë këshilli i përgjithshëm i LKP-së,
13 do të thotë, që ka përfshirë të gjitha nëndegët.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Janë mbajtur dhe takime të
15 përgjithshme, apo jo, të LPK-së, çka do të thotë se anëtarë
16 nga shtetet e ndryshme takoheshin me njëri-tjetrin? I
17 referohem periudhës përpara luftës.

18 PË. Jemi takuar këshilli i përgjithshëm i cili ka qenë i
19 zgjedhur me votë nga delegatët në kuvend. Këshilli i
20 përgjithshëm jemi takuar, po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të themi
22 që gjatë këtyre takimeve janë bërë bisedime për mënyrën se si
23 do të përpiqej LPK-ja të përmbushte qëllimet e veta? Është e
24 drejtë të themi kështu?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe mesa kuptova unë, këtu
2 përfshihej dhe mundësia e përmbushjes së qëllimeve ushtarake?
3 PË. Përmbushjen e qëllimeve për përkrahjen apo mbështetjen
4 politike, financiare dhe materiale për njësitet e Ushtrisë
5 Çlirimtare të Kosovës.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të themi se këto
7 mundësi që shqyrtoheshin asokohe bënë një dallim të qartë mes
8 LPK-së dhe LDK-së? Është një parashtrim i drejtë ky?
9 PË. Po, mund të thuhet.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju në intervistën për ZPS-
11 në keni thënë se gjatë periudhës para luftës - e kam fjalën
12 për 1996 deri në nga marsi i 1998 - Shtabi Qendror i UÇK-së,
13 siç njihej asokohe, ka lëshuar disa komunikata. Ju kujtohet
14 kjo?

15 PË. Po kanë qenë komunikata publike.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po mund ta thoni me fjalët
17 e tuja, po a pajtoheni ju me mua që kjo ka qenë një gjë e
18 rëndësishme për Shtabin e Përgjithshëm për t'u bërë të ditura,
19 për t'i bërë të ditura aktorëve të jashtëm pikëpamjet e veta
20 dhe tek aktorët e jashtëm përfshihej dhe publiku në
21 përgjithësi? A pajtoheni ju me këtë?

22 PË. Po, sigurisht.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndër çështjet që
24 trajtoheshin në disa prej këtyre komunikatave, i keni thënë
25 dhe ju gjatë intervistave me ZPS-në, ndonjëherë Shtabi Qendror

1 i UÇK-së merhte përsipër dhe disa sulme kundër serbëve apo
2 ish-armatës jugosllave, për shembull, merrnin përsipër sulmet
3 që mund të ishin kryer në stacione policore. Ju kujtohet diçka
4 e tillë?

5 PË. Po, mesa më kujtohet, kështu kanë qenë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të
7 nxjerrë në ekran provën me numër P152.

8 Dëshmitar, për kontekst, kjo që do të shohim është një
9 komunikatë që i atribuohet Shtabit Qendror të Ushtrisë
10 Çlirimtare të Kosovës. Data është 19 tetor 1997. Dhe sipas
11 tekstit kjo është botuar më 23 tetor 1997 tek Zëri i Kosovës.
12 E keni të qartë këtë? Edhe do të presim që të dali dhe shqipja
13 në ekran.

14 Për procesverbal, më duket se shqipja ka numër tjetër. Ju
15 kërkoh ndjesë. Është prova me numër 269. Faleminderit. Mund ta
16 zmadhojmë pak, ju lutem.

17 Së pari, Dëshmitar - besoj se ju e keni thënë dhe më
18 përpara - por sidoqoftë në kohën kur ka dalë kjo komunikatë,
19 23 tetor 1997, ju keni qenë në redaksinë e Zërit të Kosovës,
20 apo jo?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëhere në goftë se do
23 shikojmë përmbajtjen e komunikatës, në dy paragrafët e parë
24 thuhet që:

25 "Me urdhër të Shtabit Qendror të UÇK-së në zonën

1 operative numër 1 janë bërë sulme objekteve dhe policisë
2 pushtuese serbe, gjegjësisht, në Dukagjin, Karadak dhe
3 Drenicë.”

4 Pastaj vazhdohet më tej në paragrafin tjetër që:

5 “Sulmet u kryen në këto fshatra ...”

6 Nuk do i lexoj emrat e fshatrave. Megjithatë besoj që e
7 shikoni këtë pjesë, apo jo, Dëshmitar, e shihni?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që të jetë
10 botuar kjo komunikatë në atë kohë?

11 PË. Mesa më kujtohet, po.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares
13 tani të paraqesë në ekran provën P1053. Në të dyja versionet
14 në shqip dhe në anglisht.

15 Ndërkohë që paraqitet dokumenti, për kontekst më lejoni
16 t’ju them, Dëshmitar, që kjo është një komunikatë tjetër që
17 pretendohet të jetë Komunikata numër 36 nga Shtabi Qendror i
18 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mban datën 15 shtatorit të
19 1997. Është batuar tre ditë më pas në Zërin e Kosovës.

20 Ju lutem shikoni paragrafin e parë të këtij dokumenti,
21 këtu thuhet që:

22 “Më 11 dhe 12 shtator 1997, me vendim të Shtabit Qendror,
23 njësitet e armatosura të UÇK-së kryen një aksion të
24 sinkronizuar në tërë hapësirën e zonës operative. Operacionet
25 u kryen në nënzonat e Drenicës, Erenikut, Pashtrikut,

1 Dukagjinit, Karadakut dhe Llapit. Në një sulm të rrufeshëm u
2 goditën stacionet e policisë pushtuese në Gllogovc, Kijevë,
3 Runik dhe disa vende tjera.”

4 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet ta keni
7 botuar këtë komunikatë në Zërin e Kosovës në shtator të 1997?

8 PË. Besoj që e kemi botuar, sepse nuk më kujtohen të gjitha.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E drejtë. A pajtoheni që
10 në shtator të 1997 ju keni qenë i informuar lidhur me Shtabin
11 Qendror të UÇK-së? Pajtoheni me këtë?

12 PË. Komunikatat na kanë ardh në redaksinë e Zërit të Kosovës
13 përmes fakseve edhe në bazë dhe të asaj që kanë dalë në
14 komunikata, do të thotë, që ne i kemi marrë se Shtabi po e
15 sinkronizon veprimin, Shtabi Qendror. Po ne nuk kemi ditur
16 detaje rreth Shtabit Qendror.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, dëshmia juaj është që
18 ju nuk e dinit asokohe se kush kanë qenë anëtarët e shtabit
19 Qendror në UÇK, këtë po thoni, kjo është dëshmia juaj?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dinit që ata ishin
22 anëtarë të LPK-së?

23 PË. Jo, nuk e kemi dit.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, e dinit që UÇK-ja
25 ishte një derivat i LPK-së, po nga ana tjetër nuk e dinit në

1 qoftë se anëtarët e UÇK-së, pra, të Shtabit Qendror të UÇK-së
2 ishin anëtarë të LPK-së, këtë po thoni?

3 PË. Kështu po them sepse s'e kam ditur.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk keni pyetur asnjëherë
5 asnjë person që kishit pranë, pra, persona me të cilët juve u
6 futët në Kosovë, asnjëherë nuk e keni pyetur se kush kanë qenë
7 anëtarët e Shtabit Qendror?

8 PË. Jo në atë kohë, sepse ka qenë rrezikshmëria shumë më e
9 madhe.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur keni shkuar për t'u
11 regjistruar në UÇK në mars të 1998, ju nuk ju ka shkuar mendja
12 që të pyesnit 14 personat ose 29 personat me të cilët jeni
13 pyetur në Kosovë se kush kanë qenë pjesëtarë të Shtabit
14 Qendror? Asnjëherë nuk e keni bërë këtë pyetje?

15 PË. Jo, sepse unë e kam pësuar me këto çështje në vitet e
16 mëhershme kur jam burgosur dhe pyetjet e shumta, informacionet
17 e shumta kanë qenë të rrezikshme sepse ne gjithmonë kemi
18 llogaritur se mund të zihemi rob nga forcat serbe, mund të
19 arrestoheshim. Dhe gjithmonë jam ruajtur që të mos di shumë
20 për formacionet.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, do kishte qenë befasia
22 për ty kur ke zbuluar që të gjithë personat që kanë qenë
23 përreth teje në Zvicër dhe që janë futur në Kosovë me juve ose
24 disa prej tyre, pjesa dërrmuese e tyre, ka qenë pastaj anëtarë
25 të Shtabit Qendror të UÇK-së? Informacion juve e keni mësuar

1 nga mesi i luftës? A s'ka qenë kështu, Dëshmitar?

2 PË. Jo, jo. Për mu ka qenë pak e habitshme, po jo dhe shumë.
3 Sepse pjesë e Shtabit të Përgjithshëm, kur i kam kuptuar unë,
4 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm kanë qenë edhe njerëz që
5 nuk kanë qenë në kuadër të LPK-së.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një ndër gjërat e tjera që
7 keni thënë në intervistën me ZPS-në - për procesverbal, bëhet
8 fjalë për provën P1816.2 numër provizor i provës në faqen 31
9 dhe 32 - në këtë pjesë ju pyeteni sesa njohuri kishit ju për
10 vrasjet na UÇK-ja. Në përgjigje ju thoni si më poshtë dhe
11 citoj që "Ju e dinit lidhur me këtë sepse UÇK-ja merrte
12 përsipër përgjegjësi të plota përmes komunikatave sa i takon
13 personave të vrarë". A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

14 PË. Nuk po më kujtohet. Po përmes komunikatave, do të thotë,
15 publike që kanë qenë, do të thotë, janë marrë përsipër këto.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A kujtohet Zëri i Kosovës
17 që të ketë botuar disa prej këtyre komunikatave ndërkohë që
18 keni qenë pjesë e redaksisë?

19 PË. Po. Ne i kemi botu çdo komunikatë që ka ardhë në redaksi
20 përmes faksit.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohim provën P154.

22 Për kontekst, z. Buja, bëhet fjalë për Komunikatën numër
23 42. Datën 26 shkurt 1998, domethënë, në këtë ju akoma
24 vazhdonit që të qëndroni në Zvicër.

25 Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

1 dhe është botuar tek Zëri pak përpara sesa ju të largoheshit
2 nga Zvicra më 5 mars të vitit 1998.

3 Do të filloj me paragrafin e parë të këtij dokumenti ku
4 thuhet që:

5 "Me vendim të Shtabit Qendror të UÇK-së gjatë janarit dhe
6 shkurtit njësitet tona të armatosura kryen një varg sulmesh
7 kundër forcave të policisë serbe dhe bashkëpunëtorëve të
8 tyre."

9 A pajtoheni që edhe ky është një shembull i faktit që
10 Shtabi Qendror merrte përsipër sulme kundër shënjestrave të
11 policisë serbe dhe bashkëpunëtorëve të tyre? A e shikoni këtë?
12 PË. Po, e shikoj. Dhe kështu thuheshin në komunikata që i
13 botonim.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të kalojmë dy paragrafë më
15 poshtë, aty thuhet:

16 "Më 23 janar 1998, njësitë tona kryen një atentat kundër
17 kriminelit Desimir Vasic, bashkëpunëtori i afërt i Arkanit."

18 Në qoftë se vazhdoni që të lexoni pak më poshtë thuhet:

19 "Më 13 shkurt 1998, u likuidua Mustafë Kurti
20 bashkëpunëtor i pushtuesit."

21 Dhe:

22 "Më 19 shkurt u likuidua në Lluzhan në afërsi të
23 Podujevës kriminelin Nebojsa Cvejic, anëtar i forcës policore
24 serbe."

25 A e shikoni këtë?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni që ky është
3 një ilustrim i llojit të komunikatave që juve ju kujtohet se
4 janë botuar në atë kohë nga Zëri, kështu?

5 PË. Po, ne kemi botuar.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua që të shikoni diçka
7 tjetër. Bëhet fjalë për paragrafin pasardhës.

8 "Është komunikata që prefshin gjithashtu edhe një
9 kërcënim për kryeministrin shqiptar të fabrikuar nga qarqet
10 antishqiptare dhe e lëshuar në emër të UÇK-së që nuk është e
11 jona dhe është e pavlefshme."

12 A ju kujtohet që Shtabi Qendror i UÇK-së ka dalë haptazi
13 në formën e një komunikate për të mohuar një pretendim të
14 tillë, pretendim i cili është bërë në dokumente të mëhershme?
15 A ju kujtohet kjo?

16 PË. Jo, s'po më kujtohet.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretarisë që
18 të paraqesë në ekran provën P273.

19 Sa për kontekst, Dëshmitar, do shikoni në shqip që është
20 një dokument i cili pretendohet të jetë Komunikata numër 28.
21 Komunikata mban datën 12 janar 1997. Është një komunikatë e
22 cila është e botuar në Zërin e Kosovës më 16 janar 1997,
23 ndërkohë që ju keni qenë pjesë e redaksisë.

24 Në versionin në shqip do ju kërkoja që të kalonim në të
25 majtë dhe më lart në dokument, pjesa e sipërme e dokumentit.

1 Pyetja e parë që kam për juve është kjo, Dëshmitar: A e
2 njihni personin që është në fotografi?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni kush
5 është ky person?

6 PË. Ish-udhëheqësi i lëvizjes së mëhershme para vitit 1981,
7 Jusuf Gërvalla.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur flisni për "lëvizjen"
9 e keni fjalën për LPRK-në apo jo?

10 PË. Ka qenë lëvizja për Republikën e Kosovës në ish-
11 Jugosllavi kështu diçka është quajt.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky person e ka emrin Jusuf
13 Gërvalla, kështu?

14 PË. Po, Jusuf Gërvalla.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ai ishte themeluesi i
16 Zërit, Zëri i Kosovës, a është e saktë kjo?

17 PË. Po, është e vërtetë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të përqendrohemi në
19 versionin në shqip në cep në të djathtë të ekranit tek
20 Komunikata 28.

21 Do t'ju lexoj një pjesë të këtij dokumenti duke filluar
22 nga fillimi. Thuhet që:

23 "Më 26 dhjetor 1996 dhe më 9 janar 1997 në Zonën
24 Operative numër 1, njësite të armatosura kryen dy atentate
25 kundër bashkëpunëtorëve të okupatorit serb në Kosovë.

1 "Atentati i parë u krye kundër Faik Bellopojës në fshatin
2 Besi të Podujevës. Veprimtaria e të cilit u vlerësua si tejet
3 e rrezikshme dhe antikombëtare. Ndërsa vrasja e dytë ishte
4 kundër Maliq Shehollit i cili ishte deputet i Partisë
5 Socialiste Serbe, PSS dhe bashkëpunëtor i vjetër i UDB-së.
6 Pjesëmarrës në varrimin e antishqiptarit dhe kriminelit serb
7 Milos Nikolic (i cili u ekzekutua nga njësitë tona më 25 tetor
8 1996) dhe me ç'rast mbajti edhe një fjalim mortor.

9 "Vendimin për ekzekutimin e tyre e mori Shtabi Qendror i
10 UÇK-së pasi ata kishin ish-in paralajmëruar edhe më herët që të
11 hiqnin dorë nga bashkëpunimi me okupatorin dhe në përputhej me
12 vendimin e Shtabit Qendror të UÇK-së të publikuar në
13 Komunikatën numër 27.

14 "Ekzekutimi i tyre është paralajmërim për të gjithë
15 bashkëpunëtorët e armikut dhe tradhtarët e kombit dhe, në
16 veçanti, për ata të cilët gjoja nga trysnia e disa qendrave
17 ndërkombëtare mund të hyjnë në pazarllëqe për të nënshkruar
18 çfarëdo marrëveshje me okupatorët në kundërshtim me interesat
19 e kombit."

20 A është kjo një prej komunikatave që ju kujtoni se është
21 batuar në Zërin e Kosovës ndërkohë që keni qenë pjesë e
22 redaksisë së Zërit të Kosovës?

23 PË. Po, besoj që është botuar nga Zëri i Kosovës.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për procesverbal,
25 Komunikata 27 e cila përmendet në Komunikatën 28, është

1 pranuar si provë gjyqësore me numrin P269.8.

2 Dëshmitar, ju na thatë që në mars të 1998 jeni futur në
3 Kosovë përmes Shqipërisë, mesa e kuptova dëshminë tuaj, ju
4 thatë që keni qenë 15 vetë që vinit nga Zvicra, përfshirë dhe
5 veten tuaj dhe rreth 15 persona të tjerë të cilët vinin nga
6 shtete të tjera. A e kam kuptuar drejt?

7 PË. Po, drejt.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të përqendrohemi për një
9 çast tek 15 personat që vinin nga Zvicra. Ju të gjithë ishit
10 anëtarë të LPK-së apo ishit të lidhur me LPK-në të gjithë ju?

11 PË. Nuk di a kanë qenë të gjithë LPK, por këta 15, ne që jemi
12 njof mes veti kemi udhëtuar për në Shqipëri.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'jua bëj ndryshe
14 atëherë pyetjen. Ndërmjet këtyre 14 a 15 vetëve që kanë hyrë
15 së bashku me ju në Kosovë atë ditë, a njihnit ndonjë person
16 ndërmjet tyre që nuk ishte anëtar i LPK-së ose cilin ju nuk e
17 njihnit nga veprimtaria që kishit brenda LPK-së?

18 PË. Ka qenë Fatmir Limaj që s'e kam ditë a është anëtarë i
19 LPK-së apo jo, po dhe ndonjë tjetër po që s'po më kujtohet.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ndonjë tjetër, ndonjë
21 person tjetër përveç Fatmir Limajt ju vjen në mendje?

22 PË. Për momentin s'po më kujtohen.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam
24 pyetje tjera për ju.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi

1 Barthe.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi

3 Smith.

4 Mirëdita, Dëshmitar. Mirëdita, Avokat.

5 PË. Mirëdita.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Buja, më herët sot gjatë
7 pyetjeve të ekipit të z. Veseli ju na thatë si më poshtë, për
8 procesverbal këtë e keni thënë në faqen 9 deri në 10 të
9 transkriptit në kohë reale, këtu citoj:

10 "PY. Tani është e drejtë, apo jo, që përpara sesa z.
11 Rejika të emërohej nuk ka pas asnjë person zbulimi në nivel
12 zone në zonën tuaj?

13 "PË. Jo, nuk ka pas se kjo ka ndodhur në tetor, nëntor
14 kur ne kemi filluar që të konsolidojmë komandën e zonës së
15 Nerodimës.

16 "PY. Pra, ju nuk keni pas asnjëherë asnjë strukturë
17 zbulim kundërzbulimi në zonën tuaj përpara kësaj kohe, kështu?

18 "PË. Jo, nuk kemi pasur.

19 "PY. Në brigadat që përmenda, domethënë, në Brigadën 161
20 dhe në Brigadën 162, nuk ka pasur njësi zbulim kundërzbulimi,
21 apo jo, në ato brigada?

22 "PË. Jo, deri në formimin e tyre nuk ka pasur.

23 "PY. Dhe kur janë formuar, sikurse e thatë, në tetor,
24 nëntor, dhjetor, a është caktuar ndonjë person në brigada për
25 të trajtuar zbulim kundërzbulimin me ndonjë nga brigadat apo

1 ka ndodhur kjo më vonë?

2 "PË. Unë nuk e di momentin kur ekzaktësisht, por secili
3 komandant brigade që ishte i emëruar, ishte i ngarkuar me
4 detyrën për të krijuar këtë sektor dhe mendoj që në dhjetor të
5 gjithë sektorët e brigadave që kanë funksionuar në zonën time
6 kanë qenë të krijuara.

7 "PY. Këta sektorë janë caktuar nga komandantët e
8 brigadave përkatësisht, kështu, është e drejtë kjo?

9 "PË. Po, në konsolidim dhe në bashkërendim me shefin e
10 shtabit të zonës dhe komandantët e zonave."

11 Z. Buja, a ju kujtohet ta keni thënë këtë më herët sot?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më vonë, në faqen 11 të
14 transkriptit në kohë reale ju konfirmoni se vetëm Elmi Reqica
15 ka qenë personi që merrej me zbulimin në zonën tuaj në janar,
16 shkurt dhe mars të vitit 1999. A ju kujtohet ta keni thënë
17 këtë, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ime e
20 parë është kjo: Kush kryente punë zbulim kundërzbulimi në
21 zonën tuaj operative përpara sesa të caktohej z. Reqica? Ju
22 thatë që nuk kishte strukturë zbulimi në zonën operative. A do
23 të thotë kjo që askush nuk merrej me punë zbulim kundërzbulimi
24 në zonën tuaj përpara se të emërohej z. Reqica?

25 PË. Para z. Reqica jemi munduar me mbulu këtë mangësi përmes

1 ushtarëve në brigada dhe komandave të brigadave. Për ndryshe
2 si sektor ka filluar të funksionojë diku në dhjetor apo në
3 janar dhe plotësimi ka shku në vazhdimësi dhe ka marrë bukur
4 shumë kohë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka marrë edhe informacion
6 sa i takon, për shembull, pozicioneve të forcave të armikut,
7 të fuqisë së tyre ose armëve që kishin në dispozicion nga
8 dikush tjetër përtej zonës operative përpara sesa të emërohej
9 z. Reqica nga Shtabi i Përgjithshëm?
10 PË. Nga shtabi i zonës, besoj po thoni? Kemi marrë
11 informacione sepse ushtarët tonë kanë qenë të pozicionuar në
12 pika të larta dhe kanë marrë informacione sesi po lëvizin
13 forcat serbe dhe ndonjë informacion të pozicionimit të tyre.
14 Në kohën në nëntor dhe dhjetor jemi mundu me mbulu këto
15 informacione sepse kemi pas obligim ta njoftojmë t'i njoftojmë
16 edhe ekipet e vëzhguesve ndërkombëtarë për lëvizjen e forcave
17 serbe dhe për pozicionimin e tyre jashtë kontestit të
18 Marrëveshjes Holbrook-Milosevic.

19 [Mbrojtja këshillohet]

20 Z. DIXON: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës,
21 ndjesë që ju ndërpreva. Kishte një problem përkthimi që po e
22 ngrinte klienti im, megjithatë, me ç'kuptoje është bërë
23 korrigjimi në transkript për të thënë "shtabi i zonës". Nuk
24 besoj se është problem ky, besoj që, po, u korrigjua ndërkohë
25 që ngriti dorën klienti im.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po e keni fjalën për
2 përgjigjen ndaj pyetjes time?

3 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të pyetjes time? E kuptova
5 këtë.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull.

8 Po duket sikur z. Veseli ka një problem tjetër, apo jo,
9 z. Veseli?

10 Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë thjesht doja të sqaroja që
11 çështja që ngriti z. Veseli, problemi i z. Veseli ishte
12 problemi i përkthimit.

13 [Mbrojtja këshillohet]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të
15 sugjeroj në mënyrë të tillë që të bëni kontrollin e
16 transkriptit siç bëhet zakonisht në mënyrë të tillë që të mos
17 ndërpresim punën. E kuptoj që fjalët janë të rëndësishme dhe
18 dua që të jemi sa më të saktë të jetë e mundur me fjalët, por
19 do ishte mirë ndoshta që të mos e ndërpresim seancën dhe të
20 bëjmë korrigjimin dhe kontrollin për termat përkatës në
21 momentin e duhur.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Edhe unë të njëjtën gjë do
23 thoja, do ishte mirë që të bëhej kontrolli i fjalëve të
24 përkthyer dhe kur të kem mundësinë ndoshta do bëj dhe disa
25 pyetje më pas. Ju faleminderit.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do bëj një pyetje pasuese
2 mbase do mund të ndihmoj palët përmes pyetjes që do të bëj
3 tani.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni
5 Gjykatësi Barthe.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Buja, ju thatë dhe kjo u
7 regjistrua për procesverbal -- një çast ju lutem sa ta gjej se
8 mu zhduk nga ekрани. Në përgjigje të pyetjes sime që në qoftë
9 se keni marrë informacion diku përtej zonës tuaj operative,
10 domethënë, po flisnim për z. Reqica dhe përpara sesa të
11 emërohej z. Reqica, unë përmenda Shtabin e Përgjithshëm,
12 ndërkohë që sipas transkriptit që u bë ndryshimi tani thatë:

13 "Nga shtabi i zonës e kemi marrë informacionin e zbulimit
14 sepse ne kishim pozicionet tona në terren ...", e kështu me
15 radhë.

16 Pyetja ime kishte të bënte konkretisht me Shtabin e
17 Përgjithshëm. Kështu po e përsëris ehe një herë. A keni marrë
18 informacion lidhur me emërimin e z. Reqica nga Shtabi i
19 Përgjithshëm sa i takon vendndodhjeve, pozicioneve ose
20 informatave të tjera ushtarake për armikun?

21 PË. Jo. Në atë kohë i kemi mbledhë informacionet përmes
22 njësitit -- njësiteve që kanë qenë në terren të brigadave.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do ju pyes lidhur me një
24 temë tjetër. A keni marrë informacion për njerëz brenda zonës
25 tuaj operative që dyshoheshin si bashkëpunëtorë ose

1 kolaboracionistë me armikun dhe kush se ishin, domethënë, në
2 qoftë se kjo ka ndodhur, kush ishin këta persona, në qoftë se
3 keni marrë një informacion të tillë?

4 PË. Në fakt ne si zonë nuk jemi marrë me këtë përgjegjësi
5 sepse edhe në rregulloren që e kemi marrë, do të thotë, nuk e
6 kemi pas si zonë një përgjegjësi të tillë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A po thoni në dëshminë tuaj
8 se as përpara emërimit të z. Reqica dhe as pas emërimit të tij
9 ju nuk keni marrë informacion ose ju nuk keni trajtuar
10 informacion që lidhej me kolaboracionistët ose personat që
11 dyshoheshin si të tillë në zonën tuaj operative, këtë po
12 thoni?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na shpjegoni dhe
15 një herë ju lutem pse nuk ka qenë kjo e rëndësishme për ju,
16 pse nuk ishte e rëndësishme të kishte informacion për persona
17 të dyshuar si bashkëpunëtorë?

18 PË. Për ne ka qenë shumë e rëndësishme që të kemi
19 informacione për operacionet ushtarake të ushtrisë dhe
20 policisë serbe dhe kemi pas obligimin që të bëjmë luftën
21 frontale, të mbrojmë popullatën. Dhe informacionet të cilat na
22 kanë ardhur kanë qenë kryesisht për lëvizjet e ushtrisë dhe të
23 policisë serbe. Dhe sidomos, në periudhën nëntor, dhjetor,
24 janar kanë qenë informacione tepër me peshë të lëvizjes së
25 forcave serbe për shkak se ne i kemi njoftuar dhe vëzhguesit

1 ndërkombëtar për thyerjen e marrëveshjes e cila ka qenë
2 Holbrook-Milosevic.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pra, z. Buja,
4 nëse ju nuk merreshit me bashkëpunëtorët, atëherë kush merrej
5 me bashkëpunëtorët në UÇK?

6 PË. Këtë nuk e di. Po zakonisht bashkëpunëtorët kanë qenë
7 bashkë me forcat policore dhe ushtarake serbe dhe në qoftë se
8 kanë marrë pjesë në operacionet luftarake, do të thotë, kanë
9 qenë bashkë me ta.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

11 Ju gjithashtu thatë sot se as z. Reqica dhe as vetë ju
12 nuk keni marrë ndonjë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm sa i
13 takon zbulimit, saktë?

14 PË. Jo. Realisht ne kemi marrë vetëm skemën nga Shtabi i
15 Përgjithshëm sesi do të duket komanda e zonës dhe në atë skemë
16 ka qenë dhe sektori i G2, që e kemi quajjt, sektori i zbulim
17 kundërzbulimit, të cilin unë kam vendos dhe kam emëru Ilmi
18 Reqicën.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju po thoni që ju
20 personalisht nuk keni marrë asnjë urdhër nga Shtabi i
21 Përgjithshëm për çështje të zbulimit, kështu?

22 PË. Ne kemi marrë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm për ta
23 konsoliduar zonën, komandën e zonës, formimin e sektorëve dhe
24 në kuadër të kësaj urdhërese për ta konsoliduar komandën ka
25 qenë dhe sektori i zbulim-kundërzbulimit si të gjithë sektorët

1 e tjerë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po me përjashtim të këtij
3 urdhri keni marrë gjë tjetër lidhur me zbulimin? Ndonjë urdhër
4 e kam fjalën.

5 PË. Nuk më kujtohet që kemi marrë ndonjë urdhër.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetjen tjetër
7 e kam me faktin a ka marrë z. Reqica ndonjë urdhër? Edhe nga e
8 dini ju dhe si mund të jeni i sigurtë që z. Reqica nuk ka
9 marrë asnjë urdhër prej Shtabit të Përgjithshëm?

10 PË. Unë kam qenë komandant zone. Dhe në bazë të rregullave
11 dhe skemës organizative, sektori i zbulim-kundërzbulimit ka
12 mund t'i raportojë shefit të shtabit dhe komandantit të zonës.
13 Do të thotë, kështu në bazë të skemës organizative ka qenë.
14 Unë nuk mund të jem 100 për qind i sigurtë se ka mujt të
15 rrjedhë diçka, po në rregulla nuk kemi pas dhe nuk di ndonjë
16 veprim të z. Reqica i cili ka kaluar jashtë vijës komanduese
17 të zonës.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Z. Reqica jua ka
19 thënë vetë që s'ka marrë asnjëherë urdhër prej Shtabit të
20 Përgjithshëm?

21 PË. Këtë nuk e di. Sepse nuk besoj për shkak se urdhrat u
22 dashtë të vijnë përmes komandantit të zonës.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk besoni t'ju ketë
24 thënë ndonjëherë z. Reqica a ka marrë a s'ka marrë urdhër,
25 kështu?

1 PË. Në bazë të rregullit nuk e ka pas për detyrë me marrë
2 urdhra të tillë dhe unë nuk besoj që ai ka marrë urdhra të
3 drejtpërdrejtë nga Shtabi i Përgjithshëm.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do përpiqem dhe një herë dhe
5 mund të më jepni një përgjigje me "po" ose me "jo". Z. Reqica
6 vetë a ju ka thënë ndonjëherë ai vetë me gojën e tij të ketë
7 marrë urdhër apo të mos ketë marrë urdhër? Pra, e thënë
8 ndryshe të ka thënë ndonjëherë që ka marrë urdhër, po apo jo?

9 PË. Jo, s'më ka thënë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pra, me fjalë
11 të tjera ju thjesht po supozoni në bazë të strukturës, të
12 hierarkisë së zonës dhe të Shtabit të Përgjithshëm, sikurse e
13 kemi thënë disa herë tashmë, ju thjesht supozoni që ai nuk ka
14 marrë asnjë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm, po s'mund të
15 jeni 100 për qind i sigurtë?

16 Z. DIXON: [Përkthim] Më lejoni të çohem në këmbë. Nuk e
17 kam çështjen për përkthimin por --

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të presim fillimisht të
19 përgjigjet dëshmitari dhe ju më pas mund ta bëni
20 kundërshtimin. Po më intereson të marrë fillimisht përgjigjen
21 e dëshmitarit. Duhet të marrë një herë përgjigje nga
22 dëshmitari.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë do të doja të thoja diçka
24 unë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

1 mund të përgjigjeni tani.

2 DËSHMITARI: Unë e thashë shumë qartë, ne kemi pas
3 strukturën dhe formën organizative në atë kohë. Dhe ai ka pas
4 për detyrë, sipas skemës organizative, që t'i raportojë ose
5 shefit të shtabit ose komandantit të zonës dhe komandanti i
6 zonës ose shefi i shtabit ka mund edhe t'i përcjellë
7 urdhëresat z. Ilmi Reqica.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më vjen keq do ta përsëris
9 edhe një herë pyetjen. Se besoj se është e qartë dhe mjafton
10 me një "po" ose me "jo". Pra, ju këtë përgjigje dhe ju thjesht
11 supozoni, pra, ju thjesht supozoni që z. Reqica nuk ka marrë
12 asnjë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm? Po apo jo?

13 PË. Unë po besoj që s'ka marrë sepse kështu ka qenë skema
14 organizative.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, ta marrë për po,
16 pra, po supozoni se nuk ka marrë asnjë urdhër nga Shtabi i
17 Përgjithshëm, thjesht supozoni?

18 PË. Po, mundet kështu.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon,
21 tani mund të flisni.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Dua të theksoj diçka që është, në
23 fakt, kjo që po bëni ju është një kundërpjetje që do të bëjnë
24 Ekipet e Mbrojtjes me dëshmitarin. Gjykatësit kanë të drejtë
25 sigurisht të bëjnë sqarime, por ta bëjnë këtë në mënyrë të

1 hapur me pyetje të hapura edhe komente të këtij lloji që
2 thjesht po supozon dhe dëshmitari s'po jep përgjigjen të
3 drejtpërdrejtë, nuk mendoj se është një koment që duhet ta
4 bëjë Trupi Gjykses.

5 Dëshmitar e ka thënë shumë qartë, shumë qartë se unë
6 besoj se jo, ma merr mendja që jo. Nuk mendoj që janë
7 përshtatshme komentet.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk bëra asnjë koment. Nuk
9 bëra asnjë koment. Le të vendosë Kryegjykatësi.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
11 juaj është i papërshtatshëm. Ka tërësisht të drejtë Gjykatësi
12 ta bëjë pyetjen në mënyrën sesi e bëri në bazë të rregullave
13 tona.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Unë e thashë këtë që të zbardhet në
15 procesverbal. Faleminderit që ma dhatë këtë mundësi.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit për komentin.

17 Z. Buja, kam edhe disa pyetje të tjera për ju. Sot ju
18 thatë, sot paradite që z. Reqica nuk i ka raportuar Shtabit të
19 Përgjithshëm e në veçanti nuk i ka raportuar z. Veseli,
20 kështu?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe - besoj se kam të drejtë
23 t'ua bëj pyetjen - në mënyrë të hapur, unë dua të më thoni ku
24 e bazoni këtë? Pra, nga jeni ju, si mund të jeni ju i sigurtë
25 që ai nuk i ka raportuar z. Veseli?

1 PË. Edhe mjetet e komunikimit që kemi pas kanë qenë në zonën
2 operative, në komandën e zonës tek unë dhe kontaktet me z.
3 Veseli në atë kohë kanë qenë të pamundura nga shefi i zbulim
4 kundërzbulimit. Shefi i zbulim kundërzbulimit, z. Reqica, e ka
5 pas zyrën tek komanda e zonës dhe kjo më bën të besoj se ai
6 s'ka mundur t'i raportojë dikujt tjetër dhe, në bazë të
7 detyrave që ka pas, ka mundur t'i raportojë shefit të shtabit
8 të zonës dhe komandantit të zonës.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Reqica ua
10 tha vetë, ua ka thënë me fjalët e tij, që nuk i ka raportuar
11 Shtabit të Përgjithshëm e më konkretisht z. Veseli, po apo jo?
12 PË. Mu nuk më ka thënë asgjë sepse s'e kam pyetur për këtë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Buja, gjatë
14 pyetjeve plotësuese që bëri ZPS-ja, Prokuroria ju pyeti për
15 deklaratën në gjykimin e Milosevic në gjykimin e 2002 dhe ju
16 thatë se keni marrë informacione për forcat armike nga
17 shërbimet e zbulimit të UÇK-së. Ju kujtohet që diskutuat
18 shkurtimisht me ZPS-në për këtë përpara pushimit të orës
19 11.00?

20 PË. PO.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal, për palët,
22 kjo mund të gjendet në transkriptin në kohë reale në faqen 47
23 dhe 48.

24 Në faqen 48, në rreshtat 2 dhe 3 të transkriptit të sotëm
25 ju thatë se i referoheshit shërbimit zbulim-kundërzbulim

1 brenda zonës suaj operative. Ju thatë "zona që komandoja unë",
2 kështu?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk e kishit fjalën
5 për drejtorinë e zbulimit apo ZKZ-në në nivel të Shtabit të
6 Përgjithshëm në 2002 të themi?

7 PË. Jo, jo në nivel të zonës.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, që të jemi të qartë për
9 këtë pikë, ju e kishit fjalën për z. Ilmi Reqica, që thatë
10 edhe sot ka qenë i vetmi person që merrej me çështjet e
11 zbulimit në zonën tuaj në vitin 1999, më saktë janar deri në
12 mars 1999, kështu?

13 PË. Po. E thashë që fillimisht ka qenë vetëm z. Reqica që
14 është emëru. Dhe e ka plotësu stafin e tij në vazhdimësi, do
15 të thotë, janar, shkurt, mars. Dhe kemi pas po ashtu sektorët
16 në kuadër të brigadave që kanë vepruar po ashtu në zbulim
17 kundërzbulim në Zonën Operative të Nerodimës dhe kemi marrë
18 raporte për lëvizjen e forcave.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, që ta kuptoj unë siç
20 duhet, nëse e kishit fjalën z. Reqica kur keni dhënë dëshmi në
21 gjykimin e Milosevic, pse e keni thënë në dëshminë tuaj në atë
22 kohë se keni marrë informacion nga shërbimi i zbulimit të UÇK-
23 së? Pse nuk keni thënë atëherë që informacionin e keni marrë
24 nga sektori i zbulimit në zonën tuaj operative ose nga z.
25 Reqica? Pse keni thënë atëherë nga shërbimi i zbulimit të UÇK-

1 së?

2 PË. Po realisht unë kam menduar që po nënkuptohet që është
3 fjala për zbulim kundërzbulimin në zonën operative ku ka
4 komanduar unë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ende s'e kam të qartë pse
6 nuk thatë sektori i zbulimit në zonën time? Pse përmendët
7 shërbimin e zbulimit të UÇK-së dhe nuk thatë sektori i zonës
8 sime?

9 PË. Po dhe në zonën ku kam komanduar unë, ka qenë zbulim
10 kundërzbulimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Aty nuk është
11 potencuar qartë që duket në deklaratë se është fjala për
12 zbulim kundërzbulimin e zonës operative të Nerodimës të
13 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. Buja, ju na thatë në faqen 16, 17 të transkriptit të
16 ditës së sotme, por edhe gjatë kundërpjetjeve, ju thatë se në
17 zonën tuaj operative sektori i zbulim kundërzbulimit dhe
18 policia ushtarake kanë qenë dy sektorë të ndarë me përgjegjësi
19 të ndryshme, kështu?

20 PË. Po, vetëm e potencia që policia nuk ka qenë sektor po ka
21 qenë njësi apo kompani në atë kohë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Policia ushtarake apo
23 sektori i zbulim kundërzbulimit ndonjë prej këtyre dy
24 njësive ka qenë përgjegjës për identifikimin dhe trajtimin e
25 bashkëpunëtorëve?

1 PË. Jo. Te unë në zonë, jo.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e keni diskutuar çështjen
3 e bashkëpunëtorëve me anëtarë të tjerë të UÇK-së, për
4 shembull, me anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm apo edhe me
5 komandantë të tjerë të zonave gjatë luftës?

6 PË. Gjatë luftës, e kam sqaruar, që unë edhe po të doja nuk
7 kam qenë në Kosovë për një periudhë shumë të gjatë kohore dhe
8 nuk mund të mirrem me një çështje të tillë. Dhe në zonë i kam
9 qartësuar se ne nuk kemi as kushte dhe as mundësi për të bërë
10 hetime dhe për të bërë ndjekjen e njerëzve që mund të
11 pretendohet se janë bashkëpunëtorë të Serbisë.

12 Prandaj ne kemi vepruar vetëm me policinë ushtarake në
13 bazë të rregullores për disiplinën, qoftë për civilë, qoftë
14 për njerëzit që ishin të uniformuar.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Arsyeja pse po
16 ju pyes, z. Buja, është se kemi parë dëshmitarë këtu, kemi
17 dëgjuar dëshmitarë këtu, përfshi nga bashkëluftëtarët tuaj se,
18 për shembull, pylltar, roje pylli, rojet e pyllit ishin një
19 kërcënim serioz për UÇK-në se ju jepnin informata armikut për
20 pozicionet e UÇK-së, prandaj këta persona arrestoheshin dhe
21 merreshin në pyetje. Si do ta komentoni ju këtë?

22 PË. Nuk mund ta komentoj sepse ka pasur zëra se ka diçka të
23 tillë, po unë nuk e di.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mendoni dhe ju se rojet e
25 pyllit ishin një kërcënim për UÇK-në sepse mund t'i jepnin

1 armikut informacione për pozicionet e UÇK-së?

2 PË. Në fakt, në zonën time unë nuk di që ka pasur roje të
3 pyllit, por e di që kemi organizuar si ushtri për t'i ruajtur
4 pyjet.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të jemi të qartë, domethënë,
6 ju nuk keni pasur asnjë roje pylli në zonën tuaj të
7 përgjegjësisë?

8 PË. Unë nuk kam njoft asnjë roje pylli. Kemi organizuar, ne
9 vetë si ushtri, ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të
10 cilën madje e kam pas dhe shenjën në krah policia e pyllit apo
11 PP ju ka shkru, që janë identifiku se janë njerëz të cilët e
12 ruajnë pyllin nga prerjet e shkatërrimet e mundshme.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam më
14 pyetje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
16 Gaynor.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësit
18 Smith.

19 Z. Dëshmitar, dua t'i kthehemi dhe një herë çështjes së
20 lidhjes që kishte policia ushtarake me zbulim-kundërzbulimin
21 në nivelin e zonës.

22 Në faqen 17 të transkriptit të ditës së sotme, z. Dixon,
23 Avokati i z. Veseli ju bëri një pyetje.

24 Pyetje dhe ai tha:

25 "Ju përmendët policinë ushtarake. Ju keni dhënë dëshmi

1 edhe për këtë shërbim që ishte formuar. A është e vërtetë që
2 sektori i zbulimit nuk kishte asnjë lidhje me punën e policisë
3 ushtarake?"

4 Ju jeni përgjigjur:

5 "Zbulimi dhe kundërzbulimi kanë qenë pjesë e komandës së
6 zonës. Ndërsa policia ushtarake ka qenë një kompani e policisë
7 ushtarake dhe ishte një njësi speciale që i raportonte
8 drejtpërdrejt komandantit të zonës."

9 A ju kujtohet që e keni thënë këtë?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Së pari ta sqarojmë, kush
12 është, kush ka qenë komandanti i ZKZ-së brenda zonës? Kur
13 thatë ju komandanti këtu e kishit fjalën për z. Reqica vetë?
14 PË. Shefi i sektorit ka qenë z. Reqica. Kështu e kemi quajtur
15 në bazë të skemës. Ndërsa komandanti i policisë -- kompanisë
16 së policisë ka qenë Isak Musliu. Sektori ka qenë në kuadër të
17 zonës ku ju kanë përgjigj edhe shefit të shtabit dhe
18 komandantit të zonës. Ndërsa policia ushtarake nuk ka qenë me
19 sektorët, po ka qenë kompani, kompani policore e cila i ka
20 raportuar apo ka qenë njësi vartëse drejtpërdrejt e
21 komandantit të zonës.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Personi që ju thatë është
23 Musliu a është ky i njëjti person si Qerqizi?

24 PË. Po, Qerqizi.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Qerqizi a ka qenë anëtar i

1 komandës së zonës, po apo jo?

2 PË. Jo, s'ka qenë anëtar i komandës së zonës. Ka qenë
3 komandant i kompanisë.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po nga pikëpamja
5 organizative si ka mundësi që komandanti i policisë ushtarake
6 nuk është anëtar i komandës së zonës, cila është logjika këtu?
7 PË. I nderuar, komanda e zonës e ka pas zëvendësin, shefin e
8 shtabit dhe sektorët. Dhe në kuadër të komandimit, komandanti
9 i zonës e ka pas njësi vartëse kompaninë e policisë,
10 batalionin e logjistikës dhe njësinë speciale. Do të thotë,
11 kanë qenë drejtpërdrejt të komanduara nga komandanti i zonës
12 qysh është komanduar dhe brigadat.

13 As komandanti i brigadës, as komandanti i kompanisë së
14 policisë, as i njësisë speciale nuk kanë qenë pjesë e shtabit
15 të zonës.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po z. Reqica ka qenë anëtar
17 i komandës së zonës?

18 PË. Z. Reqica si shef i zbulimit shtabit -- si shef i zbulim
19 kundërzbulimit i G2 apo i sektorit të dytë, ka qenë pjesë e
20 shtabit të zonës.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të flas tani për
22 raportimin. Ju thatë që z. Reqica ju ka raportuar ju
23 personalisht si komandant zone, por nuk është e qartë nëse i
24 ka raportuar dhe z. Veseli që ka qenë drejtor i zbulimit dhe
25 kundërzbulimit pranë Shtabit të Përgjithshëm. A mund ta

1 sqaroni pak dëshminë tuaj lidhur me këtë?

2 PË. Z. Reqica ka qenë në kuadër të komandës së zonës. Dhe
3 sektorët i janë përgjigjur shefit të shtabit i cili i ka
4 koordinu veprimin e sektorëve dhe shefi i shtabit i ka raportu
5 komandantit të zonës dhe kjo ka qenë forma e komandimit në
6 Zonën Operative të Nerodimës në bazë të skemës organizative që
7 e kemi pas. Z. Reqica e ka pas për obligim t'i raportojë
8 shefit të shtabit ose komandantit të brigadës.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në momentin që z. Reqica ju
10 jepte informacione të zbulim kundërzbulimit të një natyre
11 tepër urgjente si ia përcillnit ju këtë informacion Shtabit të
12 Përgjithshëm sa më shpejt që të mundeshit?

13 PË. Realisht, z. Reqica u dashtë ta lajmërojë menjëherë
14 shefin e shtabit të zonës e shefi i shtabit të zonës menjëherë
15 të më thërrasë si komandant zone dhe unë në momentin e parë që
16 kam mujt me kontakt me shefin e shtabit të Ushtrisë
17 Çlirimtare të Kosovës, z. Zyrapit, i kam raportuar apo e kam
18 njoftuar për rrezikshmërinë apo për llojin e informacionit që
19 kemi pas.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, nëse ishin çështje të
21 zbulimit dhe kundërzbulimit, ju telefononit vetëm z. Zyrapit?
22 Nuk telefononit askënd tjetër në Shtabin e Përgjithshëm?

23 PË. Jo, kjo ka qenë rregullisht ushtarak në periudhën e fundit
24 të luftës që komandantët e zonave kemi raportuar, kemi
25 njoftuar drejtpërdrejt shefin e shtabit të Ushtrisë Çlirimtare

1 të Kosovës.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] T'i kthehemi pyetjes së z.
3 Dixon. Sepse nuk ishte shumë e qartë përgjigja juaj. Do jua
4 bëj dhe një herë pyetjen:

5 "A është e vërtetë që sektori i zbulimit nuk kishte fare
6 përfshirje në punën e policisë ushtarake, pra, nuk merrej me
7 punët e policisë ushtarake".

8 Cila do ishte përgjigja juaj për këtë?

9 PË. Detyrat e policisë ushtarake kanë qenë tjera, ndërsa
10 zbulim kundërzbulimit kanë qenë krejt tjera. Dhe format e
11 raportimit kanë qenë të ndryshme. Policia ushtarake ka
12 raportuar drejtpërdrejt tek komandanti i zonës. Ndërsa sektori
13 apo shefi i sektorit të zbulim kundërzbulimit i ka raportuar
14 shefit të shtabit dhe komandantit të zonës. Do të thotë, kanë
15 qenë të ndryshme.

16 Dhe natyra e veprimit të tyre ka qenë krejt ndryshme.
17 Shefi i zbulim kundërzbulimit ka pas për detyrë të nxjerrë
18 informacione, të marrë informacione për lëvizjen e forcave
19 serbe, për rrezikshmërinë për popullatën civile, e tjerë e
20 tjerë. Ndërsa policia ushtarake kryesisht është marrë me
21 veprimin e brendshëm të ushtarëve të UÇK-së me shkeljet e
22 mundshme, me rregullat që i kemi pas, me rregulloren të cilën
23 e kemi pas në atë kohë.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, a është e vërtetë që
25 kishte edhe njësite të policisë ushtarake edhe njësi të ZKZ-së

1 pranë brigadës në zonë tuaj, në nivel brigade në zonën tuaj?

2 PË. Jo, jo nuk ka pas njësi, po ka pas staf sektori. Sektori
3 zbulim kundërzbulimit i ka pas disa, në vazhdimësi është
4 shtuar, por ka pas disa njerëz të cilët i kanë marrë
5 informacionet dhe i kanë përpunuar ato informacionet para se
6 të shkojnë te shefi i shtabit të zonës apo tek komandanti i
7 zonës. Ndërsa policia ushtarake ka pas një kompaninë e cila ka
8 qenë diku rreth 80 ushtarë apo 100.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Duke marrë parasysh natyrën
10 shumë të ndryshueshme të konfliktit në atë kohë, a kishte
11 raste ku stafi i zbulim kundërzbulimit për shkak të natyrës së
12 zhvillimeve do të duhej të koordinonte apo të bashkëpunonte me
13 policinë ushtarake?

14 PË. Mundësia e koordinimit ka qenë përmes komandantit të
15 zonës, jo drejtpërdrejt këto dy sektorë me policinë ushtarake.
16 Po sektori përmes shefit të shtabit dhe komandantit të zonës
17 kanë mujt të koordinohet me policinë ushtarake.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ju si komandant zone,
19 siguroheshit që të kishte një koordinim të tillë mes ZKZ-së
20 dhe policisë ushtarake?

21 PË. Kjo ka qenë njëra ndër detyrat e mia si komandant zone.
22 Unë jam mundu me i koordinu veprimet e të gjitha njësive të
23 Zonës Operative të Nerodimës sepse ka qenë detyrë e imja dhe e
24 shefit të shtabit të zonës.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Vendorsim në ekran një provë

1 para pushimit. Është prova me numër P00648. Është rregullorja
2 e brendshme e Shtabit të Përgjithshëm.

3 Po ju lexoj fillimin e faqes. Ju lutem, mund t'i lexoni
4 ju në fakt në shqip fjalët për transkript?

5 PË. Shkruan: "Rregullore e brendshme e Shtabit të
6 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Për z. Pace
8 tani, anglishtja s'i ka këto fjalë. Ju lutem ribëjeni
9 përkthimin.

10 Kalojmë në faqen 24 tek shqipja tani dhe tek faqja 20 tek
11 anglishtja.

12 Këtu, shohim që thotë Kreu VIII. Thotë kreu VII. Shqipja
13 është Kreu VII, anglishtja ka Kreu VIII. Sidoqoftë, titulli
14 është "Policia ushtarake dhe detyrat e saj". Të lutem shiko
15 pak paragrafin 5 ku thotë:

16 "Detyrat e policisë ushtarake janë."

17 Edhe, po më ndiqni? Shkoni tek viza e shtatë. Te viza e
18 shtatë thotë që:

19 "- të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e
20 Shërbimit Informativ në ushtri për të zbuluar forma të
21 ndryshme të kriminalitetit."

22 Po më ndiqni?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, a po flisnit për këtë
25 dhe ju tani që kur thatë që policia ushtarake e kishte për

1 detyrim, për detyrë të ndihmonte shërbimin e zbulimit?

2 PË. Po, po koordinimin e ka bërë komandanti i zonës ose shefi
3 i shtabit. Dhe këtu ka qenë në zonën time.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër në
5 të dyja gjuhët, te paragrafi 10, lexojeni, më ndiqni kur
6 thotë:

7 "Policia ushtarake gjithnjë duhet ta ketë parasysh se
8 tërë veprimtarinë duhet at zhvillojë në luftë dhe niveli i
9 përgjegjësisë duhet t'i përgjigjet kësaj gjendjeje. Për
10 armiqtë dhe të gjithë ata që në forma të ndryshme tentojnë ta
11 pengojnë a sabotojnë luftën tonë çlirimtare duhet të jenë të
12 pamëshirshëm."

13 PË. Po, po e shoh.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, e kuptoj drejt unë
15 atëherë që policia ushtarake ishte e detyruar të bashkëpunonte
16 me sektorin e zbulimit dhe të ishte e pamëshirshme ndaj atyre
17 që përpiqeshin të sabotonin luftën, kështu?

18 PË. Jo, kështu po thuhet. Po s'ka mujt me vepru pa
19 komandantin e zonës apo shefin e shtabit, sepse kanë qenë nën
20 komandën e tyre.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nëse ju, si komandant zone,
22 vendoseshit në dijeni se policia ushtarake dhe ZKZ-ja kishin
23 arrestuar një person dhe se kishin informacione të besueshme
24 se ky person ishte një bashkëpunëtor, si e garantoni ju
25 atëherë bashkëpunimin mes këtyre dy shërbimeve sa i takon

1 arrestimit, ndalimit dhe marrjes në pyetje të këtij personi?

2 PË. Te unë në zonë nuk ka ndodhë diçka e tillë sepse nuk kam
3 lejuar arrestimin e njerëzve për shkak se nuk kemi mujt me bë
4 hetime, s'kemi pas organe të hetuesisë, as kemi pas organe të
5 gjyqësisë dhe realisht s'kemi pas as kushte për mbajtjen e
6 ndonjë personi që kemi mujt të dyshojmë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Vazhdojmë pas pushimit.

8 Faleminderit, z. Dëshmitar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
10 tani do bëjmë pushimin e drekës për një orë e gjysëm. Do
11 kthehemi në sallë në orën 02.30. Mos flisni me askënd për
12 dëshminë që keni dhënë në sallë.

13 Mund të largoheni tani nga salla.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
16 deri në orën 02.30.

17 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.03

18 --- Seanca rifillon në orën 14.30

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
20 sillni dëshmitarin në sallë.

21 Z. Ellis, një sekondë ju lutem, sa të vë kufjet.

22 Mund të vazhdoni.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Përpara sesa të vijë dëshmitari, të
24 nderuar Gjykatës, do të mundohem të sqaroj një çështje që ka
25 të bëjë me pyetjet e fundit që janë bërë nga Gjykatësi Gaynor,

1 që ka të bëjë me dokumentin që fillojnë me ERN SPOE00225106
2 deri në 225130.

3 Mënyra sesi e kuptoj unë është që ky dokument i gjatë në
4 ERN është ndarë në dy dokumente si prova. Pra, me fjalë të
5 tjera, kemi provën P83 që janë katër faqet e para të këtij
6 dokumenti dhe që janë nga rregullorja e brendshme ose se çfarë
7 thuhet që ka qenë rregullorja e brendshme e Shtabit të
8 Përgjithshëm.

9 Pastaj ekziston dhe një provë tjetër që është prova P648
10 që fillon në faqen SPOE0225110. Nga parashtrimet e mia është e
11 qartë, domethënë, nga shifrat në krye që bëhet fjalë për një
12 dokument të ndryshëm dhe për këtë arsye kjo i referohet asaj
13 çfarë quhet rregullore të ndërmjetme ose të përkohshme.

14 Ndërkohë që Gjykatësi Gaynor vuri re që nuk ka një shënim
15 sa i takon kokës së dokumentit, rregullore e brendshme e
16 Shtabit të Përgjithshëm, arsyeja për këtë është që ky dokument
17 është pranuar si një provë më vete dhe për këtë arsye faqet që
18 janë treguar dëshmitarit janë na rregulloret e brendshme të
19 Shtabit të Përgjithshëm.

20 Nuk e di në qoftë se jam i qartë në atë çfarë thashë apo
21 jo, por doja të thoja që bëhet fjalë për dy grupe të ndryshme
22 provash.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, keni absolutisht të
24 drejtë. Në qoftë se keni ndonjë gjë tjetër për të sqaruar më
25 sqaroni sepse nuk isha në dijeni të kësaj gjëje.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani që kam mundësinë dua të
2 njoftoj Trupin Gjykses që u bë një pyetje nga Gjykatësi
3 Mettraux ku citoi një deklaratë ku tha që LPK-ja ka qenë
4 ombrellë dhe ka pas një keqpërkthim sepse nuk është përdorur
5 ky term, kështu që do ju kërkoja që të lexonit në shqip çfarë
6 ka thënë dëshmitari.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Misetiç, po ai e pranoi
8 këtë tani.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëhere i takon që do ketë një
10 debat në qoftë se e çorientuam ose e sugjestionuam të shkonte
11 në një përgjigje të caktuar apo jo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Silleni dëshmitarin tani.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
16 vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit Gaynor. Gjykatësit Gaynor i
17 kanë mbetur eshë disa pyetje tjera për ju.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
19 Smith.

20 Mirëdita, Dëshmitar.

21 PË. Mirëdita.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetjet e radhës kanë të
23 bëjmë me Fatmir Limajn dhe Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.
24 Në deklaratën e 2001 për TPNJ-në në faqen 4, ju thoni se
25 Fatmir Limaj "shkoi në shtabin kryesor të UÇK-së në nëntor të

1 1998 dhe ka mbetur anëtar aty". Pastaj në faqen tjetër duke ju
2 referuar përsëri asaj çfarë në anglisht thuhet "komanda e
3 Shtabit Qendror të UÇK-së", ju keni dhënë emrat e shtatë
4 anëtarëve të komandës. Një prej tyre është drejtor ose citohet
5 prej jush si "Drejtor i çështjeve policore", dhe ky person
6 është "Fatmir Limaj."

7 A ju kujtohet që e keni thënë këtë në deklaratën e dhënë
8 për TPNJ-në në vitin 2001, Dëshmitar?

9 PË. Më duket se po.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa për të sqaruar
11 procesverbalin, "komanda e Shtabit Qendror të UÇK-së", ky
12 përdoret ky formulim a bëhet fjalë për Shtabit të Përgjithshëm
13 të UÇK-së?

14 PË. Shtabin e Përgjithshëm se Shtabi Qendror --

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Cilët kanë qenë faktorët në
16 kohën që keni dhënë këtë dëshmi që ju kanë bërë juve të besoni
17 që Fatmir Limaj ishte drejtor për çështjet policore në Shtabin
18 e Përgjithshëm?

19 PË. Po, nëse nuk gaboju, ka qenë, në atë kohë është bërë
20 publike drejtorët e drejtorive.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A po thoni sot, a është
22 dëshmia juaj që Fatmir Limaj ka qenë drejtori i policisë në
23 Shtabin e Përgjithshëm, këtë po thoni?

24 PË. Mesa më kujtohet mua, po është kohë bukur e gjatë, do të
25 thotë, në atë kohë kur e kam dhënë e kam pas ma të qartë,

1 drejtor i drejtorisë së policisë në nëntor apo dhjetor. Nuk e
2 di të saktë.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E keni fjalën për nëntorin
4 ose dhjetorin e 1998, apo jo, Dëshmitar?
5 PË. Po, Kur është bërë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm z.
6 Limaj.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do ju kërkoj që të sqaroni
8 diçka. Disa fjali që keni deklaruar në deklaratën e prillit të
9 2022 - më falni - 28 prillit 2003 me Zyrën e Prokurorit të
10 TPNJ-së, mesa e kuptoj unë është prova që tani është
11 regjistruar P1816.1 MFI.

12 Në këtë pikë të intervistës me TPNJ-në, ju po flisni për
13 periudhën pasi keni kaluar në Kosovë, pra, në territorin
14 kosovar dhe kur mbërrini në zonën e Drenicës në mars të vitit
15 1998. Ju në këtë pikë thoni në faqen 28 dhe këtu citoj që:

16 "... pas mbërritjes tonë në Drenicë, Fatmir Limaj u
17 caktua që ta drejtonte atë njësit" dhe këtu mbaron citimi.

18 Dy faqe më pas në faqen 30 ju thoni:

19 "... ne e dinim që Fatmir Limaj ishte një person më
20 kompetent për sa i takon faktit që ai e njihte terrenin më
21 mirë sesa të tjerët.

22 "Fatmir Limaj u caktua që të bashkërendonte gjërat në
23 Shtabin e Përgjithshëm, ndërkohë që detyra ime ishte që të
24 bashkërendoja gjëra me Fatmirin", këtu përfundoj citimin.

25 Më vonë ti thua dhe citoj përsëri:

1 "... në qoftë se do vinte momenti për fillimin e krijimit
2 të njësiveve ose formave të tjera të organizatave ushtarake
3 unë do lidhesha me Fatmirin dhe Fatmiri do lidhej me Shtabin e
4 Përgjithshëm dhe linja e raportimit po ashtu do vinte nga
5 mbrapsht, në kuptimin që Shtabi i Përgjithshëm do i thoshte
6 Fatmirin, Fatmiri do më thoshte mua."

7 A ju kujtohet ta keni thënë këtë për Prokurorinë e TPNJ-
8 së, Dëshmitar?

9 PË. Po më kujtohet që kam thënë për Prokurorinë. Po, në
10 fakt, kjo ka qenë ai vizioni ynë i fillimit që nuk kemi mujt
11 me e zbatu.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sipas mendimit tuaj me kë
13 bashkërendonte punët Limaj në Shtabin e Përgjithshëm?

14 PË. Këtë nuk e di, po rrjedha që kishin më vonë që ishin
15 shumë të përshpejtuara realisht nuk kam pas nevojë më me i
16 koordinu me Fatmir Limajn sepse në kohën kur u dal zëdhënësi i
17 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të thotë, e kemi pas
18 mundësinë me kontakt drejtpërdrejt me zëdhënësin.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe kur thua zëdhënësi i
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ose UÇK-së për kë e keni fjalën
21 konkretisht?

22 PË. Flas për mesin e qershorit për zëdhënësin Jakup Krasniqi.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në faqen 3766 të dëshmisë që
24 keni dhënë në datë 4 mars të 2005 për TPNJ-në - dhe mesa
25 kuptoj është prova P1818 MFI - ju flisni për pjesën e parë të

1 prillit të vitit 1998 dhe aty thoni dhe citoj këtu:

2 "... u përpoqa të kontaktoja me Fatmir Limajn në mënyrë
3 të tillë që të mund të shkoja në Kleçkë për të kontaktuar
4 Shtabin e Përgjithshëm përmes Hashim Thaçit në Drenicë për
5 t'ju treguar atyre lidhur me përpjekjet organizative që po
6 bëja unë dhe mangësisë së armëve ..."

7 Dhe pastaj vazhdoni më tej. A ju kujtohet ta keni thënë
8 këtë?

9 PË. Po, më kujtohet.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A na shpjegoni se pse
11 kontaktonit ju Limajn në mënyrë të tillë që ai të shkonte të
12 takohej me Thaçin në mënyrë që Thaçi të bashkërendonte punët
13 me Shtabin e Përgjithshëm?

14 PË. Po kështu e kam mendu në atë kohë që të mund të shkoj
15 deri në Drenicë për me kontaktu Hashim Thaçin i cili, unë
16 besoja, se ka kontakte me Shtabin e Përgjithshëm. Dhe kështu e
17 besoja në atë kohë. Po kjo nuk ka ndodhë se rrodhën ndryshe
18 ngjarjet, do të thotë, u përshpejtuan shumë ma shumë.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Megjithatë konteksti i
20 dëshmisë tuaj ka të bëjë me mangësinë e armëve, domethënë, nuk
21 kishin armë mjaftueshëm dhe krijimin e njësiteve, njësiteve
22 ushtarake. Ju në atë kohë a e keni kuptuar që z. Thaçi ka
23 pasur përgjegjësi të lidhura me krijimin e njësiteve ushtarake
24 dhe me sigurimin e furnizimeve të mjaftueshme me armë e
25 municione?

1 PË. Jo, nuk e kam menduar se z. Thaçi e ka këtë përgjegjësi.
2 Po unë në atë kohë e kam menduar se përmes z. Thaçi muj me
3 kontaktu me njerëzit që mund të jenë kompetent në Shtabin e
4 Përgjithshëm për të na furnizuar me armë dhe me uniforma.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pse ishte Thaçi pikë
6 kontakti për ty në atë kohë e kam fjalën për prillin dhe majin
7 e 1998 në mënyrë të tillë që të mund të bashkërendohej me
8 pjesën tjetër të Shtabit të Përgjithshëm?

9 PË. Se unë besoja në atë kohë që Shtabi i Përgjithshëm duhet
10 ta ketë selinë në Drenicë dhe realisht përmes kontakteve me z.
11 Thaçi mund të kontaktoja Shtabin e Përgjithshëm në Drenicë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek
13 pyetja e komunikatave të cilat janë botuar, janë publikuar në
14 Zërin e Kosovës.

15 Më herët sot thatë dhe këtu citoj që:

16 "Ne botonim çdo komunikatë që vinte në bordin e redaksisë
17 përmes faksit."

18 Tani dua ta shtjellojmë pak më tej këtë çështje. Sipas
19 numrave të fakseve mbërritëse në redaksi, kush i dërgonte këto
20 komunikata, domethënë, juve kush ua dërgonte komunikatat për
21 botim?

22 PË. Ne nuk e dinim nga po vinin komunikatat, po neve na vinte
23 përmes fakseve.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Megjithatë ju mund ta
25 shikonit e dallonit numrin e faksit kur ju vinte faksi, apo

1 jo?

2 PË. Nuk e kemi këqyrë këtë.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Si e keni kuptuar ju kush
4 person ua dërgonte komunikatat ju për publikim?

5 PË. Po ne në atë kohë e kemi pas vendimin e këshillit të
6 përgjithshëm të LPK-së që komunikata që vijnë në emër të
7 Shtabit Qendror, nëse s'gaboje, duhet t'i botojmë. Do të thotë,
8 ka qenë organ -- gazeta ka qenë organ i Lëvizjes Popullore të
9 Kosovës dhe përgjegjësia e Shtabit -- e këshillit të
10 përgjithshëm ka qenë për me kontrollu redaksinë e gazetës dhe
11 politikat e saj.

12 Kjo, do të thotë, ka bërë që ne komunikatat t'i botojmë
13 pavarësisht se nga vijnë dhe të mos i verifikojmë se nga po
14 vijnë.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pikërisht është kjo çështja
16 që dua që ta shtjelloj më tej. A pajtoheni që nga ato çfarë
17 kemi parë edhe nga shembujt që u treguan sot që informacioni
18 në ato komunikata ka pasur rëndësi shumë të madhe?

19 PË. Nuk e kuptova, më fal.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e pranoni që informacionet
21 dhe supozimet që përfshiheshin në ato komunikata ishin
22 jashtëzakonisht të rëndësishme, pajtoheni me këtë?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Si mund të verifikoni ju që
25 personi që ua dërgonte këto komunikata që ua dërgonte juve, në

1 fakt i dërgonte ato komunikata në emër të Shtabit të

2 Përgjithshëm të UÇK-së?

3 PË. Në fakt nuk e kemi verifikuar atë.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në këtë pikë a nuk

5 ekzistonte rreziku i madh që juve të publikonit diçka që mund

6 t'ju vinte nga burime të shumta, përfshirë këtu dhe persona që

7 ishin kundërshtarë të UÇK-së, nuk ekzistonte ky si rrezik?

8 PË. Po, ka ekzistuar ky rrezik.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ndonjë prej pjesëtarëve të

10 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së a ka kontaktuar ndonjëherë

11 me ju për t'ju thënë që keni publikuar gabimisht një

12 komunikatë që nuk ishte dërguar prej Shtabit të Përgjithshëm

13 të UÇK-së?

14 PË. Jo, unë nuk kam pas rast.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A do ishte e saktë të thuhet

16 që mesa dini ju të gjitha komunikatat e publikuar në Zërin e

17 Kosovës janë vërtetë janë nxjerrë ose janë leshtuar nga Shtabi

18 i Përgjithshëm i UÇK-së, domethënë, origjinën e kanë nga

19 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së?

20 PË. Unë nuk mund ta di, po nuk ka pas ndonjë demond.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju thoni:

22 "Nuk mund ta di po nuk ka pasur ndonjë ..."

23 Çfarë, na e thoni dhe një herë?

24 PË. Demont i atyre komunikatave, me i demontu që s'është e

25 Shtabit të Përgjithshëm. Sepse ka mujt me na ardhë ndonjë

1 komunikatë e cila nuk ka qenë e Shtabit të Përgjithshëm dhe
2 Shtabi i Përgjithshëm apo ndonjë anëtar i Shtabit të
3 Përgjithshëm me na dërgu ndonjë shkresë përmes fakseve njëjtë
4 me thënë që kjo komunikatë nuk është e Shtabit të
5 Përgjithshëm. Po diçka e tillë nuk ka ndodhë sa kam qenë unë
6 në redaksi.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk ka pasur ndonjë mohim të
8 tillë, ndonjë demond të tillë siç thoni ju, këtë po thoni nuk
9 keni marrë asnjëherë asnjë kundërshtim, asnjë demont për sa i
10 takon komunikatave?

11 PË. Po, kështu e thashë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.
13 Faleminderit. Nuk kam pyetje tjera.

14 Faleminderit edhe juve, Gjykatësi Smith.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje
16 plotësuese nga ZPS-ja?

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

20 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

21 Z. MISETIC: [Përkthim

22 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Kam disa pyetje plotësuese për ju.

23 Janë pyetje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me pyetjet që ju
24 bëri Gjykatësi Mettraux. Vetëm pak minuta parashikoj.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni një minutë, ju lutem.

1 Së pari, do i kërkoj Sekretares të paraqesë në ekran
2 dokumentin MFI me numër MFI P01816.1, faqja 17, duke filluar
3 në rreshtin 18 në anglisht dhe faqja 17, duke filluar nga
4 rreshti 16 në shqip.

5 PY. Atëherë le të fillojmë të lexojmë përgjigjen tuaj në
6 shqip duke filluar nga rreshti 16. Do ju kërkoja, Dëshmitar,
7 që thjesht të lexonit fjalitë nga rreshti 16 deri në 20.
8 Lexojini me zë, ju lutem.

9 PË. Pjesa po "kur jam futur në organizatë politike", apo?

10 PY. Po, duke filluar nga aty.

11 PY. Po:

12 "Kur jam fut në organizatë politike apo në Lëvizjen
13 Popullore të Kosovës ajo mund të merret si përkrahje që i
14 është dhënë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në atë kohë. Ka
15 qenë, do të thotë, Lëvizja Popullore e Kosovës mbështetja apo
16 përkrahja politike dhe materiale. Ashtu është definuar
17 atëherë."

18 PY. Në rregull. Faleminderit. Tani dua t'ju tërheq vëmendjen
19 për disa pyetje që ju bëri Gjykatësi Mettraux lidhur me
20 komunikatat dhe që ju bëri së fundmi dhe Gjykatësi Gaynor.

21 Së pari ta përcaktojmë një herë që ekzistonte një UÇK në
22 terren në Kosovë në vitin 1996, 1997 dhe në fillim të 1998, a
23 është e saktë kjo?

24 PË. Po.

25 PY. Jo, të gjithë ata anëtarë në terren në Kosovë kanë qenë

1 anëtarë të LPK-së, a është e saktë kjo?

2 PË. Këtë nuk e di se në atë kohë nuk i kam njohur të gjithë.

3 Po pas ramies së komandantit Adem Jashari e kemi kuptuar se
4 një pjesë e anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk
5 janë të LPK-së.

6 PY. Në rregull. Atëhere le të fillojmë me disa persona të
7 cilët kanë të cilët kanë funksionuar në terren atje. Ju e
8 njihni komandant Remin, apo jo?

9 PË. Edhe një herë?

10 PY. Komandant Remin e njihni, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Rrustem Mustafën Remin e njihni, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Atëhere do ju them se çfarë i ka thënë ai Trupit Gjykues
15 lidhur me anëtarësinë e tij në partitë politike në vitin 1996,
16 1997.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për procesverbal këtë e ka
18 thënë në faqen e transkriptit 5713.

19 PY. Së pari atij i bëhet pyetja:

20 "Ju keni qenë me degën e rinisë së LDK-së në 1995, apo
21 jo?"

22 "PË. Po.

23 "PY. Dhe ju jeni larguar nga LDK-ja në 1996 kur Adem
24 Demaçi formoi partinë e vet, PPK-në, apo jo?"

25 "PË. Po."

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace.

2 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e kundërshtoj
3 këtë pyetje. Sepse nuk më kujtohet që Gjykatësi Mettraux bëri
4 ndonjë pyetje lidhur me anëtarësinë e anëtarëve të UÇK-së në
5 Kosovë në 1996, 1997, 1998.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk besoj që
7 e bëri këtë pyetje, apo jo?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Janë pyetje të cilat lidhen pastaj
9 me bazën e përgjigjeve të dhëna më pas dhe pyetjeve të bëra
10 nga Gjykatësit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] në rregull.
12 Mund të vazhdoni.

13 Z. MISETIC: [Përkthim]
14 PY. Ju thoni -- tani, z. Remi thotë që ai ka qenë anëtar i
15 partisë së Demaçit dhe më pas transkripti në faqen 5723 thotë
16 më tej:

17 "Personalisht kam pasur biseda me Adem Demaçin gjatë
18 1996, 1997 rreth çështjeve të UÇK-së."

19 Në faqen 5829 ai pyetet:

20 "A keni qenë anëtar i LPK-së?"

21 Përgjigja është:

22 "Jo. Jam shkëmbyer me ta, i njihja ata, po nuk kam qenë
23 anëtar."

24 Pastaj pyetja tjetër është kjo:

25 "A keni qenë i përfshirë me veprimtaritë e tyre?"

1 "PË. Po. I kam ndihmuar ata në mënyrë të vazhdueshme si
2 student edhe i kam ndihmuar edhe më vonë."

3 Tani, z. Remi -- ja një çast ju lutem.

4 Më tej ai përmend në dëshminë e vet thotë që "Kam qenë në
5 kontakt" --

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe këtë e ka thënë në faqen 5839.

7 PY. Ai thotë:

8 " Kam qenë në kontakt me strukturat ilegale dhe kam qenë
9 i përfshirë në veprimtarinë e tyre. Kështu që unë kam pasur
10 veprimtari të pandërprerë me LPK-në derisa kam krijuar
11 kontakte me UÇK-në, përkatësisht kur Zahir Pajaziti e pa të
12 përshtatshme që unë të përfshihesha me UÇK-në dhe hapi dyert
13 në mënyrë që unë të bashkohesha me UÇK-në."

14 A e njihni Zahir Pajazitin ju, Dëshmitar?

15 PË. Sipas Remit, kontakte me Remin kemi -- jemi takuar bashkë
16 me Zahirin para luftës.

17 PY. Ju e dini gjithashtu që ai ka qenë udhëheqës, drejtues i
18 UÇK-së në zonën e Llapit në vitin 1996 dhe më përpara, a është
19 e saktë kjo?

20 PË. Po.

21 PY. Dua t'ju tregoj atë çfarë ka thënë Skënder Zhitia lidhur
22 me Zahir Pajazitin dhe përkatësinë e tij politike në vitin
23 1996.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do kalojmë
25 tek komunikatat apo jo?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, do kalojmë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem pak
3 më shpejt.

4 Z. MISETIC: [Përkthim]

5 PY. Në fakt ka të bëjë pikërisht me pyetjet e bëra nga
6 Gjykatësi Mettraux lidhet ngushtë me këto pyetje.

7 Do kërkoja tani të kaloja te dokumentin SPOE0055678 deri
8 në SPOE0055678 në versionin në shqip dhe në anglisht. Të
9 shkojmë tek faqja SPOE0055677.

10 PY. Atëherë në paragrafin e parë thuhet që:

11 "Në mesin e kreatorëve të ideve dhe veprimeve për
12 themelimin dhe shtrirjen e UÇK-së e cila për herë të parë në
13 historinë tonë kishte tejkaluar suazat, format dhe kufijtë
14 rajonal të territorit të brendshëm të Kosovës, është
15 luftëtari, komandanti Zahir Pajaziti i cili është iniciator i
16 shtrirjes dhe rritjes së UÇK-së në nënzonën operative të
17 Llapit ..."

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja tjetër për
19 të parë përkatësinë politike të tij në atë kohë. Në fund të
20 faqes në shqip.

21 PY. Thuhet që:

22 "Pavarësisht përcaktimit politik, Zahiri nuk i shkëputi
23 marrëdhëniet me individë të dëshmuar të çështjes kombëtare. Ai
24 filloi të punojë për formimin e parlamentit rinor të cilin e
25 themeloi si degë në Gallup (Orllan) më vonë në vitin 1994

1 themeloi Partinë Parlamentare të Kosovës ...”

2 Partia Parlamentare e Kosovës ishte partia e Adem

3 Demaçit, apo jo, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja

6 SPOE00055792. Do të kalojmë tek pika se kush ka qenë në

7 Shtabin e Përgjithshëm në momentin kur është nxjerrë kjo

8 komunikatë.

9 PY. Dëshmitar, Gjykatësi Gaynor ju bëri një pyetje të cilën
10 unë dua ta shtjelloj pak më tej dhe kjo pyetje ka të bëjë me
11 botimet, publikimet tuaja informacionin që ju publikonit dhe
12 nga vinin komunikatat.

13 Pra, informacioni i komunikatave pretendohet që të vinte
14 nga Shtabi Qendror e kam fjalën këtu për komunikatat që ju
15 publikonit, a është kështu, Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe pretendohet se ka informacione lidhur me sulmet në
18 stacionet policore, me likuidime personash. Po një informacion
19 i tillë domosdoshmërisht që vjen nga terreni, nga poshtë lart
20 në Kosovë, nëse do të jetë i saktë? Duhet të ketë një person
21 në teren dikund që e përcjellë këtë informatë që më pas ky
22 informacion të përkthehet - falni- të botohet në një
23 komunikatë, kështu?

24 PË. Besoj që po.

25 PY. Tani në ekran, përpara mund të shikoni çfarë ka thënë z.

1 Zhitia. Ai thotë:

2 "Në fillim të marsit", 1998, "Rrustem Mustafa dhe Rrahman
3 Rama në fillim të marsit kishin udhëtuar në Drenicë në një
4 takim pune me anëtarët e SHP-së së UÇK-së. Me këtë rast, më 4
5 mars, së bashku me Adem Jasharin, Rexhep Lesimin [Sipas
6 përkthimit] e Mujë Krasniqin kishin qenë në vizitë të
7 plagosurve në betejën e Likoshanit që gjendeshin në Ticë.

8 "Në mbrëmjen e 4 marsit, shkoi në Aqarevë ... në familjen
9 e Sulejman Selimit për të biseduar rreth organizimit."

10 Përpara vrasjes së Adem Jasharit, Adem Jashari ka qenë
11 komandanti i UÇK-së në terren në Kosovë, apo jo?

12 PË. Pas ramjes së tij dëshmor e kam kuptuar, sepse unë në atë
13 kohë nuk e kam ditur kush komandant.

14 PY. E keni mësuar më vonë. Këta persona janë persona të
15 terrenit dhe sipas librit vepronin dhe mblidheshin si anëtarë
16 të Shtabit të Përgjithshëm?

17 Z. PACE: [Përkthim] E kundërshtoj. Kjo nuk ka lidhje me
18 pyetjet e Gjykatësve. Dhe fragmenti që po i tregohet
19 dëshmitarit aktualisht i përket një periudhe të marsit 1998.
20 Ndërsa Gjykatësi Mettraux e pyeti dëshmitarin për anëtarësinë
21 e tij në redaksinë Zëri i Kosovës gjatë kohës që ishte në
22 Zvicër që nuk përkon me datën që po shohim ne në ekran.

23 Kështu që kjo nuk po lidhet me pyetjet e gjykatësve.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, ai ka thënë
25 disa herë që nuk e ka ditur kush ka qenë anëtar i Shtabi

1 Qendror në atë kohë. Është pyetur disa herë dhe ka thënë që
2 nuk e ka ditur.

3 Tani po përpiqesh të thuash që nuk po thotë të vërtetën
4 apo kërkoni të merrni diçka tjetër?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë besoj që nga dëshmitari
6 dëgjova që tha kam mësuar më vonë që Adem Jashari ka qenë
7 komandant, nuk e kuptoj çfarë ka këtu në mospërputhje.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më falni. Ai nuk tha që ka
9 qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, thjesht tha që ka qenë
10 komandant. Më mirë pyeteni nëse e dini që ka qenë anëtar i
11 Shtabit Qendror.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta pyes edhe në këtë formë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pyeteni
14 dëshmitarin.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Po më lejoni të dal -- Më lejoni
16 të dalë aty ku dua të dal.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po përdorni
18 shumë materiale që nuk janë të nevojshme për të bërë pyetjen
19 tuaj.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Me gjithë respektin, janë shumë të
21 rëndësishme për mua sepse kundërshtimi është i pavlerë, sipas
22 meje, se komunikata që ju tregua dëshmitarit kishte datën 5
23 mars 1998, Komunikata 42.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, është botuar më datën
25 5.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. U botua në datën 5.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të bëni
3 një pyetje që ka lidhje me pyetjet e gjykatësve dhe deri tani
4 s'e keni bërë këtë lidhje.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni të bëj parashtrimet e
6 mia. Po flasim për komunikata ku thuhet se anëtarë të Shtabit
7 të Përgjithshëm kanë lëshuar komunikata dhe kanë botuar
8 informata të caktuara.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po këtë e tha
10 dëshmitari.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Po përpiqem ta eksploroj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tha që nuk e
13 di. Tha që nuk e di kush ishte në Shtabin e Përgjithshëm. Nuk
14 e keni dëgjuar dëshmitarin. Ne e dëgjuam. Ju mund t'i thoni
15 jeni gënjeshtar nëse doni të thoni këtë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk është ky qëllimi im.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
18 vazhdoni.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, a njihni ndonjë prej emrave që shohim në
21 ekran? Rustem Mustafën, Rahman Ramën, Adem Jasharin? Dhe a
22 ka qenë ndonjë prej tyre në LPK, mesa dini ju?

23 PË. I njoh të gjithë këta emra. Rustem Mustafa ka qenë
24 bashkë me mu në forumin rinor të LDK-së në 1994, 1995. Rahman
25 Ramën nuk e di. Adema Jasharin ma vonë e kam kuptuar që ka

1 qenë anëtar i LPK-së. Për Rexhep Selimin nuk e di, as për Mujë
2 Krasniqin

3 PY. Po Sylejman Selimi?

4 PË. As për Sylejman Selimin nuk e dija.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, nxjerrim tani në ekran
6 komunikatën 42 e cila mban numrin e provës P00154.

7 Ndërkohë do të doja të kërkoja dhe pranimin e faqes së
8 librit të Skënder Zhitisë dhe mund të bashkëngjiten në provën
9 që mban numrin P0017 edhe përndryshe ka numrin SPOE00055792.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
11 kundërshtime?

12 Z. PACE: [Përkthim] Dëshmitari nuk ka thënë asgjë që të
13 mund bëjë relevant këtë dokument dhe të pranohet përkatësisht.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

15 Materiali 0055792 pranohet, do t'i bashkëngjitet provës
16 00187.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të përsëris edhe një
18 herë ERN. Është faqja SPOE00055792.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Faleminderit.

20 PY. Dëshmitar, lidhur me këtë komunikatë që ua tregoi
21 Gjykatësi Mettraux, këtu thuhet:

22 "... njësisë të tona të armatosura kryen disa -- gjatë
23 janarit sulmet e armatosura u kthyen në janar dhe në shkurt
24 nga anëtarët tanë."

25 Shkojmë te paragrafi që thotë:

1 "Për gjatë gjithë janarit sulmet e armatosura u kryen dhe
2 në Obiliq, Dellovë të Klinës, Ferizaj dhe në Podujevë."

3 Dy rreshta më poshtë më 19 shkuan u likuidua në Lluzhan
4 pranë Podujevës kriminelin Nebojsa Cvejic, një anëtar i forcave
5 policore serbe."

6 Mesa dini ju, Podujeva në zonën e Llapit është?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe në atë kohë zona e Llapit, mesa dini ju, a ka qenë
9 zona ku operonte Rustem Mustafa, Remi, në fillim të 1998 dhe
10 mund ta kundërshtoni në qoftë se mendoni që jo?

11 PË. Jo, jo. Nuk e di në 1998.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Miseti, harrova të
13 thoja që ka një gabim për datën të anglishtja. Anglishtja e ka
14 13 shkurt, domethënë, shqipja e ka 1990, është një problem
15 përkthimi, ndërsa shqipja e ka 1998.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Paragrafi tjetër lidhet me diçka
17 që ju pyeti Gjykatësi Gaynor nëse janë bërë korrigjime. Ju
18 thatë jo. Komunikata thotë që:

19 "Komunikata ka pas, përmbante një kërcënim për
20 kryeministrin shqiptar fabrikuar nga qarqet antishqiptare dhe
21 e lëshuar në emër të UÇK-së. Ajo nuk është e jona dhe është e
22 pavlefshme."

23 Ky është një shembull sesi janë mohuar disa komunikata,
24 siç është rasti konkret, të paktën kjo këtu.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund t'i bëni një

1 pyetje, z. Misetic?

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, pyetja ime është kjo: A e keni ditur ju që
4 Komunikata 42 ka pasur probleme sa i takon faktit që është
5 botuar dhe është -- dhe shtabi qendror e ka mohuar këtë
6 komunikatë si një komunikatë të vetën?

7 PË. Kur ka pas probleme na kanë njoftu, do të thotë, edhe pse
8 e kemi botu, sepse në atëkohë nuk kemi mujt me komuniku
9 drejtpërdrejt me Shtabin e Përgjithshëm, na ka ardhë me faks.
10 Në qoftë se s'ka qenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e
11 Shtabit të Përgjithshëm ka reaguar po ashtu me faks dhe ne,
12 normalisht, e kemi demontuar pastaj.

13 PY. Mbetemi tek kjo temë. Mesa e kuptoj unë dëshminë tuaj, ju
14 nuk e keni idenë kur ishit te Zëri i Kosovës nëse komunikatat
15 vinin drejtpërdrejt nga terreni në Kosovë, pra, nga poshtë,
16 apo dërgoheshin nga Shqipëria apo përgatiteshin e dërgoheshin
17 nga Zvicra. Ju nuk e kishit idenë nga vinin këto, apo jo?

18 PË. Ne nuk e kemi dit. Na kanë ardhë me faks. Nga cili terren
19 nuk e kemi dit.

20 PY. Lidhur me faktin që nuk keni pasur dijeni se kush ishin
21 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm dhe nëse ndonjë prej këtyre
22 personave ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm kur
23 udhëtonit bashkë drejt Kosovës. Më vonë a keni dëgjuar gjë, a
24 keni mësuar gjë që, për shembull --

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

1 Z. PACE: [Përkthim] Po prisja të përfundonte pyetjen po e
2 bëj që tani kundërshtimin. Pyetja që bën Avokati buron nga
3 pyetjet e mia. Unë e trajtova kush po udhëtonte me të. Unë e
4 kam bërë këtë pyetje.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë pyetje e kam bërë dhe
6 unë, z. Pace.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
8 Misetic. Rrëzohet kundërshtimi.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi Mettraux
10 që ia solli në vëmendje, z. Pace.

11 PY. Dëshmitar, unë po ju bëja këtë pyetje: A mësuat në ndonjë
12 moment më pas që për shkak të vrasjes së Adem Jasharit si
13 udhëheqës, komandant, çfarë të doni të UÇK-së poshtë në bazë,
14 ka pasur dhe persona, pra, që në Shtabin e Përgjithshëm pas
15 vrasjes së Adem Jasharit pati person -- pas vrasjes së Adem
16 Jasharit në Shtabin e Përgjithshëm pati anëtarësi të re, keni
17 mësuar gjë më vonë në lidhje me këtë?

18 PË. Ma vonë në periudhën e fundit thua ja të luftës. Po e kemi
19 ditur se ka njerëz që veprojnë në terren.

20 [Mbrojtja këshillohet]

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. Dixon.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Po, kam disa pyetje
25 plotësuese.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] në rregull.

2 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

3 Z. DIXON: [Përkthim]

4 PY. Z. Buja, kam pak pyetje që burojnë nga pyetjet e
5 gjykatësve.

6 Pyetja e parë lidhet me pyetjen që bëri Gjykatësi Barthe
7 për z. Reqica, nëse z. Reqica merrte urdhra prej Shtabit të
8 Përgjithshëm dhe nëse ai vetë raportonte drejtpërdrejt në
9 Shtabin e Përgjithshëm. Ju kujtohen këto pyetje?

10 PË. Po.

11 PY. Do t'ju lexoj pjesën përkatëse që ta kemi të qartë.

12 Gjykatësi Barthe ju pyeti:

13 "Nga e dini ju që z. Reqica nuk ka marrë urdhra prej
14 Shtabit të Përgjithshëm? Si mund të jeni ju i sigurtë që ai
15 nuk ka marrë urdhër prej shtabit?"

16 Dhe ju u përgjigjët kështu:

17 "Unë kam qenë komandanti i zonës. Dhe në bazë të
18 rregullave dhe të strukturës organizative, zbulimi dhe
19 kundërzbulimi mund t'i raportonte shefit të shtabi dhe
20 komandantit të zonës. Në bazë të organigramës kjo ka qenë vija
21 e raportimit. Kështu që nuk mund të jem 100 për qind i sigurtë
22 nëse nuk ka pasur ndonjë përjashtim, se ka ndodhur, po këto
23 kanë qenë rregullat, si rregull kështu ka qenë dhe unë nuk kam
24 dijeni që z. Reqica të ketë anashkaluar komandën e zonës."

25 Ju kujtohet kjo përgjigje?

1 PË. Po.

2 PY. Më pas vijoi Gjykatësi Barthe dhe ju pyeti:

3 "Po z. Reqica ta ka thënë apo nuk ta ka thënë ndonjëherë
4 që ka marrë a s'ka marrë një urdhër? A të ka thënë vetë ai ty
5 që s'ka marrë asnjëherë urdhër, po apo jo?

6 Dhe ju u përgjigjët:

7 "Jo, asnjëherë s'ma ka thënë një gjë të tillë."

8 Vijoi Gjykatësi Barthe dhe thotë:

9 "Faleminderit. Pra, me fjalë të tjera ju po supozoni në
10 bazë të strukturës së zonës operative dhe të Shtabit të
11 Përgjithshëm, e keni thënë, pra, disa herë që ju thjesht po
12 supozoni se ai nuk ka marrë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm,
13 por nuk mund të jeni i sigurtë. A është kjo dëshmia juaj?"

14 Më pas në këtë moment unë bëra një ndërprerje, patëm disa
15 diskutime këtu dhe ju më pas u përgjigjët dhe thatë që:

16 "Nuk besoj që e ka bërë se kjo ka qenë organigrama apo
17 struktura që kishim ne."

18 Dëshmitar, ju kujtohet ky shkëmbim me Gjykatësin?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe do jap dhe një pjesë tjetër që ta keni panoramën të
21 plotë. Kur ju pyetën për z. Reqica dhe raportimin në Shtabin e
22 Përgjithshëm ju thatë që ai si shef i ZKZ-së, "kishte një
23 zyrë" --

24 Z. DIXON: [Përkthim] Është në faqen 79 të transkriptit.

25 PY. Pra, thatë që:

1 "Kishte një zyrë në komandën e zonës dhe unë besoj që ai
2 nuk mund t'i ketë raportuar dikujt tjetër. Në bazë të detyrave
3 që kishte ai, ai i ka raportuar komandantit të zonës,
4 komandantit dhe shefit të shtabit të zonës."

5 Ju kujtohet kjo përgjigje?

6 PY. Po.

7 PY. Z. Buja, unë dua t'ju pyes, sidomos në kuadër të dëshmisë
8 dhe përgjigjeve që keni dhënë, cilat janë, mbi ç'fakte thoni
9 ju që z. Reqica nuk ka marrë asnjë urdhër prej Shtabit të
10 Përgjithshëm dhe se nuk i ka raportuar vetë drejtpërdrejt
11 Shtabit të Përgjithshëm, ku e bazoni këtë?

12 PË. Po, së pari, kemi pas strukturën organizative e cila ka
13 ardh nga Shtabi i Përgjithshëm dhe komanda e zonës. Dhe
14 organigrami ka qenë nga shefi i shtabit të Ushtrisë Çlirimtare
15 të Kosovës, z. Bislum Zyrapi. Dhe, në bazë të këtij
16 organigrami, kanë qenë dhe vijat e sesi përcillet raporti dhe
17 si raportohet dhe kush komandon dhe si kthehen urdhrat. Në
18 bazë të këtij organigrami, G2 apo sektori i informacionit i
19 zbulim kundërzbulimit e ka pas për detyrë me e përcjellë
20 raportin te shefi i shtabit, po ashtu, ka pas mundësi edhe
21 drejtpërdrejt komandantit të zonës. Do të thotë, këto të dyja
22 i ka pas detyra të raportimeve.

23 Dhe në bazë të këtyre raporteve, ne pastaj kemi bërë dhe
24 operimet në bazë të informacioneve që kanë ardhur nga shërbimi
25 i zbulim kundërzbulimit.

1 PY. Po. A është e saktë që ju dhe z. Reqica keni qëndruar në
2 të njëjtën zyrë të zonës dhe që po ashtu dilnit së bashku dhe
3 luftonit në vijën e frontit?

4 PË. Po, është e vërtetë.

5 PY. Pra, ju keni qëndruar bashkë rregullisht dhe keni punuar
6 ngushtësisht bashkë, kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Ju keni dhënë dëshmi dhe keni thënë se e njihnit mirë
9 këtë person dhe kishit besim tek ai, kështu?

10 PË. Po, se kam qenë dhe në burgjet e Serbisë bashkë me të.

11 PY. Dhe gjatë kohës që keni qëndruar bashkë nuk patë asgjë në
12 veprimet e tij që t'ju shtynte ju të mendonit që ai po merrte
13 urdhra prej dikujt tjetër apo nuk po respektonte vijën
14 komanduese, saktë?

15 PË. Po, fakt është.

16 PY. Asnjëherë s'keni dyshuar se ai po ua punonte pas shpine
17 ndonjëherë apo jo?

18 PË. Nuk kam dyshu. Se po të kisha dyshu kisha marrë veprime
19 ndaj tij apo shkarkimin e shefit.

20 PY. Pra, a po thoni ju në dëshminë tuaj se keni besim që ju
21 si komandant zone do ta kishit ditur patjetër nëse ai do t'i
22 raportonte drejtpërdrejt Shtabit të Përgjithshëm apo se
23 merrte urdhra prej tyre drejtpërdrejt?

24 PË. Po e ka pas të pamundur sepse dhe mjetet e komunikimit
25 kanë qenë në komandë të zonës tek unë, tek komandanti i zonës.

1 E për të shkuar nga territori apo nga komanda në një territor
2 tjetër u dashtë po ashtu të marrë leje nga unë. Dhe unë ta
3 përcaktoj detyrën e tij dhe e ka pas të pamundur me kontakt
4 me anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm në kohën kur unë kam
5 qenë në komandë të zonës bashkë me të.

6 PY. Me një fjalë, ju jeni i bindur që ai nuk e ka bërë këtë?

7 PË. Po, i bindur jam.

8 PY. Faleminderit. Tani do t'ju pyes për një aspekt që e
9 trajtoi Gjykatësi Gaynor. Në faqen 87 të transkriptit në kohë
10 reale, Gjykatësi Gaynor ju pyeti dhe ju tha:

11 "Duke parë marrë parasysh natyrën tepër të ndryshueshme
12 të konfliktit asokohe, a është e vërtetë që kishte raste kur
13 zbulimi dhe kundërzbulimi, stafi i zbulimit dhe kundërzbulimit
14 duhet të ndërlihdeshin dhe të koordinonin me policinë
15 ushtarake?"

16 Ju thatë:

17 "Mundësia për koordinim bëhej përmes komandantit të zonës
18 dhe jo drejtpërdrejt mes dy shërbimeve."

19 Ju kujtohet që e thatë këtë?

20 PË. Po.

21 PY. Më pas Gjykatësi Gaynor tha, ju pyeti:

22 "Po ju si komandant zone, a siguroheshit që të kishte
23 koordinim mes ZKZ-së dhe policisë ushtarake?"

24 Dhe ju u përgjigjët:

25 "Po" --

1 Më falni. Ju thatë:

2 "Kjo ka qenë një nga detyrat që kisha unë si komandant
3 zone. Ka qenë një prej detyrave që unë kisha si komandant
4 zone, jam përpjekur t'i koordinoj veprimet e të gjitha njësive
5 të Zonës Operative të Nerodimës sepse kjo ka qenë detyra ime
6 si dhe detyra e shefit të shtabit të zonës."

7 Ju kujtohet përgjigja?

8 PË. Po.

9 PY. Më pas Gjykatësi ju tregoi provën P00648. Ishte një
10 rregullore e brendshme. E mbani mend që u vendos në ekran një
11 rregullore e brendshme?

12 PË. Po.

13 PY. Te kreu VII ose VIII se kishte një mospërputhje mes
14 shqipes dhe anglishtes dhe ju bënë disa pyetje lidhur me
15 policinë ushtarake dhe detyrat që kishte ajo. Ju kujtohet?

16 PË. Edhe një herë? Se s'po --

17 PY. Pra, Gjykatësi ju bëri disa pyetje për Kreun VII të
18 rregullores ku trajtoheshin detyrat e policisë ushtarake. Ju
19 kujtohen pyetjet për këtë?

20 PË. Po.

21 PY. Dëshiroj të jemi të qartë, këto rregullore të brendshme
22 nuk janë të njëjtat si rregullorja e disiplinës që të tregova
23 unë por dhe Prokurori, z. Pace, kur ju bëri pyetjet. Pse po e
24 them unë këtë? Po e them unë këtë sepse unë dua t'ju pyes nëse
25 i kishit parë ju ndonjëherë këto rregullore, nëse i kishit

1 parë ju ndonjëherë këtë rregulloren përpara ditës së sotme kur
2 ua tregoi Gjykatësi?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
4 pyetje këtu?

5 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Jo, pyetja ishte a i ka parë
6 ndonjëherë më përpara?

7 PY. E keni parë ndonjëherë më përpara?

8 PË. Jo. Një rregullore të tillë, jo.

9 PY. Pra, ajo që ju tregoi Gjykatësi sot, kreu konkret, ishte
10 hera e parë që ju e shihnit, ishte hera e parë që shihnit një
11 pjesë ku flitej për policinë ushtarake dhe detyrat e saj,
12 kështu?

13 PË. Jo, mesa më kujtohet, është hera e parë.

14 PY. Më pas Gjykatësi Gaynor ju bëri disa pyetje për
15 rregulloren, ai pyeti dhe tha:

16 "A e kuptoj unë drejt, se policia ushtarake ishte e
17 detyruar të bashkëpunonte me shërbimin e zbulim kundërzbulimit
18 dhe të ishte e pamëshirshme ndaj atyre që sabotonin luftën për
19 liri?"

20 Dhe ju u përgjigjët:

21 "Kështu thuhet këtu. Por nuk mund të vepronin pa lejen e
22 komandantit të zonës ose shefit të shtabit sepse ishin në
23 varësi të komandës së tyre. Ishin në varësi të komandës."

24 E mbani mend këtë përgjigje?

25 PË. Po.

1 PY. Pyetja ime është kjo tani: Nëse ju kujtohet, ju
2 personalisht e keni koordinuar shërbimin e sektorit të
3 zbulimit me shërbimin e policisë ushtarake në ndonjë moment
4 gjatë kohës që ju keni komanduar zonën? Ju është dashur në
5 ndonjë moment që ta ushtronit këtë funksion?

6 PË. Po, sigurisht.

7 PY. A mund të tregoni çfarë ishte ky koordinim, çfarë
8 nënkuptonte ky lloj koordinimi?

9 PË. Po koordinimi në qoftë se e kishim informacionet të
10 ndonjë rrezikshmërie nga forcat okupatore serbe nga zbulim
11 kundërzbulimi atëherë e përcillnim përmes shefit të shtabit
12 ose drejtpërdrejt komandantit të policisë që të kishte kujdes
13 në atë pozicion.

14 PY. Po cili ishte qëllimi i këtij udhëzimi të komandantit të
15 policisë ushtarake në këtë formë?

16 PË. Edhe një herë?

17 PY. Për ç'qëllim? Cili ishte qëllimi i udhëzimit të policisë
18 -- i komandantit të policisë - më falni - në këtë mënyrë për
19 të koordinuar këto veprimtari?

20 PË. Po ka pas raste që në qoftë se duhet ta përshkruaj, ka
21 pas një, në qoftë se më lejohet, ka pas një moszbatim të
22 urdhëresës nga komplet një kompani e Ushtrisë Çlirimtare të
23 Kosovës në Batalionin e Dytë të Brigadës 161. Dhe sipas
24 informacioneve nga zbulim kundërzbulimi, ata nuk po i
25 ndëgjonin urdhnat e komandantit të brigadës. Dhe normalisht që

1 unë është dashtë të kërkoj nga policia ushtarake që të shkojë
2 tek kompania dhe ta shof pse s'po zbatojnë atë urdhëresë. Dhe
3 normalisht që kemi marrë veprime sipas rregullores disiplinore
4 por nuk kemi mujt me i çarmatosë komplet një kompani sepse
5 rrezikshmëria ka qenë e lartë. Do të thotë, ky koordinim është
6 bërë përmes shefit të shtabit ose përmes meje.

7 PY. Pra, ju sapo na përshkruat një proces ku ju
8 konsultoheshit si komandant zone për të siguruar që koordinimi
9 do të ishte i frytshëm, kështu?

10 PË. Sigurisht.

11 PY. Pra, në çdo rast ky proces duhet të kalonte përmes jush
12 si komandant zone. Nuk ndodhte që vetë sektorët të koordinonin
13 mes njeri-tjetrit pa dijeninë tuaj, kështu?

14 PË. Sektorët koordinojshin përmes shefit të shtabit, ndërsa
15 sektorët me njësi të veçanta, siç është kompania e policisë,
16 shkonin përmes komandantit të zonës.

17 PY. Pra, ose përmes komandantit të zonës ose shefit të
18 shtabit. Sidoqoftë dy pikat qendrore për koordinim ishit ju të
19 dy?

20 PË. Po.

21 PY. Faleminderit, z. Buja.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
24 z. Dixon.

25 Z. Roberts.

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

3 Alagendra.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kam vetëm një pyetje.

5 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. V.

6 Alagendra:

7 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

8 PY. Z. Buja, Zëri i Kosovës botohej dhe shpërndahej jashtë

9 Kosovës, apo jo?

10 PË. Zëri i Kosovës botohej në Zvicër dhe shpërndahej në

11 shtetet e perëndimit. Ndërsa në Kosovë ka pas shumë vështirësi

12 për t'u shpërndarë.

13 PY. Pra, ta kuptoj këtë përgjigje tuajën që Zëri i Kosovës

14 nuk publikohej dhe nuk qarkullonte si gazetat e tjera në

15 Kosovë, si, për shembull, Koha Ditore, kështu?

16 PË. Ndonjë fragment i saj po, po jo po botimi i Zërit të

17 Kosovës apo shpërndarja e Zërit të Kosovës ishte e ndaluar në

18 Kosovë.

19 PY. Faleminderit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

21 znj. Alagendra.

22 Po, Avokat.

23 Z. HODAJ: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

24 [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Nuk e di në qoftë se më dëgjoni tani?

1 Faleminderit. Kam një koment të shkurtër që ka të bëjë me
2 një prej konstatimeve të bëra nga Gjykatësi Barthe sa i takon
3 gjendjes së dëshmitarit, domethënë, në pozicionin e
4 dëshmitarit që dëshmitari ka dhënë dëshmi në TPNJ.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
6 pjesë e kompetencave të tuaja. Nuk është e nevojshme që ju të
7 shpreheni lidhur me këtë.

8 Z. HODAJ: [Përkthim] Sepse dëshmitari nuk ka kontrolluar
9 siç duhet --

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk ju
11 lejoj që të vazhdoni më tej.

12 Z. HODAJ: [Përkthim] Në rregull.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Buja,
14 besoj që do gëzoheni t'ju them që këtu përfundam me dëshminë
15 tuaj. Faleminderit që ishit me ne këto katër ditë. Tani mund
16 të vazhdoni më tej. Nuk keni detyrime të tjera përpara Trupit
17 Gjykues. Ju urojmë gjithë të mirat. Ju falënderojmë dhe një
18 herë. Dhe mund të largoheni nga salla e gjyqit me Asistenten
19 së bashku me të.

20 Gjithë të mirat, z. Buja.

21 DËSHMITARI: Faleminderit.

22 Z. HODAJ: [Përkthim] Gjykatës, a mund të them diçka.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
24 z. Hodaj.

25 Z. HODAJ: [Përkthim] Faleminderit. Ka qenë nder për mua

1 që të kem qenë avokat i dëshmitarit. Ju uroj gjithë të mirat,
2 shëndet dhe uroj që ta përfundoni sa më shpejt këtë proces
3 gjyqësor.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 [Dëshmitari largohet]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë gjë
7 tjetër për t'u thënë nga palët tani?

8 Faleminderit të gjithëve. Ju faleminderit që përfunduar
9 me këtë dëshmitar në mënyrën e duhur dhe në kohën e duhur. Do
10 shihemi pas një jave bashkë, do të takohemi të hënën pas një
11 jave, jo javën që vjen. Faleminderit të gjithëve.

12 --- Seanca mbyllet në orën 15.33

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25